

Revistë shkencore juridike e kandidatëve të Programit Fillestar për Arsimit Ligjor

JUSTICIA

Viti I/2009, Numri 1/2009



J U S T I C I A

*Revistë Juridike me punime të kandidatëve nga Programi Fillestar për
Arsimim Ligjor 2008/2009 në Institutin Gjyqësor të Kosovës në Prishtinë*

Viti I, Nr.1/2009

Botues
Instituti Gjyqësor i Kosovës

ANËTARËT E REDAKSISË

Mr.sc.Afrim Shala,
Mr.sc.Albert Zogaj,,
Burim Çerkini, jur. i dipl.,
Valon Totaj, jur. i dipl.

Dizajni dhe radhitja kompjuterike
Instituti Gjyqësor i Kosovës

© Instituti Gjyqësor i Kosovës / Kosovski Institut za Pravosudje
/Kosova Judicial Institute

Publikimi i kësaj reviste u mundësua nga Programi për Zhvillim i
Kombeve të Bashkuara, UNDP, Zyra në Kosovë



Financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë



P Ë R M B A J T J A

Lavdim Krasniqi, Parathënie	1
Mr.sc.Afrim Shala Kompetencat e gjyqtarit të procedurës paraprake sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.....	3
Mr.sc.Albert Zogaj, Aspekte krahasimore të përkufizimit të pronësisë	15
Arsim Hamzaj Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, roli i saj në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe intervenimi humanitar	21
Burim Çerkini Tentativa si fazë e kryerjes së veprës penale	27
Fatmir Behrami E drejta e pronësisë	43
Isa Shala Propozimi për përmbardim dhe lejimi i përmbardimit	49
Mr.sc.Isuf Sadiku E drejta për një proces gjyqësor të drejtë, publik, brenda një kohe të arsyeshme, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, në ditën e nënit 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Legjislacionit në Republikën e Kosovës	61
Nehat Idrizi Vepra penale e trafikimit të njerëzve	67
Qerim Ademaj Arrestimi i përkohshëm dhe ndalimi policor	75
Sabri Halili Gjyqësori kosovar, refleksionet nga e kaluara dhe etika gjyqësore	85

Mr.sc.Shaban Shala Caktimi i vlerës së objektit të kontestit	93
Mr.sc.Shaban Shala Ligji i ri për procedurën administrative, raporti me ligjin e mëparshëm dhe sfidat e zbatimit të tij	99
Valon Totaj Kontrata (para)martesore	105
Valon Totaj & Arsim Hamzaj Shkurorëzimet në Kosovë	111
Violeta Husaj-Rugova Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut me theks të veçantë Neni 5	117



Lavdim KRASNIQI

Drejtore i Institutit Gjyqësor të Kosovës

Të nderuar lexues të revistës "Justicia"

Muaj më parë Instituti Gjyqësor i Kosovës filloj zbatimin e Programit për Përgatitjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve të ardhshëm të Kosovës. Gjatë periudhës së trajnimit në këtë program, kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë, përveç ndjekjes së trajnimeve, kanë marrë përsipër edhe obligime të tjera profesionale. Njëra ndër to është edhe publikimi i kësaj reviste juridike me emrin "Justicia".

Kjo revistë shpreh koherencën dhe ambiciet e tyre si gjyqtarë dhe prokurorë të ardhshëm si dhe implementon iniciativat e tyre konkrete.

Revista përmban punime dhe hulumtime të ndryshme të kandidatëve të cilët ndjekin trajnimet në Programin Fillestar për Arsimim Ligjor në Institutin Gjyqësor të Kosovës.

Kur u shfaq ideja për publikim, qëllimi i kësaj reviste ka qenë që kandidatët e Programin Fillestar për Arsimim Ligjor të shprehin opinionet e tyre ligjore, të nxiten për hulumtimin e çështjeve problemore kryesisht në sistemin gjyqësor, të japin mendime dhe interpretime për institute të ndryshme të së drejtës, por gjithmonë duke menduar se këto punime do të ishin me karakter informativ. Mirëpo duke

vështruar punimet dhe qasjen e kandidatëve në hartimin e tyre vërehet qartë se këto punime përveç karakterit informativ për të gjithë juristët në Kosovë, kanë edhe vlera solide për kulturën tonë juridike.

Karakteristikë e kësaj reviste është se temat janë përzgjedhur dhe janë redaktuar nga vet kandidatët.

Shpresojmë se idetë, interpretimet dhe opinionet e prezantuara në këtë revistë do të jenë të dobishme për ju në punën tuaj të përditshme.

Megenëse, ky është numri i parë i revistës e cila tani e tutje do të jetë e përvitshme, komentet dhe sugjerimet tuaja janë të mirëseardhura.



Mr.sc.Afrim SHALA

KOMPETENCAT E GJYQTARIT TË PROCEDURËS PARAPRAKE SIPAS KODIT TË PROCEDURËS PENALE TË KOSOVËS¹

Gjykata si subjekt themelor i procedurës penale funksionin e vetë të gjykimit e realizon duke vendosur në mënyrë kolegjiale dhe individuale. Në mënyrë kolegjiale gjykata vendos në trup gjykues (trup të madh gjykues, të vogël dhe në trup gjykues për të mitur) si dhe në kolegj gjyqësor (kolegj prej tre ose pesë gjyqtarëve), kurse në mënyrë individuale vendos gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i cili e zbaton seancën për konfirmimin e aktakuzës, kryetari i gjykatës, kryetari i trupit gjykues, gjyqtari i vetëm kur shqipton urdhrin ndëshkimor, gjyqtari i vetëm kur gjykon çështjet penale në procedurën e shkurtër dhe gjyqtari për të mitur².

Gjyqtari i procedurës paraprake është njëri nga gjyqtarët profesional të gjykatave komunale dhe të qarkut në Kosovë.

Termi "gjyqtar i procedurës paraprake" është një term i ri i cili është i paraparë për herë të parë me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës.

¹ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, është shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut, nr.2003/26, të datës 06.07.2003 dhe ka hyrë në fuqi më datën 06.04.2004 (në tekstin e mëtejme KPPK). KPPK është ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.03/L-003, të datës 03.11.2008, për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës. Meqë në këtë punim trajtohen kompetencat e gjyqtarit të procedurës paraprake sipas KPPK-së, atëherë në të gjitha rastet kur është shënuar vetëm neni (dhe/ose paragrafi) pa e theksuar ligjin përkatës, është fjala për dispozitë të KPPK-së.

² Dr.Ejup Sahiti, E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2005, faqe 60 - 61.

Duke u bazuar në dispozitat e KPPK-së, parimisht gjyqtari i procedurës paraprake ka kompetenca që të veprojë vetëm në procedurën paraprake. Procedura paraprake është fazë e parë e procedurës penale, e cila në vete përfshinë hetimet, ngritjen e aktakuzës dhe seancën e konfirmimit të aktakuzës. Mirëpo, siç do të shohim në vijim, në disa raste gjyqtari i procedurës paraprake ka kompetenca që të veprojë edhe nëse ende formalisht nuk është filluar procedura penale (hetimore), sidomos kur është fjala për kufizimin e lirisë së lëvizjes së personit. Disa veprime të cilat në procedurë paraprake i ndërmerr gjyqtari i procedurës paraprake, sipas dispozitave të KPPK-së, në shqyrtim gjyqësor i ndërmerr kryetari i trupit gjykues ose trupi gjykues.

Përcaktimi i kompetencave të gjyqtarit të procedurës paraprake është një çështje e vështirë, për arsye se me KPPK këto kompetenca nuk janë të caktuara në mënyrë taksative në një dispozitë ligjore, por ato mund të përcaktohen duke i analizuar një numër të madh të dispozitave ligjore. Në përgjithësi gjyqtari i procedurës paraprake ka kompetencë për të vendosur lidhur me veprimet dhe masat në procedurën paraprake të cilat i kufizojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut (neni 9 parag.3).

Karakteristikë themelore e procedurës paraprake është se gjyqtari i procedurës paraprake nuk merr asnjë veprim sipas detyrës zyrtare, por gjithnjë me propozimin e palëve dhe pjesëmarrësve tjerë, edhe atëherë kur duhet vendosur lidhur me kufizimin e lirisë dhe të drejtave tjera të personit³.

Në radhë të parë, gjyqtari i procedurës paraprake ka kompetenca që deri para ngritjes së aktakuzës të marrë vendim për caktimin e masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit, pengimin e rikryerjes së veprës penale dhe sigurimin e suksesshëm të zhvillimit të procedurës penale (neni 268 parag.4). Sipas nenit 268 parag.1 të KPPK-së, masat të cilat mund të përdoren për të siguruar praninë e të pandehurit, për pengimin e rikryerjes së veprës penale dhe për zbatimin e suksesshëm të procedurës penale janë: thirrja, urdhërarrestit, premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin, ndalimi për t'iu

3 Xhevdet Elshani, Mejdin Dehari, Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, Pjesa e III - IV, Instituti Gjyqësor i Kosovës, Prishtinë, Shtator, 2008, Prezentimi X-XI, Faqe 1.

afruar vendit ose personit të caktuar, paraqitja në stacionin policor, dorëzania, arresti shtëpiak dhe paraburgimi. Para ngritjes së aktakuzës gjyqtari i procedurës paraprake vendos edhe për zgjatjen e masës e ndalimit për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar (neni 272), masën e paraqitjes në stacionin policor (neni 273) dhe masën e paraburgimit, nëse plotësohen kushtet e parapara me ligj.

Kur është fjala për kufizimin e lirisë së personit, gjyqtari i procedurës paraprake është kompetent që të vendos edhe për ankesën e personit të arrestuar të paraqitur kundër vendimit mbi ndalimin (neni 212 parag.6). Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit. Gjyqtari i procedurës paraprake vendos për ankesë brenda njëzetekatër orëve nga momenti i arrestimit (212 parag.6).

Mirëpo, padyshim se njëra ndër kompetencat më të rëndësishme të gjyqtarit të procedurës paraprake është caktimi, vazhdimi (zgjatja) dhe ndërprerja e paraburgimit.

Sipas nenit 282 parag.1 të KPPK-së, paraburgimin e cakton gjyqtari i procedurës paraprake i gjykatës kompetente në bazë të kërkesës me shkrim të prokurorit publik pas mbajtjes së seancës së dëgjimit. Pasi që personi i arrestuar të jetë sjellë te gjyqtari i procedurës paraprake, ai menjëherë e njofton personin e arrestuar për këto të drejta: të drejtën që të informohet në gjuhën që ai e kupton për arsyet e arrestimit, të heshtë dhe të mos përgjigjet në asnjë pyetje, përveç dhënies së informatave mbi identitetin e tij, t'i sigurohet përkthim falas nëse nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën e procedurës, të shfrytëzojë ndihmën e mbrojtësit dhe t'i caktohet mbrojtës nëse nuk ka mundësi të paguajë për ndihmë ligjore, për arrestimin e tij të lajmërojë ose të kërkojë nga policia ta lajmërojë anëtarin e familjes ose ndonjë person tjetër sipas zgjedhjes së tij dhe të ketë kontroll dhe trajtim mjekësor duke përfshirë edhe trajtimin psikiatrik.

Pas kësaj gjyqtari i procedurës paraprake e zbaton seancën e dëgjimit lidhur me paraburgimin, në të cilën prokurori duhet që të paraqesë arsyet në të cilat e mbështetë kërkesën për caktimin e paraburgimit, kurse i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, mund të përgjigjen duke i prezantuar argumentet e tyre (neni 282 parag.5).

Gjyqtari i procedurës paraprake, pas mbajtjes së seancës së dëgjimit ka këto mundësi:

- a) të aprovoj kërkesën e prokurorit dhe ndaj të pandehurit të caktoj paraburgimin,
- b) të refuzoj kërkesën e prokurorit dhe ndaj të pandehurit të caktojë ndonjë masë tjetër alternative të paraburgimit ose
- c) të refuzoj kërkesën e prokurorit publik dhe i pandehuri të lirohet.

Paraburgimi caktohet me aktvendim nga ana e gjyqtarit të procedurës paraprake, kundër të cilit lejohet paraqitja e ankesës në afat prej 24 orëve.

Paraburgimi i caktuar nga gjyqtari procedurës paraprake, mund të vazhdohet nga kolegji prej tre gjyqtarëve. Por, edhe gjyqtari i procedurës paraprake mund të vazhdoj paraburgimin ndaj të pandehurit nëse prokurori publik ka paraqitur propozim. Kështu, sipas dispozitës së nenit 285 parag.4 të KPPK-së, paraburgimi i caktuar nga kolegji prej tre gjyqtarësh, mund të zgjatet nga gjyqtari i procedurës paraprake jo më shumë se një muaj, brenda afateve të parapara në nenin 284 të këtij Kodi, pas seancës së dëgjimit lidhur me paraburgimin⁴.

Me pëlqimin e prokurorit publik, gjyqtari i procedurës paraprake në çdo kohë mund të ndërpresë paraburgimin ndaj të pandehurit gjatë zbatimit të hetimeve (neni 286 parag.1). Arsyet për të cilat gjyqtari i procedurës paraprake mund të ndërpres paraburgimin ndaj të pandehurit janë të përcaktuara në nenin 286 parag.3 dhe 4 të KPPK-së. Kur gjyqtari i procedurës paraprake dhe prokurori publik nuk mund të arrijnë marrëveshje për heqjen e paraburgimit, gjyqtari i procedurës paraprake kërkon që për këtë çështje të vendosë kolegji prej tre gjyqtarësh (neni 286 parag.1).

Edhe i paraburgosuri ose mbrojtësi i tij në çdo kohë mund t'i ankojnë gjyqtarit të procedurës paraprake që të vendosë mbi ligjshmërinë e paraburgimit (neni 286 parag.2).

Gjyqtari i procedurës paraprake mund të zbatojë seancën e dëgjimit nëse në shikim të parë me ankesë vërtetohet se arsyet për

⁴ Kohëzgjatja e paraburgimit para ngritjes së aktakuzës, është rregulluar me nenin 284 parag.2 dhe 3 të KPPK-së.

paraburgim nga neni 281 i këtij Kodi që nga vendimi i fundit gjyqësor për paraburgim pushojnë së ekzistuari për shkak të ndryshimit të rrethanave ose zbulimit të fakteve të reja ose ndalimi për ndonjë arsye tjetër është i paligjshëm.

Gjyqtari i procedurës paraprake në seancë dëgjimi urdhëron lirimin e menjëhershëm të të paraburgosurit kur:

- pushojnë së ekzistuari arsyet e paraburgimit nga neni 281 i KPPK, ka kaluar afati i paraburgimit i urdhëruar nga gjykata,
- afati i paraburgimit i caktuar nga gjykata kalon afatin e paraparë në nenin 284, paragrafi 2 i KPPK apo në rrethana të jashtëzakonshme, afatin e paraparë në nenin 284, paragrafi 3 të KPPK ose,
- ndalimi për ndonjë arsye tjetër është i paligjshëm.

Gjatë kohës sa i pandehuri gjendet në paraburgim, gjyqtari i procedurës paraprake mund të lejoj që i paraburgosuri të vizitohet nga farefisi i afërm, me kërkesën e tij edhe nga mjeku, apo nga persona të tjerë (neni 294 parag.1). I paraburgosuri mund të korrespondojë ose të ketë kontakte të tjera me persona jashtë institucionit të paraburgimit me dijeninë dhe nën mbikëqyrjen e gjyqtarit të procedurës paraprake. Kur gjyqtari i procedurës paraprake refuzon vizitën e të paraburgosurit ose e ndalon komunikimin me persona jashtë institucionit të paraburgimit, i paraburgosuri mund të kërkojë nga kolegji prej tre gjyqtarësh t'i jepet leje e tillë (neni 294 parag.5).

Gjyqtari i procedurës paraprake me aktvendim mund të shqiptojë dënim disiplinor të ndalimit ose kufizimit të vizitave a korrespondencave ndaj të paraburgosurit që ka bërë shkelje disiplinore (neni 295 parag.1). Kundër këtij aktvendimi mund t'i paraqitet ankesë kolegjit prej tre gjyqtarësh në afat prej 24 orëve.

Edhe pse prokurori publik është përgjegjës për hetimin e veprave penale, sipas dispozitave të KPPK-së, gjyqtari i procedurës paraprake ka kompetenca mjaftë të rëndësishme në këtë drejtim.

Kështu, gjyqtari i procedurës paraprake duhet të njoftohet për fillimin e hetimit (221 parag.1), zgjerimin e hetimit (neni 222 parag.2),

pezullimin e hetimit (neni 223 parag.4) dhe pushimin e hetimit (neni 224 parag.2). Përveç këtyre, gjyqtari i procedurës paraprake ka kompetenca që të autorizoj zgjatjen e hetimeve, si dhe të urdhëroj dhe të kryej disa veprime hetimore.

Në këtë mënyrë gjyqtari i procedurës paraprake ka kompetenca që të lejoj zgjatjen e hetimeve, nëse për një gjë të tillë ka bërë kërkesë prokurori publik. Sipas nenit 225 parag.1 të KPPK-së, nëse hetimi nuk përfundon brenda një periudhe prej gjashtë muajve, prokurori publik i paraqet kërkesë me shkrim gjyqtarit të procedurës paraprake së bashku me arsyet për zgjatjen e hetimit. Gjyqtari i procedurës paraprake, pas marrjes së kërkesës së prokurorit publik për të lejuar vazhdimin e hetimeve, informon të pandehurin dhe të dëmtuarin me kërkesën e prokurorit publik për vazhdimin e hetimit, me ç'rast ata kanë të drejtë që brenda afatit prej 3 ditëve të paraqesin deklaratë me shkrim lidhur me vazhdimin e hetimit. Gjyqtari i procedurës paraprake mund të autorizojë një vazhdim të hetimit deri në gjashtë muaj kur kjo arsyetohet me ndërlikueshmërinë e çështjes. Për veprat penale për të cilat parashihet dënimi me të paktën pesë vjet burgim, gjyqtari i procedurës paraprake mund të autorizojë edhe një vazhdim tjetër të hetimeve deri në gjashtë muaj (neni 225 parag.2).

Derisa të merret vendim mbi vazhdimin e hetimit, prokurori publik mund të ndërmarrë veprime hetimore të cilat janë të ngutshme e që kërkojnë vëmendje. Gjyqtari i procedurës paraprake menjëherë njoftohet për veprimet e tilla hetimore (neni 225 parag.6).

Me KPPK është parashikuar se në procedurën paraprake, gjyqtari i kësaj procedure, me kërkesën e prokurorit publik (në raste të ngutshme edhe të policisë gjyqësore) mund të urdhëroj kontrollimin e një shtëpie, të lokaleve të tjera dhe të pronës së një personi kur ekziston dyshim i bazuar se personi i tillë ka kryer vepër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare dhe kur ka gjasa reale që kontrolli të rezultojë me arrestimin e këtij personi ose me zbulimin dhe konfiskimin e provave të rëndësishme për procedurën penale (neni 240 parag.1). Përveç kësaj, gjyqtari i procedurës paraprake mund të urdhëroj kontrollimin personal të një personi konkret kur ka gjasa reale se ky kontroll do të rezultojë në zbulimin e gjurmëve ose në konfiskimin e

provave të një vepre penale (neni 240 parag.3). Përmbajtja e urdhërkontrollit është përcaktuar në nenin 240 parag.5 të KPPK-së.

Përrjashtimisht, në rrethana të ngutshme, kur urdhri me shkrim për kontroll nuk mund të merret me kohë dhe nëse ekziston rrezik real për vonesë, që mund të rezultojë me humbjen e provave, ose rrezik ndaj jetës ose shëndetit të njerëzve, policia gjyqësore mund të fillojë kontrollin në bazë të lejes gojore nga gjyqtari i procedurës paraprake (neni 245 parag.3).

Kompetencë tjetër e rëndësishme e gjyqtarit të procedurës paraprake është edhe këqyrja dhe rikonstruimi⁵ i vendit të ngjarjes. Kështu, sipas nenit 254 parag.1, gjyqtari i procedurës paraprake mund të urdhëroj këqyrjen dhe rikonstruimin e vendit të ngjarjes për të shqyrtuar provat e mbledhura ose për të qartësuar faktet e rëndësishme për procedurë penale (neni 254 parag.1).

Ekspertimin në procedurë paraprake sipas dispozitës së nenit 176 parag.2, e urdhëron gjyqtari i procedurës paraprake në bazë të kërkesës së prokurorit publik, të mbrojtësit ose sipas detyrës zyrtare. Gjyqtari i procedurës paraprake ekspertimin e cakton kur për vërtetimin ose për vlerësimin e ndonjë fakti të rëndësishëm duhet të merret konstatimi dhe mendimi nga specialisti i cili posedon njohuri të nevojshme profesionale (neni 175). Në nenin 237 parag.2 të KPPK-së, është parashikuar se autopsia, kontrolli fizik, përveç rasteve nga nenet 192, paragrafët 2 deri 4 dhe 205 të këtij Kodi, kontrolli psikiatrik, kontrolli molekular dhe gjenetik dhe analizat e ADN-së, mund të urdhërohen vetëm nga gjyqtari i procedurës paraprake, përveç rasteve kur dëshmitari ose i dëmtuari pajtohet që këto veprime të ndërmerren nga policia ose prokurori publik.

Nën kushte të caktuara edhe gjyqtari i procedurës paraprake mund të merr dëshmi nga dëshmitari ose të kërkojë mendimin e ekspertit, nëse për një gjë të tillë kërkojnë prokurori publik ose i pandehuri. Kjo mundësi e gjyqtarit të procedurës paraprake është parashikuar në

⁵ Rikonstruksioni kryhet me rikrijimin e fakteve ose të situatave nën rrethanat e të cilave është zhvilluar ngjarja, bazuar në provat e mbledhura. Gjatë rikonstruksionit të ngjarjes duhet pasur kujdes që të mos shkelet ligji dhe rendi, të mos fyhet morali publik apo të vihet në rrezik jeta ose shëndeti i njerëzve (neni 254 parag.4 dhe 5).

nenin 238 të KPPK i cili emërtohet "mundësia hetuese e jashtëzakonshme". Sipas kësaj dispozite ligjore, përjashtimisht, prokurori publik ose i pandehuri mund të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprake të merr dëshmi nga dëshmitari ose të kërkojë mendimin e ekspertit me qëllim të ruajtjes së provës kur ekziston vetëm një mundësi për marrjen e provës së rëndësishme ose kur ka rrezik potencial se kjo provë nuk do të mund të merrej gjatë shqyrtimit gjyqësor. Kolegjit prej tre gjyqtarëve mund t'i paraqitet ankesë kundër mospranimit të gjyqtarit të procedurës paraprake për marrjen e dëshmisë së tillë. Në seancën e dëgjimit për marrjen e dëshmisë së tillë, të cilën e zbaton gjyqtari i procedurës paraprake duhet të jenë të pranishëm i pandehuri, mbrojtësi i tij dhe prokurori publik.

Nëse një dëshmitar apo një ekspertë nuk paraqitet ose nuk pranon të paraqitet pa arsye, me kërkesën e prokurorit publik, gjyqtari i procedurës paraprake mund t'i gjobitë, kurse dëshmitarin edhe ta burgos (neni 237 parag.2).

Edhe masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe të hetimit mund të urdhërohen nga gjyqtari i procedurës paraprake nëse plotësohen kushtet e parapara me ligj (neni 256). Përveç, gjyqtarit të procedurës paraprake, edhe prokurori publik mund të jep urdhër për disa nga masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe të hetimit (neni 258 parag.1). Mirëpo caktimi i shumicës së masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe të hetimit, sipas dispozitave të KPPK-së është kompetencë e gjyqtarit të procedurës paraprake.

Sipas nenit 258 parag.2 të KPPK-së, gjyqtari i procedurës paraprake, me kërkesë të prokurorit publik, mund të urdhërojë secilën masë të mëposhtme: fotografim të fshehtë ose vëzhgim me video në vende private, monitorim të fshehtë të bisedave në vende private, kontrollim të dërgesave postare, përgjim të telekomunikimeve, përgjim të komunikimeve nga rrjeti kompjuterik, dërgim të kontrolluar të dërgesave postare, shfrytëzimin e përcjelljes ose vendosjes së mjeteve të përgjimit, blerje të simuluar të ndonjë sendi, simulim të një veprë të korrupsionit ose zbulim të të dhënave financiare.

Në rastet e ngutshme, kur pritja e urdhrit të gjyqtarit të procedurës paraprake nga paragrafi 2 i nenit 258 të KPPK-së do të rrezikonte sig-

urinë e hetimeve ose jetën dhe sigurinë e të dëmtuarit, dëshmitarit, informatorit ose anëtarëve të familjes së tyre, prokurori publik mund të jep urdhër të përkohshëm për njëren nga masat e parapara në paragrafin 2 të këtij neni. Urdhri i tillë i përkohshëm e humb fuqinë nëse nuk konfirmohet me shkrim nga gjyqtari i procedurës paraprake brenda njëzet e katër orëve nga lëshimi. Me rastin e konfirmimit të urdhrit të përkohshëm, gjyqtari i procedurës paraprake sipas detyrës zyrtare përcakton me shkrim ligjshmërinë e tij.

Me kërkesën me shkrim të prokurorit publik, paditësit privat, paditësit subsidiar, mbrojtësit, të dëmtuarit apo dëshmitarit, gjyqtari i procedurës paraprake mund të jep masën mbrojtëse ose urdhrin për anonimitet⁶ kur ka rrezik serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin apo anëtarët e familjeve të tyre (neni 169 parag.1). Pas marrjes së kërkesës, gjyqtari mund të urdhërojë masa të përshtatshme mbrojtëse për të dëmtuarin ose dëshmitarin, e nëse ai e sheh të nevojshme para se të marrë vendim për kërkesën, thërret seancë dëgjimi të mbyllur për të dëgjuar informata shtesë nga prokurori, i pandehuri, mbrojtësi, të dëmtuarit ose dëshmitarët. Masat mbrojtëse të cilat mund t'i jap gjyqtari i procedurës paraprake janë:

- lënien bosh ose shlyerjen e emrave, adresave, vendit të punës, profesionit ose ndonjë të dhëne a informate tjetër që mund të përdoret për të identifikuar të dëmtuarin ose dëshmitarin,
- mos zbulimin e ndonjë shkrese që identifikon të dëmtuarin ose dëshmitarin,
- përpjekjen për të fshehur veçoritë ose përshkrimin fizik të të dëmtuarit apo dëshmitarit që jep dëshminë, duke përfshirë dhënien e dëshmisë prapa një mburoje jo të tejdukshme përmes pajisjeve për ndryshimin e fotografisë ose të zërit, ose marrjen në pyetje të njëkohshme nga një vend tjetër që komunikon me gjykatoren me anën e qarkut të mbyllur televiziv, ose videoregjistrimin para seancës së dëgjimit në praninë e mbrojtësit,

⁶ Anonimitet është mungesa e informatave të dhëna për identitetin ose vendndodhjen e të dëmtuarit apo të dëshmitarit, identitetin ose vendndodhjen e anëtarit të familjes së të dëmtuarit apo dëshmitarit ose identiteti i cilitdo personi që ka lidhje me të dëmtuarin apo me dëshmitarin (neni 168 parag.4 i KPPK-së).

- caktimin e pseudonimit,
- seancën e mbyllur për publikun, konform me nenin 336 të KPPK-së,
- urdhrat ndaj mbrojtësit për të mos zbuluar identitetin e të dëmtuarit ose dëshmitarit apo për të mos zbuluar ndonjë material që mund të çojë në zbulimin e identitetit,
- largimin e përkohshëm të të pandehurit nga gjykatorja nëse dëshmitari refuzon të dëshmojë në prani të të pandehurit dhe nëse rrethanat ia bëjnë të ditur gjykatës se dëshmitari nuk do ta flasë të vërtetën në prani të të pandehurit, ose
- cilido kombinim i metodave të përmendura më lart për të parandaluar zbulimin e identitetit të të dëmtuarit ose dëshmitarit.

Gjyqtari i procedurës paraprake mund të lejoj që masat mbrojtëse të ndryshohen, të anulohen apo të autorizoj dhënien e materialit të mbrojtur një gjyqtari tjetër për të përdorur në procedura tjera (neni 170 parag.4). Nëse masa mbrojtëse nga neni 170 i KPPK-së, nuk mjaftojnë për të garantuar mbrojtjen e dëshmitarit apo të dëmtuarit, gjyqtari i procedurës paraprake mund të jep urdhër për anonimitet (neni 171 parag.1 dhe neni 172 parag.1). Para se të marr urdhër për anonimitet, gjyqtari i procedurës paraprake zbaton seancë dëgjimi me dyer të mbyllura, në të cilën merren në pyetje i dëmtuari ose dëshmitari dhe personat tjerë të nevojshëm. Në këtë seancë mund të marrin pjesë vetëm prokurori publik, personeli kryesor i gjykatës dhe mbrojtësi (neni 172 parag.2).

Prokurori publik mund t'i bëjë kërkesë me shkrim gjyqtarit të procedurës paraprake për të urdhëruar që personi i caktuar të shpallet dëshmitar bashkëpunues (neni 299 parag.1).⁷ Pas marrjes së kërkesës, gjyqtari i procedurës paraprake cakton seancën e dëgjimit, në të cilin prokurori publik dhe mbrojtësi i dëshmitarit bashkëpunues mund të jenë të pranishëm për të vlerësuar besueshmërinë e dëshmitarit bashkëpunues dhe për të siguruar plotësimin e

7 "Dëshmitar bashkëpunues" do të thotë i dyshuari ose i pandehuri për të cilin ende nuk është lexuar aktakuza në shqyrtimin gjyqësor dhe i cili pritet të dëshmojë në gjykatë kur : ka gjasa të parandalojë vepra të tjera penale nga personi tjetër, ka gjasa të shpie drejt zbardhjes së të vërtetës në procedurën penale, është bërë vullnetarisht dhe me marrëveshje të plotë për të dëshmuar të vërtetën në gjykatë, është vlerësuar nga gjykata si e vërtetë dhe e plotë ose mund të shpie drejt ndjekjes së suksesshme të kryerësve të tjerë të veprës penale (neni 298).

kushteve nga neni 298 i KPPK-së. Më pas gjyqtari i procedurës paraprake me urdhër e shpallë një person si dëshmitar bashkëpunues nëse konsideron se janë plotësuar kushtet nga neni 298 i KPPK-së.

Duke u bazuar në nenin 116 parag.1 dhe 2 të KPPK-së, gjyqtari i procedurës paraprake, me propozimin e personave të autorizuar mund të marr aktvendim mbi caktimin e masave të përkohshme për sigurimin e kërkesës pasurore juridike si rrjedhojë e kryerjes së veprës penale, sipas dispozitave të zbatueshme në procedurën e përmbartimit.

Në disa raste të përcaktuara me KPPK, gjyqtari i procedurës paraprake vendos edhe lidhur me ankesën e paraqitur kundër vendimeve apo veprimeve të prokurorit publik. Kështu p.sh. sipas nenit 143 parag.3 i KPPK-së, në rastet kur prokurori publik refuzon që mbrojtësi t'i shikoj, fotokopjojë apo fotoqrafojë shkresat e lëndës, atëherë mbrojtësi mund të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprake që të lejoj shikimin ose fotokopjimin e shkresave të lëndës. Edhe i dëmtuari apo përfaqësuesi i tij ligjor ose i autorizuari, mund të paraqesin ankesë tek gjyqtari i procedurës paraprake, që të vendos lidhur me lejimin e shikimit, fotokopjimin apo fotografimin e shkresave të lëndës. Vendimi i gjyqtarit të procedurës paraprake është përfundimtar (neni 143 parag.3).

Në fund, gjyqtari i procedurës paraprake, me propozimin e prokurorit publik, mund të lëshoj letërreshtim kur i pandehuri gjendet në arrati, e kundër të cilit është filluar procedura penale për vepër penale për të cilën mund të shqiptohet sipas ligjit dënim me të paktën dy vjet burgim dhe kur është lëshuar urdhërarresti ose aktvendim për caktimin e paraburgimit (neni 544 parag.1 dhe 2).

Gjyqtari i procedurës paraprake ka edhe disa kompetenca tjera të parashikuara me KPPK, të cilat i ndërmerr në procedurën paraprake.

Shumicën e kompetencave, gjyqtari i procedurës paraprake i ushtron duke vendosur me aktvendim. Mirëpo në disa raste të caktuara, gjyqtari i procedurës paraprake autorizimet ligjore të tij i ushtron me urdhërkontroll (neni 240), urdhër (neni 116, 170, 176, 237, etj.), leje me shkrim (neni 294), letërreshtim (neni 544), leje gojore (neni 245 parag.3), etj.



Mr.sc.Albert ZOGAJ

ASPEKTE KRAHASIMORE TË PËRKUFIZIMIT TË PRONËSISË

E drejta e pronësisë paraqet njërën ndër institutet juridike më të rëndësishme të së drejtës civile në përgjithësi, respektivisht institutin juridik më të rëndësishëm të së drejtës sendore në veçanti.¹ Instituti i së drejtës së pronësisë është një institut qendror i një sistemi shoqëror-ekonomik, i një sistemi juridik.² Ky përkufizim shkencor-juridik, në mënyrë eksplicite tregon për rëndësinë e madhe që ka e drejta e pronësisë në sistemin juridik civil të pothuajse çdo vendi.

E drejta e pronësisë është institut i hershëm juridik dhe si e tillë përcaktimin me konciz e fiton në të drejtën romake, në kontekstin e asaj periudhe kohore. Edhe përkundër faktit se juristët romakë nuk e kanë dhënë definicionin e të drejtës reale, juristët klasikë kishin idenë themelore se prona duhet përcaktuar si pushtet i plotë mbi sendet ose si plena in re potestas.³ Termi "proprietas" ose pronë që etimologjikisht do të thotë ajo që i takon dikujt, lind relativisht vonë, por përpjekjet për ta përcaktuar kuptimin e pronës janë të hershme. Sipas përcaktimit që i bëjnë juristët romakë, përmbajtjen e pronësisë e përbëjnë të drejtat e përdorimit, gëzimit dhe disponimit.⁴ Duke e analizuar përmbajtjen e pronës të marrë si plena in re potestas, u pa se pronarët në bazë të së drejtës pronësore marrin kryesisht tri grupe autorizimesh: jus utendi, jus fruendi et jus abutendi.⁵

1 Abdullah Aliu, E drejta sendore (Pronësia), Prishtinë, 2004, faqe 47.

2 Ejup Stavocci, Mbrojtja e pronësisë - studime komparative, Prishtinë, 1979, faqe 65.

3 Arta Mandro, E drejta romake, Emal 2007, faqe 108.

4 Po aty, faqe 241.

5 Ivo Puhan, E drejta romake, Prishtinë, 1989, faqe 239.

Këto tri grupe të autorizimeve që i merrnin pronarët në bazë të së drejtës pronësore nënkuptonin: jus utendi - e drejta e posedimit dhe e përdorimit të sendit të tyre, jus fruendi - e drejta për të mbledhur frytet natyrale, por edhe civile të sendit të tyre dhe jus abutendi - e drejta e asgjësimit të sendit apo tjetërsimit të sendit apo të drejtën që të konstituonin ndonjë të drejtë reale për persona të tjerë.

Analizimi i këtyre të drejtave nënkupton pushtet absolut të pronarit mbi sendin.

E drejta e pronësisë përfaqëson një marrëdhënie shoqërore lidhur me sendin. Titullari i një marrëdhënieje të tillë juridike-shoqërore, ka të drejtë të plotë që të përdorë, të gëzojë, të vjelë frytet dhe të disponojë me sendin e vet.⁶

Tani në kohën bashkëkohore shkenca juridike, por edhe shumica e vendeve me ligjet e tyre e kanë definuar (përcaktuar) të drejtën e pronësisë. E drejta e pronësisë është e drejtë sendore që përmban në vete autorizime më të gjera me rastin e shfrytëzimit dhe të disponimit të një sendi.⁷ E drejta e pronësisë është e drejtë sendore, e cila titullarit të vetë (pronarit) i jep autorizimin më të plotë për çdo pushtet juridik privat, çka rendi juridik lejon dhe shteti garanton.⁸

Për rëndësinë e pronës si institut juridik, qasje e njëjtë dominon në literaturën e kohës. Pronësia midis të drejtave reale, është e drejta që përfshin më shumë tagra që subjekti mund të ushtrojë mbi sendin tagra të cilat janë potencialisht të pakufizuara.⁹ Pronësia për nga përmbajtja e vetë është e drejtë pushtet më i gjerë që i njihet pronarit mbi një send.¹⁰

Pavarësisht formulimeve që mund të hasim në shkencën juridike lidhur më të drejtën e pronësisë, në përmbajtjen e saj detyrimisht hasim në tri autorizime që kanë të bëjnë më përdorimin, shfrytëzimin dhe disponimin e një sendi. Këto tri autorizime janë të lidhura me titullarin - pronarin, i cili ka pushtetin faktik dhe juridik mbi sendin.

6 Ejup Statovci, vepra e cituar, faqe 66.

7 Andrija Gams, Bazat e së drejtës reale, Prishtinë, 1978, faqe 122.

8 Abdullah Aliu, vepra e cituar, faqe 47.

9 Francesko Galgano, E drejta private 1, Hyrje-Pronësia, Tiranë, 2003, faqe 132.

10 Vedrish Martin & Karic Petar, Gradansko pravo, Zagreb, 1998, faqe 76.

Siç u theksua edhe më lart shumica e vendeve me ligjet e tyre pozitive e kanë normuar të drejtën pronësore, po ashtu edhe në vendin tonë kjo çështje është e rregulluar me ligj. Në Kosovë, ende është në fuqi Ligji Mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore, i vitit 1980, i cili i rregullon marrëdhëniet themelore juridike-pronësore. Mirëpo meqenëse ky ligji i përket periudhës së sistemit socialist vetëqeverisës, ku marrëdhëniet juridike-pronësore janë rregulluar në frymën e atij sistemi, Kuvendi i Kosovës, në vitin 2004 ka miratuar Ligjin për të Drejtat Sendore i Kosovës me Nr.2004/31,¹¹ me të cilin rregullohen marrëdhëniet juridike-pronësore lidhur me pronën private. Meqenëse Ligji për të Drejtat Sendore i Kosovës së shpejti pritet të futet në fuqi, me ç'rast Ligji mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore, do të shfuqizohet, e shoh te arsyeshme që si pika referimi t'i kem të dy ligjet ngase kjo edhe i shërben komperativitetit të çështjes.

Me Ligjin mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore, thuhet: "pronari ka të drejtë që sendin e vet ta mbajë, ta shfrytëzojë dhe të disponojë në kufijtë e caktuar me ligj".¹²

Me ligjin për të drejtat sendore në Kosovë, pronësia definohet: "Pronësia është e drejtë e tërësishme në një send. Pronari mund të disponojë sipas dëshirës së tij, veçanërisht atë ta posedojë dhe ta përdorë, më atë disponim dhe të tjerët t'i përjashtojë nga çfarëdo ndikimi, nëse nuk kundërshtohet nga ligji ose nga e drejta e një të treti".¹³

Ky përkufizim ligjor për definimin e pronësisë përgjithësisht i përgjigjet përcaktimeve që kanë ligjet e vendeve bashkëkohore sidomos vendet që i përkasin sistemit kontinental, e që në njëfarë mënyre janë nën ndikimin e kodeve civile të Francës, Gjermanisë, Italisë, Zvicrës etj.

Përmbajtja e pronësisë, në kuptimin e rregullimit ligjor dhe në kuptimin e autorizimeve që i njihen pronarit, sipas Ligjit për të Drejtat Sendore i Kosovës, po interferon më përmbajtjen e disa kodeve civile dhe ligjeve pozitive, atëherë si pika krahasuese jap edhe përkufizimet që paraqesin disa kode civile.

11 Ligji për të Drejtat Sendore i Kosovës, me Nr.2004/31,-(ende nuk është në fuqi, ngase nuk është nënshkruar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm)

12 Ligji mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore, Gazeta Zyrtare e RSFJ-ës, nr. 6/80), neni 3

13 Ligji për të Drejtat Sendore i Kosovës, (nr. 2004/31), neni 17 pika 1, - (ende pa hyrë në fuqi).

Kodi Civil Francez, (neni 544): "Pronësia është e drejtë e gëzimit dhe disponimit me sendet në mënyrën më absolute të mundshme, në mënyrë që të mos bëhet ajo çka është e ndaluar me ligje ose dispozita tjera".¹⁴

Kodi Civil Zvicëran, parasheh: "Kush është pronar i një sendi mund të disponojë me atë send sipas dëshirës së tij, në kufijtë e sendit juridik".¹⁵

Kodi Civil Gjerman parasheh, (paragrafi 903): pronari i ndonjë sendi mundet, nëse ajo nuk është në kundërshtim me ligjin dhe të drejtat e të tjerëve, me atë të silltet si ta ketë dëshirën dhe të tjerët t'i përfshijë nga çdo veprim mbi sendin".¹⁶

Edhe vendet e rajonit, fqinjë me Kosovën, si vende që kanë lënë sistemin socialist të qeverisjes dhe kanë pranuar sistemin demokratik me ligjet e tyre post-komuniste kanë pranuar frymën dhe parimet e kodeve civile si të atij francez, gjerman, italian etj.

Republika e Shqipërisë në Kodin Civil përcakton: "Pronësia është e drejtë për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet brenda kufijve të caktuar me ligj".¹⁷

Është me rëndësi të theksohet se Mbretëria Shqiptare, në vitin 1929, kishte nxjerrë kodin civil, ku ndër të tjera jep edhe përkufizimin për pronësinë: "Zotnimi asht e drejta me gezue e me disponua sendet pa asnjë kufizim tjetër, jasht atyne qe caktohen me ligj ose me rregullore".¹⁸ Lehtë mund të konkludohet se Shqipëria mjaft herët kishte filluar ndërtimin e një sistemi të mirëfilltë juridiko-civil, por periodha e diktaturës kishte rrënuar të tërë sistemin paraparak..

Edhe Maqedonia, në Ligjin për pronësinë dhe të drejtat sendore, përcakton: "pronari ka të drejtë që sendin e vetë ta mbajë, tërësisht ta shfrytëzojë dhe të disponojë me të sipas dëshirës së tij, në qoftë se kjo nuk është në kundërshtim me ligjin ose me ndonjë të drejtë të personit tjetër".¹⁹

14 Kodi Civil i Francës.

15 Kodi Civil i Zvicrës.

16 Kodi Civil Gjerman.

17 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë"(1994, ndryshuar 1999 dhe 2001), neni 149

18 Kodi Civil, i Mbretërisë Shqiptare, (1929), neni 794, Toena, Tiranë, 1998.

19 Zakon za sopstvenost i drugite stvarim prava, su beni Vesnik na Republika Makedonija, (18/2001).

Nga studimi i përkufizimit të pronësisë sipas përcaktimeve ligjore që kanë paraparë vendet e ndryshme, në rastin konkret vendet e lartcekura, shihet vërtet se formulimi mund të dallojë, por përmbajtja është e përafërt.

Përveç se përmbajtja e përkufizimit të pronësisë është e përafërt në mes të ligjeve pozitive, kjo përmbajtje është e përafërt edhe me formulimin që i kanë bërë juristët romakë të drejtës pronësore, përveç se tani çështja shtrohet në rrethana krejt tjera ekonomike dhe shoqërore.

**Arsim HAMZAJ**

DEKLARATA UNIVERSALE E TË DREJTAVE TË NJERIUT, ROLI I SAJ NË MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE INTERVENIMI HUMANITAR

Miratimi i Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut nga ana e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, paraqet një arritje tejet të rëndësishme në shumë aspekte. Për herë të parë në një organizatë ndërkombëtare që arritur pajtimi për një deklaratë të përbashkët mbi të drejtat e njeriut, e cila pretendonte që juridikisht t'i obligonte të gjitha palët e saj. Deklarata që përgatitur për një kohë tejet të shkurtër krahasuar me tekstet e tjera të të drejtave të njeriut. Mizoritë e luftës së dytë botërore, me represionin dhe brutalitetin e saj intensiv dhe të pa besuar, siguruan bazën e drejtpërdrejtë "morale" për hartimin dhe miratimin e Deklaratës së Përgjithshme të të Drejtave të Njeriut, ndërkaq realizimin e saj e bënë të mundur personalitetet e përkushtuara dhe të afta, të cilat ishin të involvuara në këtë proces si dhe vet rrethanat kohore. Përfaqësuesit e disa shteteve si: Kina, ish-BRSS, SHBA dhe ish-Jugosllavia, ishin mbështetësit më të zëshëm të dokumentit për të drejtat e njeriut në formë të deklaratës, i cili formalisht do të ishte jo obligues. Përkundër këtyre delegatët nga India, Australia dhe Britania e Madhe ishin përkrahësit më të fuqishëm të konventës obliguese. Ndërsa përfaqësuesit e Kilit, Egjiptit, Francës dhe Uruguait mbanin pozicion ndërmjetësues. Ata dëshironin formën e kombinuar të deklaratës dhe të konventës. Ata nuk e ndanin mendimin se Konventa ishte më e preferueshme se Deklarata, për shkak se kjo e dyta formalisht nuk obligon.

Përkundër shteteve të cilat e mbronin Deklaratën, për shkak se ato qartazi nuk dëshironin dispozita tepër të fuqishme (ngase i frikësoheshin ndërhyrjes në çështje të brendshme), pozicioni i Francës ishte pragmatik. Delegacioni i saj nuk kundërshtonte Konventën obliguese, por konsideronte se Deklarata ishte më e favorshme për atë kohë, sepse Deklarata do të shkruhej menjëherë si fazë e pare ku ajo shumë shpejtë do ta zgjonte opinionin publik dhe do të shërbente si udhërrëfyes për politikën e ardhshme të shteteve. Kështu strategjia "së pari Deklaratë e pastaj Konventë" fitoi në praktikë.

Megjenëse Deklarata e Përgjithshme (Universale) për të Drejtat e Njeriut është miratuar në formë të rezolutës, e jo në formë të traktatit ndërkombëtar, që nga dita e parë janë shfaqur dallime lidhur me atë se a janë dispozitat e Deklaratës të obligueshme apo jo. Një grup autorësh, duke u mbështetur në tekstin e Deklaratës, e cila është shpallur si "ideal i përgjithshëm" ia mohonin vlerën juridike, për arsye se Deklarata nuk imponon detyrime juridike e as që përmban mjete ligjore për të siguruar zbatimin e saj. Autorë të tjerë dispozitat e Deklaratës i konsideronin si burim juridik joformal, të cilat do të marrin vlerën juridike kur të hyjnë në fuqi Paktet për të Drejtat e Njeriut. Megjithatë, asnjëri nga këta autorë nuk e ka kontestuar vlerën e saj të lartë morale.

Megjenëse Deklarata e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut është miratuar në formë të Rezolutës e jo të traktatit ndërkombëtar, ajo ka luajtur një rol shtytës dhe ka pasur ndikim në zhvillimin e të drejtave të njeriut, si në planin e brendshëm ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Kjo shihet nga fakti se shumica e dokumenteve më të rëndësishme nga fusha e të drejtave të njeriut që janë miratuar më vonë, kanë qenë të frymëzuara dhe janë mbështetur në qëllimet dhe parimet e Deklaratës së Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut. Këtu bëjnë pjesë: Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Deklarata për të Drejtat e Fëmijëve, Konventa kundër Diskriminimit në fushën e arsimit, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, etj.

Deklarata për të drejtat e njeriut është e garantuar edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Dallimi në mes të Deklaratës së Përgjithshme (Universale) për të Drejtat e Njeriut dhe dokumenteve të tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Deklarata e Përgjithshme (Universale) për të Drejtat e Njeriut ndryshon nga dokumentet e tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, sepse kjo ka qenë e miratuar dhe e proklamuar në formë të rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, e jo në formë të traktatit apo të ndonjë pakti me anë të të cilave shtetet merrnin detyrime ndërkombëtare.

Deklarata e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut ndryshon nga Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, ngase Deklarata përmban të gjitha të drejtat civile dhe politike, si dhe të drejtat ekonomike sociale dhe kulturore, ku për herë të parë provohet që ngushtësisht të ndërlidhen këto kategori socio - politike. Ndërsa Paktet përmbajnë vetëm të drejtat civile dhe politike, përkatësisht të drejtat ekonomike sociale dhe kulturore. Kjo pra (Deklarata e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut) ka qenë një ndër dokumentet e para ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, e cila ka qenë bazë për nxjerrjen edhe të shumë dokumenteve të tjera të mëvonshme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Intervenimi humanitar

Intervenimin humanitar e hasim qysh tek mendimtarët e kohërave të vjetra. Intervenimi humanitar lejohet çdo herë nëse ka për qëllim të pengohen mizoritë e neveritshme ose të ndalen krimet e një shteti kundër një popullsie të tërë, ose kur në një vend mungon një minimum i rendit moral.

Intervenimi humanitar ka funksionin e dënimit të shtetit ose të kombit keqbërës që është i prirur tu shkaktojë dëme të tjerëve, e që i jep të drejtë të gjithë të tjerëve të bashkohen për ta ndëshkuar dhe parandaluar atë që të shkaktojë dëme të mëtejme. Intervenimi humanitar është konsideruar si interes i shoqërisë njerëzore. Nga kjo del se çdo herë kur shkeljet sistematike dhe masive të të drejtave të njeriut dhe të

drejtave të pakicave, mund të kualifikohen si kërcënim për paqe, qoftë për shkak të rrezikut të internacionalizimit të konfliktit të brendshëm, qoftë për shkak se pasojat negative i tejkalojnë kufijtë (fluksi masiv i refugjatëve), Këshilli i Sigurimit mundet në bazë të kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, të autorizojë ndërmarrjen e masave që përfshijnë edhe përdorimin e forcës së armatosur.

Në kohën bashkëkohore, sfidë të madhe për OKB-në dhe për të gjitha shtetet e tjera, paraqet vazhdimësia e shkeljeve të rënda të drejtave të njeriut nëpër pjesë të ndryshme të botës (në formë të gjenocidit, urisë, torturës, etj). Prandaj fokusi i përpjekjeve globale do të duhej të përqendrohej në luftimin e praktikave të tilla dhe të sjelljes së kriminelëve para drejtësisë. Nga kjo perspektivë, themelimi i një gjykate ndërkombëtare - siç ishte vendosur nga Konferenca e plotfuqishme për themelimin e Gjykatës Ndërkombëtare, të organizuar nga Kombet e Bashkuara në Romë (qershor - korrik 1998) është me rëndësi fundamentale. E tillë është edhe gatishmëria e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe trupave të tjerë politik, për të ndërmarrë masa, nëse është nevoja edhe përmes përdorimit të forcës ushtarake, për ti luftuar shkeljet e rënda. Zhvillimet në ish-Jugosllavi prej vitit 1993 demonstuan se çfarë mund të ndodhë nëse reagimi i bashkësisë ndërkombëtare është tepër i vonë dhe jo efikas.

Karta e OKB-së ndalon përdorimin e forcës në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe i fton palët që ato ti zgjidhin në mënyre paqësore. Mirëpo në rast se një mosmarrëveshje është e tillë që mund të rrezikojë e të prishë paqen dhe sigurinë në botë, atëherë Këshilli i Sigurimit mund të urdhërojë ndërmarrjen e masave tjera duke përfshirë edhe intervenimet me forca ushtarake, të cilat i gjykon si të nevojshme për ruajtjen ose për rikthimin e paqes e të sigurisë. Kjo ishte manifestuar shumë qartë me rastin e Kosovës në vitin 1999. Por, fatkeqësisht ky nuk ishte rasti edhe me Ruandën (1994-1995) ku vetëm për tre muaj janë zhdukur mbi 500.000 deri një milion pjesëtarë të fisit Tutsi, apo për Republikën e Bosnjës dhe Hercegovinës (1992-1995), ku janë vrarë mbi 200.000 vetë, ndërsa janë përzënë me shumë se 2,5 milionë të tjerë, vetëm pse ishin të një kombësie, të një fisi, race, feje apo gjuhe tjetër. Nga kjo del se praktika shkon në favor të së drejtës së intervenimit për shkaqe humanitare.

Siç edhe e thamë në fillim, intervenimi humanitar qysh herët është konsideruar interes i shoqërisë njerëzore, pra edhe para miratimit të Kartës së OKB-së. Kështu fuqitë e mëdha si Franca, Britania e Madhe, Rusia etj., kanë intervenuar në luftë për çlirimin e Greqisë nga okupimi otoman në vitin 1927 i cili edhe konsiderohet si një ndër rastet e para të intervenimit humanitar.

Shumë autorë e përkrahin të drejtën e intervenimit humanitar, ku disa mendojnë se intervenimi duhet të jetë edhe i shpejtë nëse dëshirohet të pengohen shkeljet masive të të drejtave të njeriut si: aparteidi, gjenocidi, vdekjet nga uria etj. Ndërsa për dallim nga grupi i autorëve të lartpërmendur, disa të tjerë mendojnë se intervenimi i armatosur për qëllime humanitare është i ndaluar dhe jo legjitim ngase nuk është i autorizuar nga Karta e OKB-së. Kjo ngase duke u bazuar në të drejtën e "intervenimit humanitar" shumë shtete të forta e kanë keqpërdorur këtë të drejtë për okupimin e shteteve të tjera. Mirëpo pavarësisht kësaj, Karta e OKB-së, në kapitullin VII, lejon edhe përdorimin e forcës së armatosur, në qoftë se nuk ka ndonjë rrugë tjetër për zgjidhjen e ndonjë mosmarrëveshje e cila rrezikon paqen dhe sigurinë e ndonjë rajoni apo të botës në përgjithësi.



Burim ÇERKINI

TENTATIVA SI FAZË E KRYERJES SË VEPRËS PENALE

Hyrje

E drejta penale, si degë e legjislacionit pozitiv të një shteti dhe si pjesë e sistemit të shkencave juridike, është një sistem normash ligjore me të cilat përcaktohet se cilat veprime të njerëzve konsiderohen vepra penale dhe çfarë lloje të sanksioneve penale do tu shqiptohen kryesve të tyre. Ajo merret me kuptimin e veprës penale dhe të figurës së saj, me elementët përbërëse të kësaj figure, të cilët janë faktorët kryesorë që shërbejnë si bazë për të vënë një person përpara përgjegjësisë penale.¹

Me luftën kundër fenomenit penal merren edhe degë të tjera të së drejtës, si kriminologjia, penologjia, kriminalistika, etj. E veçanta për të drejtën penale është se ajo përcakton kushtet e përgjithshme dhe të veçanta sipas të cilave një vepër mund të konsiderohet vepër penale, sanksionet që parashikohen për autorët e tyre, si dhe rrethanat e veçanta (lehtësuese dhe rënduese) që duhet të kihen parasysh nga gjykata, në procesin e caktimit të tyre rast pas rasti.

Duke përcaktuar veprën penale, si veprim shoqërisht të rrezikshëm, të parashikuar me ligj, kjo degë e së drejtës pozitive të çdo shteti

¹ Dr. Ismet Salihu, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2003, faqe 25.

është bazë për një luftë efektive kundër kriminalitetit. Kjo degë synon të vendosë përpara përgjegjësisë penale ata persona që kryejnë vepra, të cilët i plotësojnë kushtet e cekura më lartë dhe si rrjedhojë garanton ligjshmërinë në procesin penal.

E drejta penale si shkencë juridike dhe degë e së drejtës pozitive ndahet në dy pjesë, në pjesën e përgjithshme dhe në pjesën e posaçme. Kjo ndarje është si rrjedhojë edhe e faktit se të gjitha kodet penale të shteteve bashkëkohore ndahen në pjesën e përgjithshme dhe të posaçme. Edhe Kodi Penal i Kosovës² është i ndarë në këto dy pjesë:

1. Pjesën e përgjithshme e përbëjnë dispozitat e karakterit të përgjithshëm që u referohen veprave penale, përgjegjësisë penale dhe sanksioneve penale.
2. Pjesa e posaçme, e cila ka për objekt studimin e figurave konkrete të veprave penale të parashikuara në dispozitat e veçanta të pjesës së posaçme, sidomos elementët përbërës të tyre, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese në të cilat kryhen veprat penale nga persona konkretë.

Një nga të arriturat në të cilat vihet në dukje kujdesi që tregon e drejta penale për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të individit të mbrojtura me Kushtetutë, Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe me akte të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, është dhe kontributi që ajo jep lidhur dhe me përcaktimin e fazave të kryerjes së veprës penale apo fazave paraprake të kryerjes së veprës penale. Faza kryesore dhe ndoshta më e rëndësishmja prej tyre, të cilën do ta trajtojmë më poshtë është "tentativa".

Për të kryer një vepër penale, personi kalon nëpër një proces paraprak të veprimtarisë kriminale, duke filluar që nga lindja e mendimit për të kryer një vepër penale, shfaqja e këtij mendimi në botën e jashtme, ndërmarrja e veprimeve përgatitore, tentativa për të kryer veprën, dhe në fund, arritja e rezultatit të dëshiruar kriminal.

Tentativa është veprimi që ka synuar drejtpërsëdrejti në kryerjen e veprës, por kjo nuk është kryer për shkaqe që nuk varen nga vullneti

2 Kodi Penal i Kosovës, ka hyrë në fuqi me 06.04.2004 (në tekstin e mëtejshëm KPK).

i personit. Në fakt, kur vepra penale ka mbetur në tentativë do të thotë se, nuk kanë ardhur pasojat e dëshiruara, për shkaqe të pavarura nga vullneti i subjektit që ka ndërmarrë veprimet. Por kjo nuk nënkupton mos përgjegjësinë e subjektit që ka tentuar të kryejë një vepër penale të caktuar.

Vështrim historik i institutit të tentativës

Në historinë e së drejtës penale, institutin e tentativës e hasim njëkohësisht me institutin e veprës penale. Nëse do ti hidhnim një vështrim historisë të së drejtës penale do të vinim re se fazat e veprimtarisë paraprake kriminale, apo fazat para kryerjes së veprës penale, janë dënuar në mënyra të ndryshme në kohë të ndryshme historike.

Në periudhën skllavopronare personi dënohej jo vetëm për veprën penale të kryera në mënyrë të plotë, por edhe për veprimtarinë paraprake kriminale.

E drejta skllavopronare dënonte përgatitjen dhe tentativën. Kjo e drejtë dënonte dhe mendimin e shprehur në botën e jashtme edhe pse ai nuk shoqërohej me ndonjë veprim konkret.

E drejta penale feudale, në përgjithësi, dënonte njëlloj sikur vepra penale të kish përfunduar, si përgatitjen ashtu dhe tentativën. Ajo dënonte shfaqjen e mendimit në botën e jashtme dhe shkonte edhe më tutje se e drejta skllavopronare. Sipas kësaj të drejtë, personi dënohej edhe kur dyshohej se në mendjen e tij kishte lindur një mendim që ishte në kundërshtim me interesat e klasës në fuqi, sidomos me dogmat fetare. Mjaftonte që dikush të dyshohej se nuk pajtohej me interpretimin zyrtar të dogmave fetare për të përfunduar i djegur në turmën e druve.

Pas revolucionit francez të shek.XIX, ideologë të ndryshëm i shpallën luftë arbitraritetit të së drejtës penale feudale.

Ata ngritën parimin "*nullum crimen sine lege*", sipas të cilit nuk mund të konsiderohej vepër penale një vepër e cila nuk parashikohej si e tillë nga vetë ligji. Si një e arritur shumë e madhe e kësaj periudhe

është edhe parimi se mendimi i shfaqur në botën e jashtme nuk mund të konsiderohej vepër penale dhe personi nuk mund të dënohej vetëm për shfaqjen e atij mendimi.

E drejta penale e kësaj periudhe shpalli se, fazat e përgatitjes së veprës penale, në pjesën më të madhe të rasteve ishte e padënueshme.

Sipas saj, dënimi duhej të zbatohej, si rregull, vetëm atëherë kur personi kishte tentuar të kryente një vepër e cila, sipas ligjit konsiderohej vepër penale.

Në viset shqiptare, nga fillimi shek. XV, nëpër vendet e pushtuara nga Perandoria Osmane vepronte Sheriati, i cili ishte i bazuar në Kur'anin. Karakteristikë në këtë kohë ishte papërcaktueshmëria e dënimeve, të cilat mund t'i ketë dhënë Kadiu sipas bindjes së tij, në mbrojtje të interesave të klasës sunduese që ai përfaqësonte.

Në viset shqiptare ky Ligj zbatohet në qytete dhe në ato zona të cilat ishin të pushtuara nga Turqit, kurse në zonat malore, të cilat nuk iu nënshtruan administratës së huaj vazhdonte të vepronte e drejta zakonore penale e shqiptarëve.

Në historinë e së drejtës zakonore, zakonet janë konceptuar si tërësi e normave të pashkruara, të përcjella në traditën nga njëri brez në tjetrin.

Burimet e së drejtës zakonore shqiptare të njohur deri tani janë: Kanuni i Skënderbeut, Kanuni i Lekë Dukagjinit, Kanuni i Maleve dhe Kanuni i Labërisë.

Të gjitha këto Kanune, pa përjashtim, parashikonin një varg normash më karakter penal, por ndër këta vend kryesor ka zënë Kanuni i Lekë Dukagjinit.

Sipas kanunit, vepra penale mund të kryhej si me veprime aktive ose me mosveprime. Për disa vepra penale kërkohet ardhja e pasojës, si p.sh. vdekja e viktimës në vrasje, kurse për të tjera, vepra penale mund të mbetet në tentativë.³

3 Dr. Ismet Elezi, Zhvillimi historik i legjislacionit penal në Shqipëri, Tiranë, 1998, faqe 22.

Lidhur më fazat e zhvillimit të veprës penale, Kanunet flisnin për përgatitjen, por për këtë fazë nuk parashikohej përgjegjësi penale. Si fazë e parë e kryerjes së veprës penale pranohej tentativa dhe pastaj vepra e kryer (e përfunduar).

Tentativa dallohej në disa lloje:

- kur një person qëllonte me pushkë një tjetër dhe plumbi i shkonte pranë, ai detyrohej të shpërblente gjysmën e gjakut,
- kur një person qëllonte kundërshtarin, por pushka nuk i shkrepse, sepse fisheku nuk ishte i përshtatshëm, fajtori përgjigjej njëlloj si për krim të kryer,
- kush qëllonte mbi një kufomë përgjigjej për dy gjaqe: për tentativë vrasje dhe për fyerje të të vdekurit⁴.

Në kohën e re (sotme) ka pasur një ngritje edhe më të madhe të parimit "nullum crimen nulla poena sine lege" dhe një zhvillim edhe me tutje të fazave të kryerjes së veprës penale si dhe ndëshkueshmërisë së këtyre fazave.

Sipas teorisë të së drejtës penale, prej momentit kur tek individi lind mendimi për të kryer veprën penale dhe deri në momentin e kryerjes së veprës penale, respektivisht deri në momentin e shkaktimit të pasojës (në rastin e veprave penale materiale) së dënueshme, mund të ekzistojnë disa faza, dallimi dhe përkufizimi i të cilave ka rëndësi të madhe. Në literaturë zakonisht njihen katër faza të cilat, në të shumtën e rasteve shprehen gjatë kryerjes së veprës penale.

Këto faza janë⁵:

1. Vendimi për të kryer veprën penale,
2. Veprimet përgatitore të cilat ndërmerren me qëllim të kryerjes së veprës penale;
3. Fillimi i kryerjes së veprës penale që mund të mbetet edhe në tentativë;
4. Kryerja e veprës penale (delictum consummatum).

Edhe pse, sikundër u përmend, veprimtaria kriminale kalon nëpërmjet disa momente të tjera, të brendshme, që kanë të bëjnë me vull-

4 Kanuni i Leke Dukagjinit, i përmbledhur nga Shtjefën Gjeqovi.

5 Dr.Ismet Salhiu, vepra e cituar, faqe 337.

netin e autorit të veprës penale (lindja dhe shfaqja e mendimit) për të drejtën penale, në përgjithësi interes paraqesin fazat, duke filluar nga marrja e vendimit për të kryer veprën penale. Rëndësi praktike dhe interes, për sa i përket marrjes në përgjegjësi penale paraqesin në disa raste : faza përgatitore dhe për të gjitha veprat penale që kryhen me dashje, tentativa.

Kuptimi i tentativës

Tentativa si përkufizim është dhënë në nenin 20 të KPK-së. Sipas tij *"Kushdo që me dashje ndërmerr veprime të drejtpërdrejta për kryerjen e veprës penale dhe vepra nuk është kryer ose elementet e veprës së qëllimshme penale nuk janë realizuar, ai konsiderohet se ka tentuar të kryejë vepër penale"*.

Në teorinë e së drejtës penale sa i përket shkaqeve që e arsyetojnë ndëshkimin e tentativës ekzistojnë apo janë parashtruar tri teori :

1. teoria objektive,
2. teoria subjektive dhe
3. teoria objektivo-subjektive.

Sipas teorisë objektive, tentativa paraqet rrezikim të të mirës juridike që është e mbrojtur me të drejtën penale. Pra rrezikimi i të mirës materiale është esenca e tentativës, rrezikim ky i cili e arsyeton ndëshkimin. Intensiteti i rrezikshmërisë së tentativës varet nga lloji i veprës penale të tentuar.

Sipas teorisë subjektive, tentativa mbështetet në vullnetin e personit që të kryejë vepër penale, vullnet ky i cili është manifestuar në botën e jashtme. Sipas kësaj teorie personi duhet që të dënohet për tentativën e veprës penale ngase e ka manifestuar vullnetin e tij kriminal.

Teoria objektivo-subjektive është bashkim e këtyre dy teorisë. Sipas saj kryesi i tentativës dënohet për shkak se e ka rrezikuar të mirën materiale dhe për shkak se me atë rast e ka manifestuar vullnetin e tij kriminal për të kryer veprën penale.

Në aspektin juridiko penal, për tu konsideruar se është kryer tentativa e veprës penale, duhet që të përmbushen tri kushte⁶:

- a) që të ndërmerret veprimi i kryerjes së veprës penale ,
- b) që veprimi të ndërmerret me dashje dhe
- c) vepra të mos përfundohet , përkatësisht të mos shkaktohet pasoja.

Nëse këto tri kushte përmbushen mund të themi se është kryer tentativa e veprës penale. Mirëpo, meqë në tentativa njëri nga kushtet është të mos shkaktohet pasoja e veprës penale, në teorinë e së drejtës lindin dilema se cilat janë shkaqet që e arsyetojnë ndëshkimin e tentativës.

- a. Kushti i parë për ekzistencën e tentativës ishte ndërmarrja e veprimeve të drejtpërdrejta për kryerjen e veprës penale.

Nuk mund të kemi tentativë të kryerjes së veprës penale , kur akoma nuk janë krijuar kushtet që autori i krimit të mund të vepron drejtpërsëdrejti mbi objektin. Para kësaj kohe akoma jemi në një fazë tjetër, në veprimet përgatitore për kryerjen e veprës penale të subjektit. Por në momentin që ai vepron drejtpërdrejt mbi ndonjë të mirë shoqërore e cila është e mbrojtur nga ligji penal dhe nuk arrin të realizojë qëllimin e tij d.m.th. përfundimin e veprës për shkaqe të cilat nuk varen nga vullneti i tij, në atë rast kemi të bëjmë me tentativë.

- b. Kushti i dytë në aspektin e së drejtës penale është që tentativa konsiderohet se është kryer vetëm kur veprimet e drejtpërdrejta për kryerjen e veprës penale të jenë kryer me dashje.

Pra kërkohet që personi të jetë i vendosur për të kryer veprën, si dhe i vetëdijshëm për të gjitha tiparet e veprës penale konkrete si dhe ta dëshiron atë.

Ekzistenca e dashjes tek tentativa presupozon që, personi parashikon pasojat e veprës penale dhe dëshiron ardhjen e tyre duke u përpjekur kështu për të kryer veprën penale konkrete, të ndërmarrë veprime të drejtpërdrejta për të realizuar atë çfarë ai kishte parashikuar.

6 Dr.Ismet Salihu, vepra e cituar, faqe 342.

Nga kjo nuk mund të konsiderohet se ekziston tentativa nëse personi nuk ka vendosur të kryejë veprën e caktuar, edhe pse i ka ndërmarrë disa veprime, p.sh. kur personi nxjerr nga këllëfi thikën dhe i drejtohet tjetrit, por akoma nuk ka vendosur të godasë mbi të.

Sikurse që u theksua më lart, në tentativë veprimi mund të drejtohet drejtpërsëdrejti në realizimin e veprës vetëm atëherë kur subjekti ka parashikuar ardhjen e pasojës dhe kur ai e ka dëshiruar ardhjen e kësaj pasoje. Për këto arsye, me të drejtë është pranuar në teorinë e së drejtës sonë penale se tentativa, si fazë paraprake e kryerjes së veprës penale, kryhet gjithmonë me dashje direkte.

Lind pyetja se a mund të kemi tentativë të kryer me dashje eventuale (indirekte)?

Në lidhje me të ka pasur mendime të ndryshme.

Disa autorë pranojnë mundësinë e kryerjes së tentativës me dashje eventuale, por thonë se në praktikë është e vështirë të vërtetohet se personi ka tentuar me dashje eventuale të arrijë një rezultat të caktuar, shoqërisht të rrezikshëm. Sipas mendimit të tyre tentativa mund të kryhet si me dashje direkte ashtu dhe më dashje indirekte. Ja një shembull, do të kemi vepër penale të tentim vrasjes, me dashje indirekte në ato raste, kur subjekti qëllon me armë zjarri kundër personit që ai dëshiron ta vrasë, kur ky ndodhet shumë afër me një shok të tij. Në këtë rast kur subjekti qëllon kundër personit që e dëshiron vrasjen e tij, ai vepron me dashje direkte, por në të njëjtën kohë ai mund të parashikon se plumbi mund të prekë dhe personin tjetër, i cili ndodhet pranë tij. Megjithëse vrasjen e këtij personi, nuk e dëshiron, këta autorë shprehin se subjekti duke qëlluar kundër një personi, lejon më ndërgjegje edhe vrasjen e personit tjetër. Për këto arsye, vazhdojnë këta autorë, në qoftë se personi tjetër nuk vritet, në të tilla raste ndodhemi përpara tentativës së vrasjes me dashje eventuale.

Autorë të tjerë, mendimet e të cilëve përputhen më qëndrimet e të drejtës sonë penale, shprehin se tentativa nuk mund të kryhet me dashje eventuale. Është praktikisht e pamundur të vërtetohet se personi i cili ka vrarë ose ka tentuar të vrasë një person, vrasjen e të cilit

e dëshironte, që ndodhet pranë një personi tjetër, ka tentuar me dashje eventuale të vrasë edhe këtë person. Në tentativë, veprimi duhet të drejtohet drejtpërsëdrejti në realizimin e veprës penale vetëm atëherë kur personi ka parashikuar se me anën e atij veprimi do të arrihet një rezultat i caktuar shoqërisht i rrezikshëm, rezultat të cilin personi e ka dëshiruar.

Sa i përket asaj se a kemi tentativë të veprës penale pakujdesia, në të drejtën penale dhe në mendimet e shume autorëve mbizotëron mendimi që nuk mund të ketë vepër penale të mbetur në tentativë kur personi vepron nga pakujdesia në të dy format e saj.

- c. Kushti i tretë i cili duhet për t'u konsideruar se ekziston tentativa, është që të mos shkaktohet pasoja e veprës penale të cilën personi ka dashur ta shkaktoj me veprimin e ndërmarrë. Përndryshe nëse është shkaktuar pasoja e veprës penale atëherë nuk mund të bëhet fjalë për fillimin e veprës penale, përkatësisht tentativën, por për veprën penale të përfunduar - të kryer.

Në praktikë ka raste kur vepra penale e dëshiruar nuk përfundohet, por veprimet e personit i cili i ka ndërmarrë kanë shkaktuar pasojat e cila i ka përmbush të gjitha elementet e një vepre tjetër penale. Atëherë, në këtë rast për tu konsideruar se cila vepër penale është kryer si bazë merret elementi subjektiv, dashja e atij personi, se cilën vepër ka dashtë që ta kryej, p.sh. personi A shkrep me armë në drejtim të personit B, me qëllim që ta privoj nga jeta dhe e godet në këmbë, ku i shkakton lëndim të rëndë trupor. Në këtë rast edhe pse janë përmbushur të gjitha elementet e veprës penale lëndimi i rëndë trupor të shkaktuar me armë zjarri, këtu kemi të bëjmë me veprën penale vrasje në tentativë, sepse qëllimi apo dashja e personit A ka qenë që personin B ta privoj nga jeta.

Veprat penale te të cilat nuk është e mundur tentativa

Në teorinë e së drejtës penale dhe në praktikën gjyqësore konsiderohet se tek disa vepra penale nuk është e mundur tentativa.⁷ Kryesisht njihen dy grupe të veprave penale tek të nuk është e mundur tentativa.

7 Dr. Ismet Salihu, vepra e cituar, faqe 348.

Grupin e parë e përbëjnë ato vepra penale tek të cilat konsiderohen se janë kryer nëse janë ndërmarrë veprimet përgatitore. Vepra të tilla janë krimet e luftës, kundër njerëzimit, gjenocidi etj., ndërsa grupin e dytë e përbëjnë ato vepra të cilat në teori njihen edhe si vepra penale formale, tek të cilat për shkak të natyrës së këtyre veprave nuk është e mundur tentativa, p.sh. nuk është e mundur tentativa veprës penale të shpifjes, pjesëmarrjes në rrahje, fyerjes, disa veprave në komunikacion e të cilat shkaktohen nga pakujdesia, etj.

Një dilemë që është në teorinë e së drejtës penale dhe në praktikën gjyqësore e që kemi mjaft mendime të ndara është dënueshmëria e tentativës tek veprat penale të cilat kryhen me mosveprim.

Sipas disa autorëve për shkak të natyrës specifike të këtyre veprave nuk është e mundur tentativa te veprat penale të cilat kryhen vetëm me mosveprim e që njihen vepra penale të drejta me mosveprim, p.h. mosdhënia e ndihmës mjekësore.

Ndëshkimi i tentativës sipas Kodit Penal të Kosovës

Në nenin 20 parag.2 të KPK-së, përkufizohet dënueshmëria e tentativës. Sipas këtij paragrafi, tentativa për kryerjen e një vepre penale të dënueshme me së paku tre vjet burgim, dënohet, kurse lidhur me veprat tjera penale tentativa dënohet vetëm nëse ligji e parasheh shprehimisht këtë.

Nga kjo dispozitë e KPK-së rezulton se në të drejtën tonë penale nuk ndëshkohet tentativa tek të gjitha veprat penale. Për tentativë personi do të dënohet vetëm kur është fjala për veprat penale më të rënda. Pra sipas kësaj pesha e veprës penale apo intensiteti i rrezikshmërisë është përcaktuar me llojin dhe masën e dënimit të paraparë, e që do të thotë se për ndëshkimin e një personi që tenton të kryejë veprën penale kërkohet një shkallë më e lartë e rrezikshmërisë .

Edhe pse kodi ynë penal parimisht e dënon vetëm tentativën e atyre veprave të dënueshme me së paku tre vjet burgim, në fjalinë e fundit të paragrafit 2 të nenit 20, ku thotë lidhur me veprat tjera penale tentativa dënohet vetëm nëse ligji e parasheh shprehimisht këtë, parasheh mundësinë e dënimit të tentativës edhe për vepra penale

për të cilat është paraparë dënim më i lehtë se tre vjet (p.sh. vepra penale e vjedhjes, neni 252 i KPK).

Sa i përket shprehjes "më së paku", KPK nuk jep qartësinë e duhur të kësaj shprehje. Në disa vende ka kuptimin e minimumit të dënimit (tek vepra penale e vrasjes, neni 146 i KPK), kurse në disa raste tjera nuk e ka kuptimin e minimumit të dënimit por të dënimit që mundet të i shqiptohet.

Në kohën e hyrjes në fuqi të këtij kodi ka pasur dilema në mes të hartuesve të kodit dhe praktikës gjyqësore në Kosovë për sa i përket kësaj shprehje.

Hartuesit e ligjit mbronin mendimin se kjo shprehje ka kuptimin e minimumit të dënimit.⁸

Praktika gjyqësore ka mbrojtur mendimin e dytë. Është qëndrim i Gjykatës Supreme të Kosovës që tentativa dënohet për veprat penale që mundet t'u shqiptohet dënimi me më shumë se tre vjet burgim.

Ky qëndrim është marrë duke u nisur nga fakti se KPK i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2004, ka ulur shkallën e rrezikshmërisë së veprave penale për të cilat tentativa dënohet, në krahasim me Ligjin penal të Kosovës të vitit 1977.

Nëse do të zbatohet mendimi i parë atëherë Praktika Gjyqësore e Kosovës do të kishte probleme mjaft të mëdha. Do të kishte mjaft vepra penale e që për nga natyra janë të rënda, për të cilat tentativa e kryerjes së saj nuk do të dënohej, (p.sh. vepra penale e dhunimit neni 193, parag.1 i KPK-së.)

Kodi Penal i Kosovës, në neni 20 paragrafi 3, ka paraparë që personi i cili tenton të kryejë vepër penale, pra kur vepra mbetet në tentativë, dënohet më butë sesa personi i cili e ka përfunduar - kryer veprën penale.

Kjo zbutje bëhet në pajtim me nenin 65 paragrafi 2 të KPK-së, e që thotë se dënimi i shqiptuar për tentativë nuk duhet të jetë më i lartë

⁸ Dr. Ismet Salihu, vepra e cituar, faqe.344.

se tri të katërtat e maksimumit të dënimit të paraparë për atë vepër penale.

Dallimi në mes tentativës dhe veprimeve përgatitore, si faza të kryerjes së veprës penale

Dallimi në mes tentativës së veprës penale dhe veprimeve përgatitore, është se me rastin e tentativës fillohet kryerja e veprës penale të dëshiruar, kurse me veprime përgatitore vetëm krijohen kushtet paraprake për ta kryer një vepër penale.

Por këto dy faza të kryerjes së veprës penale kanë edhe ngjashmëritë në mes vete:

- të dyja janë faza që i përkasin veprimeve apo fazave para prake të veprës penale,
- në të dy këto faza mungon pasoja, cenimi fizik i ndonjë të mire të mbrojtur nga ligji penal.

Sikurse u tha, për dallim nga veprimet përgatitore, tentativa është një fazë më e avancuar. Një person gjatë kësaj faze të veprimtarisë paraprake penale kalon nga krijimi i kushteve dhe i mjeteve për të kryer në të ardhmen një vepër penale, shoqërisht të rrezikshme, në realizimin të asaj vepre. Ai ndërmerr veprimet për të kryejë veprën e plotë, të cilën ka dëshiruar, t'a çojë atë deri në fund.

Pra, që një vepër penale të mbet në tentativë, nuk mjafton vetëm përgatitja e kushteve dhe mjeteve por edhe të ketë filluar veprimi i drejtpërdrejtë për kryerjen e asaj vepre. Tek tentativa, qëllimi i kryesit është kryerja e veprës penale, për këtë arsye ai ndërmerr veprime të drejtpërdrejta për të realizuar qëllimin e tij.

Ka mendime nga autorë të ndryshëm se i njëjti veprim i një personi, ose të njëjtat veprime në disa raste mund të jenë veprime përgatitore e në disa raste tentativë, p.sh. "thyerja e derës në banesës duhet të cilësohet si veprim përgatitor, në qoftë se vërtetohet, që personi A ka dashtë ta privon nga jeta personin B, i cili banonte në atë banesë, kurse duhet cilësuar si tentativë në qoftë se thyerja e derës është bërë me qëllim për të kryer veprën penale të vjedhjes."

Nga kjo mund të konkludojmë se për të përcaktuar nëse kemi veprime përgatitore apo tentativë të veprës penale, duhet të vlerësohen me kujdes të madh jo vetëm karakteristikat e jashtme të veprimeve ose të mosveprimeve të kryera nga personi, por dhe se çfarë ka dashur të arrijë me ato veprime ai person, pra, duhet që të shikohet edhe ana subjektive e figurës së veprës penale.

Llojet e tentativës

Meqenëse tentativa konsiderohet e kryer si në rastin kur veprimi i kryerjes ka përfunduar, ashtu dhe në rastin kur ky veprim vetëm ka filluar (por gjithmonë me kusht që pasoja e veprës penale të mos jetë shkaktuar), në të drejtën penale njihen disa ndarje në lloje të tentativës: tentativa e plotë dhe tentativa e metë; tentativa e papërshtatshme dhe tentativa e cilësuar.

Tentativë e plotë konsiderohet në rastet kur një person ka ndërmarr veprimin e kryerjes së një vepre penale dhe e ka përfunduar atë veprim, mirëpo pasoja nuk është shkaktuar, p.sh. personi A qëllon me armë me qëllim që ta privoj nga jeta personin B, por nuk e godet.

Tentativë e metë është atëherë kur një person e fillon veprimin e kryerjes së një vepre penale por nuk e përfundon veprimin, p.sh. personi A me armën e tij merr në shenjë me qëllim që ta privoj nga jeta personin B, por arma nuk shkrepi.

KPK nuk e njih një ndarje të tillë në mes tentativës së plotë dhe asaj të metë. Në nenin 20 të KPK-së, është e dhënë saktësisht definicioni i tentativës. Mirëpo, teoria e së drejtës penale e njih ndarjen e tentativës në tentativë të plotë dhe të metë.

Dallimi midis tentativës së plotë dhe asaj të metë rëndësinë më të madhe e ka lidhur dhe me çështjen e heqjes dorë vullnetare nga kryerja e veprës penale

KPK e njih tentativën e papërshtatshme. Në nenin 21 të këtij kodi thuhet *"gjykata mund ta lirojë personin i cili tenton të kryejë vepër penale me mjete të papërshtatshme ose ndaj objektit të papërshtat-*

shëm." Mirëpo ky kod nuk njeh dallimin në mes tentativës së papërshtatshme absolute dhe asaj relative, e cila ndarje në teorinë e së drejtës penale ekziston.

Tentativa e cilësuar ekziston atëherë kur me veprimin e ndërmarrë e që është tentuar të kryhet një vepër penale, është kryer në fakt një vepër tjetër penale, d.m.th. ai veprim i ka të gjitha elementet e një veprë tjetër penale, e që parashihet me Kodin Penal. Pra dashja e një personi ka qenë që të kryejë një vepër penale e cila ka mbetur në tentativë, por në veprimet e tij kemi të gjitha elementet e një veprë tjetër penale, p.sh. personi A e qëllon me armë personin B me qëllim që ta privoj nga jeta, mirëpo e godet në pjesët e poshtme të këmbëve ku i shkakton lëndim të rëndë trupor. Në këtë edhe pse ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale të lëndimit të rëndë trupor, dashja e personit A ka qenë që ta privoj nga jeta personin B dhe kjo vepër cilësohet si vrasje në tentativë.

Përfundime

Kuptimi i tentativës si fazë e kryerjes së veprës penale, paraqet një interes të madh, në aspektin teorik dhe sidomos në atë praktik.

E drejta penale i njeh si faza të kryerjes së veprës penale : lindjen e mendimit, shfaqjen e tij, veprimet përgatitore dhe tentativën.⁹

Lindja e mendimit, edhe me Kodin Penal të Kosovës nuk është e dënueshme, por kjo nuk do të thotë se ajo nuk ekziston si fazë.

Shfaqja e mendimit, përgjithësisht nuk është e dënueshme, me përjashtim të rastit kur personi që në momentin e shfaqjes së mendimit ka konsumuar veprën penale .

Në lidhje me veprimet përgatitore, në kodet penale, në pjesën e përgjithshme të tyre, parashihet kuptimi i veprimeve përgatitore si dhe përgjegjësia penale për personin i cili përgatitet për të kryer një vepër.

⁹ Dr. Ismet Salihu, vepra e cituar, faqe.202.

Pikëpamja dominuese në kodet penale, është se veprimet përgatitore për disa lloje të veprave penale janë të dënueshme.

Edhe KPK i dënon veprimet përgatitore për disa lloje të veprave penale. Zakonisht këto janë vepra të rënda penale si dhe me karakter ndërkombëtar.

Tentativa si fazë e kryerjes së veprës penale, objekt i punimit të paraqitur më lart, ekziston kur ndërmerren veprime të drejtpërdrejta për kryerjen e veprës penale, vetëm tek veprat penale ku forma e fajit është dashja si dhe vepra të mos përfundohet, përkatësisht të mos shkaktohet pasoja.

Nuk kemi të bëjmë me tentativë të veprës penale, tek veprat penale të cilat kryhen me mosveprim.

**Fatmir BEHRAMI**

E DREJTA E PRONËSISË

Objekti themelor i këtij punimi do të jetë shtjellimi i pronësisë, më saktësisht nocionit, fitimit dhe mbrojtjes së pronësisë. Tema, pra, në pika të shkurtra do të ofrojë njohuri rreth çështjeve në vijim.

1. Nocioni i pronësisë

Në Kosovë, ka mjaft pengesa, për shkak të mosdefinimit të qartë të pronësisë, e cila me vite të tëra është administruar me ligje të një sistemi juridik të cilin vështirë e kanë kuptuar edhe faktori ndërkombëtar. Termi pronësi, si institut i të drejtës civile ka një domethënie të gjerë, jo vetëm në këndvështrimin e sendeve, por edhe në të drejtën si objekt i rregullimit ligjor e kushtetues, pasi e drejta e pronësisë rregullohet edhe me kushtetutë.¹

Pronësia është e drejtë subjektive me karakter absolut, e cila gëzon mbrojtje me dispozita të së drejtës penale, të drejtës administrative dhe me dispozita të së drejtës civile, si dhe e garantuar me aktet më të larta shtetërore, me Kushtetutë.

E drejta e pronësisë është e drejtë themelore e njeriut, e përfshirë dhe garantuar me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut,

¹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 1998, neni 41, al.1.

sikundër edhe me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.

Pra, secili sistem juridik e njeh të drejtën e pronësisë, mbi bazën e konsolidimit të së drejtës "*për të gëzuar dhe disponuar sendet në mënyrë të plotë dhe ekskluzive*".² Çështje tjetër është edhe ajo se pronësia që nga e drejta romake në vete përmban jo vetëm të drejtën mbi një send, por edhe të drejtën për të përdorur, shfrytëzuar dhe disponuar me një send në kufijtë e ligjit (*jus utendi, jus fruendi dhe jus abutendi*). Sipas *jus utendi*, pronarët kishin të drejtë të posedonin dhe të përdornin sendin e tyre, sipas *jus fruendi*, pronarët kishin të drejtë të mblidhnin frutat natyrore dhe civile të sendeve, ndërsa sipas *jus abutendi*, ose mund ta asgjësojnë sendin definitivisht apo ta kenë juridikisht, duke e tjetërsuar pronën apo duke konstituuar ndonjë të drejtë sendore për interes të personave tjerë.³

E drejta e pronësisë është e drejtë sendore që përmban në vete autorizime më të gjëra me rastin e shfrytëzimit dhe të disponimit me një send.⁴

2. Fitimi i të drejtës së pronësisë

Pronësia fitohet nëpërmjet dy mënyrave të caktuara me kode civile dhe mënyrave tjera të caktuara me ligj të veçantë: fitimi origjiner i pronësisë dhe fitimi derivativ i pronësisë.

Fitimi derivativ i pronësisë i referohet fitimit të pronësisë nga një titullar i mëparshëm të titullari i ri. Sipas ligjit në fuqi, pronësia nuk mund të dorëzohet, sepse ajo nuk përfaqëson send trupor, por ajo përmban autorizime pronësore të një personi i cili ka të drejtë që sendin e vet ta mbajë, ta shfrytëzojë dhe ta disponojë brenda kufijve të caktuar me ligj.⁵

Te fitimi origjiner, pronësia fitohet e lirë dhe pa kurrfarë detyrimi, që do të thotë se është e pavarur nga e drejta e ndonjë titullari të

2 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë. Tiranë, 1998, neni 832.

3 Ivo Puhani, E drejta romake, Prishtinë, 1989, faqe 222.

4 Abdulla Aliu, E drejta sendore (Pronësia), Prishtinë, 2006, faqe 76.

5 Ligji mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore, neni 3.

mëparshëm. Në këtë mënyrë, pronësia fitohet në bazë të ligjit, me krijimin e sendit të ri, me bashkimin, me përzierjen, me ndërtim në tokën e huaj, me ndarjen e frutave, me parashkrimin fitues, me fitimin e pronësisë nga jo pronari, me okupim dhe raste tjera të caktuara me ligj.⁶

3. Mbrojtja e të drejtës së pronësisë

Mbrojtja e pronësisë është njëra nga të drejtat më të rëndësishme, për mbrojtjen të drejtën e pronës e të cilës, përveç pronarit duhet të kujdeset edhe sistemi juridik.⁷ Ndërsa, në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, për mbrojtjen e pronësisë thuhet: "E drejta e pronës është e garantuar" dhe askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona.⁸ Kjo e drejtë, siç do të diskutohet më në detaje në vijim, është gjithashtu e garantuar edhe me të drejtën ndërkombëtare.

Po qe se ndodh që dikush të shkelë apo cenojë të drejtën e pronësisë, pronari ka në dispozicion padinë si mjet juridik për mbrojtje. Paditë kryesore për mbrojtjen e pronësisë janë: padia e reivendikimit (*actio reivindicatio*), padia mohuese (*actio negatoria*) dhe padia publiciane (*actio publiciana*).⁹

Siç dihet, në zhvillimin e procedurës civile dhe dinamikën e saj, palët mbajnë më shumë përgjegjësi (*nemo procedat sine actore*) se sa në zhvillimin dhe dinamikën e procedurës penale, sepse kjo zhvillohet më tepër sipas detyrës zyrtare (*ex officio*). Sa i përket këtyre parimeve në praktik, realiteti në Kosovë është i tillë në një gjendje të pa mjaftueshme për mbrojtjen e pronës është në gjendje alarmuese dhe pasqyron funksionin e pa mjaftueshëm të sistemit ligjor dhe një papërgjegjshmëri e organeve administrative si ato në nivel lokal dhe atyre qendror.

Njëra ndër problemet e pa mundësisë për mbrojtjen e të drejtës pronësore, paraqitet fakti se zyret kadastrale shpeshherë u mungojnë dokumentacionet nga periudha e kohës të mëhershme, por sido-

6 Abdulla Aliu, vepra e cituar, faqe 111.

7 Abdulla Aliu, vepra e cituar, faqe 127.

8 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 46, pika 1.

9 Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike, neni 37-42.

mos ky dokumentacion është shkatërruar apo humbur, por ka edhe raste që pushteti i mëhershëm - Serb të cilët kanë punuar pranë këtyre organeve administrative me rastin e largimit nga Kosova, gjatë vitit 1999 kanë marrë me vete shumë libra kadastrale. Si rezultat i kësaj po shkaktohen probleme sa i përket identifikimit të së drejtës pronësore të individëve dhe për këtë çështje në shumtën e rasteve qytetarët kërkojnë që këtë të drejt ta mbrojnë përmes gjykatave.

Numri i madh i dokumenteve të falsifikuar që qarkullojnë në Kosovë, për shkak të mungesës së dokumentacioneve përkatëse kanë shkakuar konfuzione të konsiderueshme mbi pronën. Për ta mbrojtur të drejtën e pronës nga kjo dukuri Kodi Penal i Kosovës ka përcaktuar disa nga llojet e veprave penale për mbrojtjen e të drejtës pronësore të cilat i ka paraparë si për mbrojtjen e pronarëve të pronës private, ashtu edhe të pronës shoqërore me të cilën ka nxjerr një rregullore të veçantë sa i përket kësaj prone.

Ligjdhënësi ka përcaktuar me Kodin Penal të Kosovës këto lloj të veprave penale të cilat mbrojnë të drejtën e pronësisë të individit, siç janë:

- Vepra penale pushtimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme, neni 259 paragrafi 1, ku përcakton se kushdo që në mënyrë të kundërligjshme e pushton pronën e paluajtshme të personit tjetër apo një pjesë të saj dënohet me gjobë apo me burg deri në një vit, si dhe veprën penale pushtim i paligjshëm i pronës, nga neni 259 A, e cila e mbron pronën shoqërore e cila është nxjerrë si rregullore e veçantë vetëm për mbrojtjen e pronës shoqërore.
- Po ashtu, është paraparë edhe vepra penale legalizimi i përm bajtjes së pavërtetë, ku më së tepërmi është përdorur me vërtetimin e kontratave të shitblerjes së paluajtshmërive. Elementet e kësaj vepre penale janë përcaktuar në nenin 334, paragrafi 1 dhe 2 të Kodit Penal të Kosovës, ku thuhet se kushdo që e vë në lajthim organin kompetent për të vërtetuar një çështje të pavërtetë e paraparë të shërbejë si pronë në një çështje ligjore në një dokument publik, në një regjistër ose libër, dënohet me burg 3 muaj deri në 5 vite. Sipas paragrafit 2, kushdo që e përdor dokumentin, regjistrin ose libra të tilla që

e din se është i rrem, dënohet me burg nga paragrafi 1 i këtij neni.

Siç mund të shihet, ka shumë vështirësi në lidhje me mbrojtjen e duhur dhe të drejtën e pronës, që shpesh herë ka të bëjë me mungesën e llogaridhënies dhe përgjegjësisë së autoriteteve të organeve komunale, krahas këtyre edhe të gjyqësorit joefikas në mbrojtjen e të drejtës pronësore të individëve - qytetarëve.

**Isa SHALA**

PROPOZIMI PËR PËRMBARIM DHE LEJIMI I PËRMBARIMIT

Hyrje

Procedura përmbimore fillohet me propozimin e kreditorit si dhe sipas detyrës zyrtare, kur me ligj parashihet një gjë e tillë, konform dispozitës së nenit 3 të Ligjit të Procedurës Përmbimore.¹

Pasi që në këtë procedurë në mënyrë rigoroze atakohet fusha juridike e të drejtave të debitorit (merren sende dhe të drejta), kërkesa duhet të jetë provuar në atë mënyrë që të evitohet mundësia e dyshimit të ekzistimit të saj, që do të thotë të jetë e besueshme.

Dokumenti përmbimor është dokument që përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës, arritja e saj dhe legjitimiteti i palëve në procedurën e përmbimit, ku nga ky dokument përmbimor del detyra e gjykatës që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj ekzekutimin.

Përmbajtja e propozimit për përmbim

Nga ana formale LPP nuk parasheh ndonjë formë të veçantë për propozimin për përmbim. Nenet 39 dhe 40 të LPP rregullojnë çështjen se çka duhet të përmbaj propozimi për përmbim.

¹ Ligji mbi Procedurën e Përmbimit i Republikës së Kosovës, nr.03/L-008, në tekstin e mëtejshëm LPP.

Propozimi për përmbajm duhet ta përmbajë kërkesën për përmbajm në të cilën do të tregohet dokumenti përmbajm, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbajmi, kërkuesi i përmbajmit dhe debitori, kredia që kërkohet të realizohet, mjeti më anë të të cilit duhet kryer përmbajmi, objekti i përmbajmit po që se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbajmit.

- Dokumenti përmbajm është dokument në të cilin bazohet përmbajmi p.sh. vendimet gjyqësore të formës së prerë, të përmbajmshme, dokumentet e besueshme, etj. Konform nenit 37.1 të këtij ligji në qoftë se propozimi për përmbajm paraqitet në gjykatën që nuk ka vendosur në shkallë të parë për kërkesëpadinë, bashkë me propozimin paraqitet edhe dokumenti përmbajm në të cilin është vënë vërtetimi për përmbajmshëmri.

Risi paraqitet në ligjin e ri dokumenti përmbajm i noterit ku nuk ka nevojë të jetë i pajisur me vërtetimin për përmbajmshëmri për arsye se ajo përcaktohet me dispozitat e ligjit për noterit.

- Kërkuesi i përmbajmit dhe debitori, pra është e detyrueshme që të përcaktohet në propozimin për përmbajm.
- Kredia që duhet të realizohet ku sipas këtij ligji është e drejtë për realizimin e shumës së të hollave apo të ndonjë dhënie, veprimi, mosveprimi apo pësimi (shembull: të borxhet në të holla duhet të dihet natyra e detyrimit dhe shuma që do të paguhet debitorit).
- Mjeti më anë të të cilit duhet kryer përmbajmi, p.sh. të sendet e paluajtshme caktohet përmbajmi bartja apo shitja në sende konkrete për t'u realizuar kërkesa e kreditorit. Kjo nuk është e detyrueshme të sendet e luajtshme (neni 41 i LPP),
- Si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbajmit.

Po që se bashkë me propozimin për përmbajm është bërë edhe kërkesa për konstatimin e pasurisë së debitorit, për rezultatin e konstatimit të tillë gjykata do të njoftoj propozuesin e përmbajmit duke i lënë afat që ta rregullojë propozimin e paraqitur, respektivisht që ta ndryshoj apo plotësoj atë.

Konform nenit 40 të LPP, propozimi për përmbarrim në bazë të dokumentit të besueshëm përveç kërkesës përmbarrimore nga parag. 1 i nenit 39 të këtij ligji, duhet të përmbaj edhe kërkesën që gjykata ta detyroj debitorin e përmbarrimit që brenda afatit prej 7 ditësh, kurse në kontestet nga raportet ku ekziston kambiali dhe çeku brenda afatit prej 3 ditësh nga dita në të cilën i dorëzohet aktvendimi, t'a përmbush detyrimin bashkë me shpenzimet e caktuara, kjo çështje parashihet në ligjin e ri të procedurës përmbarrimore.

Risi në ligjin e ri të Procedurës Përmbarrimore është paraparë edhe konstatimi i pasurisë së debitorit, ku në bazë të nenit 42 parashihet që propozuesi i përmbarrimit në propozimin e tij që bazohet në dokumentin përmbarrimor mund të kërkoj nga gjykata që para se të lejoj aktvendimin të kërkoj nga vet debitori si dhe subjektet tjera në propozim dhënien e të dhënave për pasurinë e debitorit. Procedura se si duhet të veproj gjykata lidhur me këtë çështje rregullohet me nenin 42 parag.1 gjerë të parag 7.

Shqyrtimi i propozimit përmbarrimor

Gjykata me rastin e pranimit të propozimit për përmbarrim duhet që ta shqyrtoj dhe verifikoj dhe pastaj të merr vendim duke eliminuar dukurinë e lejimit të propozimeve jo complete dhe të pasakta.

Duke marrë për bazë numrin e madhe të lëndëve në këtë procedure dhe numrin e vogël të gjyqtarëve dhe zyrtarëve përmbarrimor, ky proces në fillim duket paksa i komplikuar sepse zyrtari përmbarrimor me rastin e shqyrtimit duhet të ketë për bazë një mori pyetjesh disa prej të cilave nuk janë të obliguara me ligj, mirëpo paraqesin të metat e propozimeve si dhe nenet 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 37 dhe 38 të LPP.

Para lejimit të përmbarrimit rëndësi të veçantë duhet kushtuar kompetencës duke pas për bazë këto pyetje:

- a është i përshtatshëm për përmbarrim dokumenti i parashtruar?
- a bie lënda në juridiksionin e kësaj gjykate apo Gjykatës Ekonomike?
- nëse përmenden sendet, a janë këto sende nën kompetencën e juridiksionit të asaj gjykate?

Nëse pas shqyrtimit të këtyre pyetjeve, vijmë në konkludim se kemi të bëjmë me inkompetencën e gjykatës, atëherë përmbartimi duhet të refuzohet dhe kreditori duhet të udhëzohet rastin t'a paraqesë në gjykatën kompetente.

Pas lejimit të përmbartimit gjykata mund të njoftohet me kundërshtim të debitorit për jekompetencën. Pas konstatimit të jekompetencës gjykata duhet të bie vendim për inkompetencën, ku përfundohet procedura e përmbartimit në atë gjykatë dhe pasi vendimi të merr formën e prerë lënda cedohet në gjykatën kompetente.

Nga lista e pyetjeve tjera veçojmë:

- a është i bashkangjitur dokumenti që shërben si bazë për ekzekutim?
- a është paguar taksa gjyqësore ?

Po ashtu gjykata me rastin e shqyrtimit të propozimit duhet të konstatoi qartë se cili propozim është i pavlefshëm dhe cili është i vlefshëm. Pas kësaj, gjykata te propozimi i vlefshëm konstaton se cili është i kompletuar dhe cili është i pa kompletuar.

Propozimi është i pavlefshëm:

- nëse nuk është cekur se kush është debitor,
- nëse dokumenti në bazë të të cilit kërkohet përmbartimi nuk është dokument i ekzekutueshëm,
- në rastet kur brenda afatit të caktuar ligjor duhet paraqitur kërkesa (kjo vlen te kthimi i punëtorit në vendin e punës, apo te kërkesa për kundërpërmbartim, etj.),
- dokumenti në bazë të të cilit është parashtruar propozimi nuk përmban asnjë detyrim,
- personi që parashtron propozim nuk është kreditor ose person i autorizuar.

Propozimi është i pakompletuar :

- nëse dokumenti në bazë të të cilit kërkohet përmbartimi nuk i është bashkangjitur propozimit (neni 37 parag.1 i LPP),

- nëse informatat lidhur me adresën e saktë të kreditorit ose debitorit nuk janë cekur, etj.

Një shqyrtim i drejt i propozimit para se të lejohet ekzekutimi vetëm se do të kursej kohë në aspektin e përfundimit sa më të shpejt të procedurës.

Në praktikën gjyqësore është duke u përsëritur por në masë më të vogël dukuria e lejimit të ekzekutimit ku dokumenti i parashtruar si bazë për ekzekutim nuk përmban asnjë obligim për debitorin ose kur propozimi paraqitet në gjykatën e cila nuk ka juridiksion për atë çështje, por është me pak e ngarkuar me lëndë dhe për atë arsye edhe i drejtohen asaj gjykate. Kjo praktikë e lejimit të gabuar të ekzekutimit duhet të ndërpritet.

Nuk duhet të lejohet në praktiken gjyqësore, që propozimi përmbarrimor lidhur me shpenzimet gjyqësore-paushallit gjyqësor dhe dënimeve me gjobë të dërgohet në zyrën e përmbarrimeve të së njëjtës gjykatë, sa për t'u regjistruar si lëndë dhe për t'u shpallur menjëherë jokompetent në atë çështje për të kompletuar një raport lidhur me lëndët e kryera, por të dërgohet drejtpërdrejt në gjykatën kompetente për përmbarrim.

Nëse propozimi për përmbarrim është jo valid gjykata e refuzon ekzekutimin.

Ndërsa, në rastet kur propozimi është jo i kompletuar gjykata bie konkluzion që të kërkoj informata shtesë apo të përmirësuar nga kreditori ose organet tjera administrative.

Në rastet kur propozimi paraqitet i pa kompletuar atëherë gjykata lëshon një konkluzion që të kërkoj informata shtesë nga kreditori, duke u bazuar në dispozitat e nenit 22 të LPP lidhur me nenin 99 parag. 2 dhe nenit 102 parag. 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.²

Nëse parashtrësia nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar ose i kthehet, por pa u korrigjuar apo plotësuar konsiderohet si e tërhe-

² Ligji i Procedurës Kontestimore i Republikës së Kosovës, nr.03/L-006, në tekstin e mëtejme LPK.

qur dhe parashtresa do të hidhet poshtë, duke u bazuar në nenin 102.3 të LPK-së.

Në praktikë ka qëndrime të ndryshme lidhur me aplikimin e dispozitës së nenit 102 të LPK. Një qëndrim është se gjykata vet duhet t'i drejtohet organeve kompetente për sigurimin e adresave duke u bazuar në nenin 117 të LPK.

Një analizë e shkurtër e neneve të lartcekura të cilat gjykata i merr për bazë me rastin e lejimit të ekzekutimit.

Konform nenit 23 të LPP gjykata e cakton përmbarimin vetëm në bazë të titullit ekzekutiv apo dokumentit të besueshëm, po qe se me ligj nuk parashihet ndryshe.

Titujt ekzekutiv janë:

- Vendimi ekzekutiv i gjykatës dhe ujdia gjyqësore ekzekutive,
- Vendimi ekzekutiv i dhënë në procedurë administrative dhe ujdia administrative nëse ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe nëse me ligj nuk është paraparë diçka tjetër,
- Dokumenti noterial ekzekutiv, e cila është shtuar si titull ekzekutiv në ligjin e ri përmbarimor,
- Dokumenti tjetër që me ligj është quajtur dokument ekzekutiv (p.sh. pajtimi i arritur në procedurën e ndërmjetësimit kur është aprovuar nga gjykata apo vërtetuar nga organi kompetent - Ligji i ri për procedurën e ndërmjetësimit neni 14.4).

Sipas nenit 25 të LPP-së vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurë gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujdi gjyqësor konsiderohet ujdia e arritur përpara gjykatës dhe arbitrazhit.

Vendim i organit administrativ konsiderohet aktvendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurën administrative, nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike, kurse ujdi administrative konsiderohet ujdia e arritur në procedurën administrative përpara organit ose shërbimit administrativ.

Dokumenti ekzekutiv duhet të përmbaj detyrimin e caktuar të debitorit, nëse ndonjë vendim i gjykatës apo organit administrativë nuk

përmban detyrimin e debitorit i cili ka të bëjë me ndonjë dhënie ose mosdhënie ai nuk mund të jetë dokument ekzekutiv.

Aktgjykimet vërtetuese (deklarative) dhe vendimet me të cilat vetëm vërtetohet ekzistimi i ndonjë marrëdhënie juridike, nuk janë dokumente ekzekutive (p.sh. aktgjykimi me të cilin zgjidhet martesë ose aktgjykimi me të cilin përmbarimi deklarohet i pa lejuar).

Vendimi i dhënë ose ujdia e lidhur në procedurën administrative, jo vetëm që duhet të përmbaj detyrime në të holla, por për përmbarimin e tyre nuk është caktuar kompetenca e ndonjë organi tjetër (p.sh. në procedurën administrative në disa çështje lidhur me pagimin e disa llojeve të tatimeve janë kompetente vet organet administrative në bazë të rregulloreve dhe udhëzimeve administrative që ta kryejnë procedurën e përmbarimit përmes xhironlogarive bankare).

Numri më i madh i dokumenteve përmbarimore në bazë të cilave caktohet përmbarimi buron nga procedura kontestimore, ndërsa më pak nga ajo jokontestimore. Ndërsa vendimet që merren në procedurën penale si dokumente ekzekutive konsiderohen aktgjykimet me të cilat shqiptohen dënimet me të holla, konfiskimi i pasurisë, vendimet mbi shpenzimet e procedurës dhe të kërkesave pasuroro-juridike.

Përmbarueshmëria e vendimit dhe plotfuqishmëria janë nocione të ndryshme, që në praktikë shpeshherë përzihen. Çështjen e përmbarueshmërisë ligji ka rregulluar me nenet 26 dhe 27, ku thuhet se një vendim gjyqësor është i përmbarueshëm nëse e ka marrë formë të prerë dhe po që se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare (p.sh. nëse në aktgjykim është thënë "detyrohet i padituri që në emër të përmbushjes së borxhit nga kontrata e huasë paditësit t'i paguaj shumën prej 500 euro, në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së aktgjykimit" afati për përmbushje vullnetare është 15 ditë, ndërsa aktgjykimi është i përmbarueshëm pas kalimit të afatit parativ prej 15 ditëve).

Klauzola e përmbarueshmërisë vihet në dokumentin përmbarues origjinal ose në kopjen e tij të vërtetuar pas kalimit të afatit për përmbushje vullnetare.

Klauzolen e vënë gjykata, përkatësisht organi i cili ka vendosur në shkallën e parë.

Dokumenti përmbarues është i përmbarueshem ditën e parë pas kalimit të afatit për përmbushje vullnetare.

Nëse i referohemi praktikës gjyqësore propozimi për ekzekutim i paraqitur para kalimit të afatit për përmbushje vullnetare nuk duhet të refuzohet, por duhet pritur të kaloj afati vullnetar për përmbushje.

Nëse gjykata gabimisht ka vendosur për përmbarim edhe pse dokumenti përmbarues nuk është bërë i përmbarueshem në rastet kur dokumenti përmbarues nuk i është dorëzuar debitorit në rregull në procedurën paraprake atëherë gjykata përkatësisht organi që ka vendosur në shkallën e parë me propozimin e debitorit në afat prej 7 ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar për përmbarimin me aktvendim do ta anulon klauzolën e përmbarushmerisë (neni 37.4 i LPP).

Në bazë të nenit 30 paragrafi 2 të LPP, dokument i besueshem është:

- fatura,
- kambiali dhe çeku, me potest dhe faturë kthyesë, nëse nevojitet për themelimin e kredisë,
- dokumenti publik,
- ekstrakti nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të ujit, energjisë elektrike dhe hedhurinave,
- dokumenti privat i verifikuar sipas ligjit.

Në gjykata propozimet që bëhen në bazë dokumentit të besueshëm, kryesisht bëhen në bazë të faturave, ndërsa në bazë të dokumenteve tjera shumë rrallë.

Kreditorët më të shpeshtë në bazë të këtyre propozimeve janë: KEK-u, PTK-ja, kompanitë shërbyese komunale të ujit apo të hedhurinave, ndërsa debitor janë personat fizik dhe juridik.

Vlera e borxhit për të cilën kërkohet përmbarimi varion nga vlera shumë të ulëta e gjerë të ato më të mëdha. Gjykata konform dispoz-

itave ligjore është e obliguar të ndërmerr veprime për të gjitha lëndët, pavarësisht se vlera e lëndës është 5 euro, ku për gjykatën është një stërngarkesë dhe në shumë raste për shkak të kohës mbeten pa u përmbuar lëndë me vlerë me të lartë.

Përshtatshmëria e dokumentit përmbarimor

Një dokument përmbarimor që të jetë juridikisht i vlefshëm dhe i përshtatshëm për përmbarim duhet ti plotësoj këto kushte:

- që në të te jenë shënuar emri dhe mbiemri i kreditorit dhe debitorit, përkatësisht emri i firmës dhe adresa (në praktikën gjyqësore ka raste kur nuk shënohet mbiemri i debitorit),
- detyrimi i debitorit sipas objektit, llojit, vëllimit dhe kohës së përmbushjes së tij në mënyrë që të eliminohen mëdyshjet se për çfarë detyrimi të debitorit është fjala.

Konform nenit 28.1 të LPP-së dokumenti ekzekutiv është i përshtatshëm për përmbarim nëse në të është treguar kreditori dhe debitori ekzekutiv, objekti, lloji, vëllimi dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Caktimi i afatit paritiv nuk është kusht i domosdoshëm për përshtatshmërinë e dokumentit përmbarues sepse nëse një afat i tillë nuk është përcaktuar në dokumentin përmbarimor, afati caktohet me aktvendimin e përmbarimit (neni 28.2 i LPP).

Bazuar në këtë gjykata e cakton përmbarimin e propozuar me kusht që debitori brenda afatit që i është caktuar për përmbushje vullnetare nuk e përmbush detyrimin.

Kufijtë e përmbarimit

Në bazë të nenit 49 të LPP, përmbarimi kryhet brenda kufijve të caktuar në aktvendimin për përmbarim.

Kreditori mund të kërkoj ekzekutimin e një shume që parashihet në dokumentin për ekzekutim, mund të kërkoj më pak, por jo me shumë se në dokumentin e parashtruar për ekzekutim.

Lejimi i aktvendimit për përmbarrim

Bazuar në shqyrtimin formal të propozimit për përmbarrim, nëse vihet në përfundim se janë plotësuar kriteret ligjore për lejim atëherë gjykata bie aktvendim për lejimin e përmbarrimit.

Neni 44 i LPP-së, përcakton që në aktvendimin për përmbarrim duhet të tregohet dokumenti ekzekutiv, respektivisht dhe debitori, kredia që duhet të realizohet, mjeti dhe objekti i përmbarrimit si dhe të dhënat tjera të nevojshme për zbatimin e përmbarrimit, ndërsa paragrafi 2 i këtij neni rregullon çështjen e llogaritjes së kamatave.

Ligji i ri Procedurës së Përmbarrimit në mënyrë të veçantë ka rregulluar aktvendimin në bazë të dokumentit të besueshëm, ku me këtë rast gjykata e detyron debitorin ekzekutiv që brenda afatit prej 7 ditësh, kurse në kontestet që lidhen me kambialin dhe çekun afatit prej 3 ditësh nga dita e dorëzimit të aktvendimit t'a shlyej borxhin bashkë me shpenzimet procedurale të caktuara në të.

Me aktvendimin për përmbarrim vendoset për lejimin e përmbarrimit si dhe mënyra e implementimit të përmbarrimit, varësisht nga mjetet dhe subjekti i ekzekutimit.

Aktvendimi mbi ekzekutimin është i njëjtë me obligimin e debitorit që është parashtruar në dokumentin për ekzekutim, ndërsa shpenzimet tjera llogariten gjatë tërë procesit përmbarrues.

Neni 46 i LPP, parasheh pjesët përbërëse të aktvendimit përmbarrimor, ku në parag.1 citohet se aktvendimi nuk duhet ta ketë domosdo pjesën arsyetuese, pra mund të nxjerrët duke u vënë vula katrore në propozimin përmbarrimor.

Aktvendimi për përmbarrim duhet ta përmbaj udhëzimin për mjetin e goditjes të cilin palët kanë të drejt ta përdorin.

Aktvendimi me të cilin propozimi për përmbarrim tërësisht ose pjesërisht refuzohet apo hedhet poshtë, domosdo duhet ta ketë arsyetimin.

Edhe pse decidivisht ligji nuk e parasheh se a do të ketë arsyetim aktvendimi përbarimor pas informative shtesë ose përmirësimeve, aktvendimi tillë domosdo duhet të ketë arsyetimin sepse në këtë rast propozimi duhet të ndryshohet ose plotësohet andaj është e pamundshme që ai vetëm të vulozet.



Mr.sc.Isuf SADIKU

E DREJTA PËR NJË PROCES GJYQËSOR TË DREJTË, PUBLIK, BRENDA NJË KOHE TË ARSYESHME, NGA NJË GJYKATË E PAVARUR DHE E PAANSHME NË DRITËN E NENIT 6 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE LEGJISLACIONIT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe legjislacioni kosovar kanë vendosur standarde të larta për respektimin e afatit të arsyeshëm brenda të cilës duhet të procedohet një rast në gjykatë.

Kështu Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të Njeriut,²⁰ në Nenin 6 ka paraparë se "në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të ndonjë akuze penale kundër tij, çdo njeri ka të drejtë për një proces gjyqësor të drejtë dhe publik brenda një kohe të arsyeshme nga një gjykatë e pavarur dhe paanshme, të themeluar me ligj". Kurse, në nenin 13, ka paraparë se "çdo njeri të cilit i shkelen të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë Konventë duhet të ketë një mjet ligjor efektiv para një autoriteti kombëtar, pavarësisht nga fakti se shkeljen e kanë kryer personat që veprojnë në cilësi zyrtare".

20 E njohur si Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut " KEDNJ " është miratuar në Romë me 4 nëntor 1950 ndërsa ka hyrë në fuqi me 3 shtator 1953.

Akte juridik më i lart i Republikës së Kosovës e cila e rregullon këtë çështje janë :

Kushtetuta e Republikës së Kosovës²¹

Neni 3 Barazia para ligjit

Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe me respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.

Neni 53 Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut

Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni 54 Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

Neni 22 Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe i Instrumenteve Ndërkombëtare

Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumente ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave dhe akteve të tjera të institucioneve publike [...]

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saja;

...

21 Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka hyrë fuqi me 15 qershor 2008.

Përveç Kushtetutës, edhe me ligjet tjera të Republikë së Kosovës parashihet kohëzgjatje e arsyeshme për t'u zhvilluar një procedurë gjyqësore, siç janë:

Kodi i Procedurës Penale i Kosovës²²

Neni 5

1. *Çdo person i dyshuar ose i akuzuar për vepër penale ka te drejtë të kërkojë procedurë të paanshme penale të zbatuar në kohë të arsyeshme.*
2. *Gjykata detyrohet të kujdeset që procedura të zbatohet pa zvarritje dhe të pengohet çdo shpërdorim i të drejtave që u përkasin pjesëmarrësve në procedurë.*
3. *Çdo heqje lirie, sidomos kohëzgjatja e paraburgimit në procedurë penale, duhet zvogëluar në kohën më të shkurtër të mundshme.*

Ligji për Procedurën Kontestimore²³

Neni 10

Gjykata ka për detyrë të përpiqet që procedura të zhvillohet pa zvarritje dhe sa më pak shpenzime, si dhe të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të së drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas këtij ligji.

Neni 475

Në kontestet nga marrëdhënia e punës, e sidomos me rastin e caktimit të afateve dhe konvokimit të seancave gjyqësore, gjykata gjithmonë do ta ketë parasysh nevojën e zgjidhjes së ngutshme të kontesteve nga marrëdhënia e punës.

22 Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale është shpallur me 6 korrik 2003, me Rregulloren e UNMIK -ut nr. 2003/26 ka hyrë në fuqi me 6 prill 2004, ndërsa me Ligjin nr. 03/L-003 6 nëntor 2009 të shpallur me dekretin Nr. DL-058 -2008 të datës 27 nëntor 2008 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës, neni 1 në tërë tekstin fjalë Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës zëvendësohet me fjalinë Kodi i Procedurës Penale të Kosovës.

23 Ligji Nr. 03/L-054 30 korrik 2008 i shpallur me dekretin nr. DL-047 -2008, datë 07 gusht 2008 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu.

Neni 479

Me rastin e caktimit të afateve dhe konvokimit të seancave gjyqësore, gjykata gjithmonë i kushton kujdes nevojës së zgjidhjes së ngutshme të kontesteve për shkak të pengimit të posedimit, por duke marrë parasysh natyrën e secilit rast konkret.

Ligji për Procedurën Përmbaremore²⁴

Neni 5 Ngutshmëria dhe radha e veprimit

5.1 Në procedurën e përmbaremit gjykata ka për detyrë të veprojë me ngutshmëri.

5.2 Gjkata ka për detyrë që lëndët t'i marrë në procedim sipas radhës me të cilën i kanë ardhur propozimet për përmbaremit, përpos kur natyra e kre-disë ose rrethanat e posaçme kërkojnë që gjykata të veprojë ndryshe.

Analizimi i situatave që mund ti referohen kohëzgjatjes së arsyeshme në procedurat gjyqësore në sistemin e administrimit të drejtësisë në Kosovë

Kohëzgjatja e arsyeshme është një element mjaftë i rëndësishëm në rrjedhën e procesit gjyqësor si dhe në përfundimin e një rasti gjyqësor qoftë ai penal ose civil. Andaj si gjyqtarët ashtu edhe prokurorët, duhet ti kushtojnë vëmendje të posaçme arsyeshmërisë së kohës gjatë të cilës fillon dhe përfundon një procedurë gjyqësore. Rëndësia dhe pesha kohës së arsyeshme, përveç që është paraparë me ligjet e lartpërmendura, për më tepër është fuqizuar me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila ka paraparë mjetin juridik efektiv në nenin 54, zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në nenin 22, si dhe Precedentin Gjyqësor të Gjykatës së Strasburgut, në nenin 53.

Elementi kohë e arsyeshme në një procedurë gjyqësore, përveç që gëzon mbrojtje ligjore me legjislacionin penal dhe civil në Republikën e Kosovës, ajo mbrohet edhe me Kushtetutën e

24 Ligji Nr. 03/L-008 2 Qershor 2008 i Shpallur me dekretin nr. DL-042-2008, datë 24.06.2008 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu.

Republikës së Kosovës si dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe me vendimet apo rastet precedentë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat të Njeriut në Strasburg. Por, është me rëndësi të thuhet se nuk ka afat kohor të përcaktuar strikt se sa është kohëzgjatje e arsyeshme për të proceduar një rast gjyqësor, por kjo varet nga rrethanat të çdo rasti konkret.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut shumë herë ka theksuar se vonesat e mëdha në administrimin e drejtësisë lidhur me palët që nuk kanë mjete efektive, përbën një kërcënim për sundimin e ligjit brenda rendit vendor ligjor. Për shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut kemi shumë vendime të lëshuara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat të Njeriut.²⁵

Zvarritje të tepruara kohore mund të ketë si në procedurat gjyqësore penale ashtu edhe në ato civile, por këto zvarritje mbizotërojnë në procedurat gjyqësore civile. Ekziston një proverb që e fuqizon dhe ia jep një kuptim elementit kohë në përfundimin e një procedure gjyqësore, e që thotë "Drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar". Po ashtu zvarritjet e tepruara në procedurën gjyqësore ndikojnë negativisht edhe në besimit apo opinionin e qytetarëve lidhur me paanshmërinë dhe objektivitetin e sistemit gjyqësor.

Në disa nga rastet që kanë të bëjnë me përcaktimin e të drejtës civile, zgjatja e procedurës konsiderohet nga koha e fillimit apo inicimit të procedurës gjyqësore, shih rastet (Sienkiewitz kundër Polonisë, aktgjykimi i datës 30 shtator 2003; Molodovan dhe të tjerë kundër Rumanisë aktgjykimi i datës 12 korrik 2005) deri në kohën kur rasti përfundimisht është vendosur ose vendimi i Gjykatës është ekzekutuar, siç garantohet nga neni 6 i Konventës, sepse në të kundërtën do të ishte iluzive në qoftë se sistemi ligjor i një shteti do të lejonte që një vendim gjyqësor i karakterit përfundimtar dhe i detyrueshëm të ngelej pa efekt në dëm të palëve në proces sepse Gjykata Evropiane e Strasburgut disa herë me radhë ka vendosur se ekzekutimi i një vendimi gjyqësor është pjesë përbërëse e procesit gjyqësor, shih

25 Shih faqen zyrtare elektronike të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg www.echr.coe.int/echr/; Buletinet mbi jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, të publikuara në faqen elektronike www.coealb.org.

rastet (Vocaturu kundër Italisë, aktgjykimi i datës 24 maj 1991; Immobiliare Saffi kundër Italisë aktgjykimi i datës 28 korrik 1999; Hornsby kundër Greqisë aktgjykimi i 5 shkurtit 1997)²⁶.

Kohëzgjatja e arsyeshme e një procedure gjyqësore duhet të vlerësohet në bazë të rrethanave të veçanta të rastit dhe duke i marr parasysh kriteret e vendosura në praktikën gjyqësore apo të drejtës së precedentëve të Gjykatës Evropiane të Strasburgut, këtu si rrethana që mund të arsyetojnë kohën më të gjatë për një procedurë gjyqësore mund të hyjnë: ndërlikueshmëria e rastit, sjellja e palëve dhe autoriteteve të përfshira, si dhe ajo çfarë është në interes për ankuesin. Pra, përjashtimisht, kur palët me sjelljet e veta i kontribuojnë zvarritjes së procedurës gjyqësore apo kur kemi ndërlikueshmëri të rastit atëherë nuk mund ti referohemi legjislacionit të lartpërmendur për shkelje.

Ndërsa sa i përket arsytimit lidhur me mungesën e resurseve humane, mbingarkimit me lëndë gjyqësore, mungesës së hapësirave adekuate, sipas praktikës apo rasteve gjyqësore të precedentëve të Gjykatës Evropiane të Strasburgut nuk justifikohen. Pra i mbetet institucioneve publike shtetërore dhe gjyqësorit në Kosovë që përveç të tjerash për të konkluduar se kemi sundim të ligjit në Kosovë duhet t'i kushtohet vëmendje e shtuar edhe kohëzgjatjes së arsyeshme për të zhvilluar dhe përfunduar një procedurë gjyqësore sepse në të kundërt mundet dhe ka të ngjarë që edhe shteti i Kosovës pas anëtarësimit në Këshillin e Evropës të paditet në Gjykatën Evropiane të Strasburgut ndër të tjera edhe për këtë që quhet "kohë e arsyeshme" brenda të cilës duhet të zhvillohet një procedurë gjyqësore.

Pra, nga që cekëm më lartë, ritheksojmë faktin elementar "kohë e arsyeshme" në një procedurë gjyqësore përveç që është e paraparë është edhe ligjrisht e obligueshme sipas instrumenteve ligjore të vendit tonë por edhe sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

²⁶ Shih me gjerësisht <http://www.echr.coe.int/echr/>.



Nihat IDRIZI

VEPRA PENALE E TRAFIKIMIT TË NJERËZVE

Hyrje

Trafikimi i qenieve njerëzore është paraqitur kryesisht pas shkatërrimit të ish Bashkimit Sovjetik, ish shteteve socialiste dhe luftërave në ish territoret Jugosllave. Trafikimi i qenieve njerëzore është një dukuri negative me të cilën ballafaqohen shumë shtete dhe vazhdon të jetë shqetësim i madh për to. Njerëzit trafikohen në mënyra të ndryshme. Shumica e tyre bëhen viktimë e trafikimit duke ju premtuar punë të mirë, jetë luksoze, pagë të madhe dhe beneficione tjera dhe vetëm më vonë e marrin vesh se ata janë viktimë e trafikimit. Gratë dhe vajzat kryesisht rekrutohen për tu marrë me prostitucion dhe punë tjera të detyrueshme.

Trafikimi i njerëzve, personave që merren me trafikim u sjell përfitime të madha.

Krimet që i përjetojnë personat e trafikuar nganjëherë përfshijnë edhe akte të tmerrshme, siç janë: dhunimet, tortura, shkeljen dhe cenimin e të drejtave të njeriut dhe ndonjëherë mund ta cenojnë sigurinë nacionale dhe ndërkombëtare kur kjo bëhet nga Organizata kriminale transnacionale.

Shpeshherë disa nga personat e trafikuar frikohen ta paraqesin te organet e shtetit shfrytëzimin të cilin janë duke e përjetuar si viktimë e trafikimit.

Trafikimi me njerëz është problem i madh, si nga aspekti i shtrirjes gjeografike po ashtu edhe nga numri i njerëzve të trafikuar. Për ta ilustruar këtë po i paraqesim disa raporte të Organizatave Ndërkombëtare.

Sipas një raporti të përgjithshëm të vitit 2005 të Organizatës Botërore të Punës, mbi punën e detyruar apo dhunshme, del se çdo vit 2.45 milion njerëz në tërë botën trafikohen për punë të dhunshme.

Fondi i Fëmijëve i Kombeve të Bashkuara (UNICEF) vlerëson se gati 1.2 milion fëmijë trafikohen çdo vit.

Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogë dhe Krim (UNODC), duke u bazuar në bazat e të dhënave për tendencat e trafikimit raporton se njerëzit trafikohen nga 127 shtete për tu shfrytëzuar në 137 shtete tjera të botës.

Në Kosovë sipas një analize të rasteve të trafikimit me njerëz, të bërë nga Seksioni për monitorim të sistemit ligjor të OSBE-së, nga fillimi i vitit 2006, në gjykatat e Kosovës kanë qenë të pakryera 41 lëndë të trafikimit me njerëz.

Kuptimi i veprës penale të trafikimit me njerëz

Në grupin e veprave penale kundër të drejtës ndërkombëtare, hynë edhe vepra penale trafikimi i njerëzve e paraparë në nenin 139 të Kodit Penal të Kosovës. Në fillim të shekullit njëzet trafikimi me njerëz është paraparë si vepër penale me disa konventa ndërkombëtare me të cilat ndalohet dhe ndëshkohet trafikimi me njerëz, ndër to më të rëndësishme janë: Konventa mbi ndalimin e tregtisë me robër të bardhë të vitit 1910, Konventa për ndëshkimin e tregtisë me gra dhe fëmijë e vitit 1921, Konventa për ndëshkimin e tregtisë me gra të rritura, të moshës madhore e vitit 1933 dhe Konventa për ndëshkimin

dhe parandalimin e tregtisë me njerëz dhe eksploatimin e tyre për qëllime prostitucioni."¹

Vepra penale trafikimi me njerëz është paraparë në nenin 139 të Kodit Penal të Kosovës. Sipas paragrafit 8, pika 1 të këtij neni, shprehja "trafikim me njerëz" do të thotë, rekrutim, transportim, transferim, strehim ose pranim i personave me anë të mjeteve të kërcënimit ose të përdorimit të forcës apo me forma të tjera të detyrimit, rrëmbim, falsifikimit, mashtrimit apo keqpërdorimit të pushtetit apo të pozitës ose të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies a marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit, që ka kontroll mbi personin tjetër me qëllim të shfrytëzimit"²

Këtë veprë penale konsiderohet se e kryen edhe personi i cili e di se personi i caktuar është viktimë e trafikimit dhe përkundër kësaj e shfrytëzon për qëllime seksuale paragrafi 5.

Forma të rënda të veprës penale të trafikimit me njerëz konsiderohen këto raste: nëse vepra penale kryhet ndaj personit nën moshën 18 vjeçare paragrafi 2, nëse personi i caktuar e organizon grupin e njerëzve, pra është organizator me qëllim të kryerjes së trafikimit me njerëz paragrafi 3, nëse vepra penale kryhet nga personi zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës së tij. Si formë e rëndë e kësaj vepre penale nuk është paraparë edhe rasti kur trafikimi i njerëzve kryhet në aso mënyre, e cila rrezikon jetën apo sigurinë e personave të cilët trafikohen sepse shpesh, trafikimi i njerëzve bëhet me aso mjete apo rrethana si në kohë dimri, natën, maleve të pakalueshme, me kamion të mbyllur, ujërave, etj. me të cilat rrezikohet seriozisht jeta e viktimave të trafikimit. Po ashtu si formë e rëndë e kësaj vepre penale duhet të parashihet edhe nëse gjatë trafikimit të njerëzve është shkaktuar vdekja e një apo më shumë personave. Për këto forma të trafikimit me njerëz do të duhej të parashihej dënime më të rënda."³

Këto forma të veprës penale të trafikimit me njerëz mund t'i kryej çdo person, përveç formës së paraparë në paragrafin 7 të cilën mund ta kryej vetëm personi zyrtarë.

1 Dr. Ismet Salihu, E Drejta Penale, Pjesa e Posaçme, Prishtinë, 2006, fq.96

2 Po aty.

3 Po aty.

Kjo veprë penale mund të kryhet vetëm me dashje, përveç rastit të paraparë në paragrafin 4 të këtij neni, që mund të kryhet edhe nga pakujdesia e cila konsiston në mundësimin, gjegjësisht lehtësimin e kryerjes së trafikimit me njerëz.

Elementet e veprës penale të trafikimit me njerëz

Nga përkufizimi del se elementet e veprës penale të trafikimit me njerëz janë: rekrutimi, transportimi, transferimi, strehim ose pranim i personave me anë të mjeteve të kërcënimit ose të përdorimit të forcës apo me forma të tjera të detyrimit, rrëmbimit, falsifikimit, mashtrimit, apo keqpërdorimit të pushtetit apo pozitës ose të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies apo marrja e pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit, që ka kontroll mbi personin tjetër me qëllim të shfrytëzimit.

Nga përkufizimi i nenit 139 të KPPK shohim se vepra penale trafikimi me njerëz i përmban tri grupe të elementeve:

1. Në grupin e parë hyjnë, rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pranimi i personave,
2. Në grupin e dytë hyjnë, mjetet e kërcënimit ose të përdorimit të forcës apo me forma tjera të detyrimit, rrëmbimit, falsifikimit, mashtrimit apo keqpërdorimit të pushtetit ose të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies a marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit, që ka kontroll mbi personin tjetër dhe
3. Në grupin e tretë hyn, qëllimi i shfrytëzimit. Shfrytëzimi është përkufizuar si "shfrytëzim i prostitucionit të të tjerëve ose formave tjera të shfrytëzimit seksual, shërbimeve ose punës së detyruar, skllavërisë ose veprimeve të ngjashme me skllavërinë, robërisë ose heqjes së organeve."

Shfrytëzimi për punë të detyrueshme mund të jetë në ndërtimtari, bujqësi, punë shtëpiake, lëmosh, prostitucion dhe forma tjera të shfrytëzimit seksual.

Këto tri elemente që dallohen midis vetit mund të shihen si, elementi i veprimit që përfshin, rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi

ose pranimi i personave, elementi i mjetit, që përfshin kërcënimi ose përdorimi i forcës apo format tjera të detyrimit, rrëmbimit, falsifikimit, mashtrimit apo keqpërdorimit të pushtetit ose të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies a marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit, që ka kontroll mbi personin tjetër dhe elementi mental apo psikik, pra qëllimi i shfrytëzimit të personit të trafikuar. Dy elementet e para kërkojnë veçanërisht ekzistimin e veprimit, ndërsa elementi i tretë kërkon ekzistimin e qëllimit të kryesit.

1) Elementi i veprimit

Elementi i parë ose elementi i veprimit mund të plotësohet përmes njëres nga pesë veprimet me radhë, respektivisht: (i) rekrutimi; (ii) transportimi; (iii) transferimi; (iv) pranimi; ose (v) strehimi i personit.

- i. Rekrutimi - nënkupton punësimin e personit. Nuk kërkohet që rekrutuesi të ketë për qëllim ta paguajë atë person. Rekrutimi mund të ndodhë jashtë vendit e po ashtu edhe në fshatin ose vendlindjen e viktimës.
- ii. Transportimi - nënkupton lëvizjen fizike të personit nga një lokacion në tjetrin. Kjo nuk kërkon domosdo kalimin e kufijve: një person mund të trafikohet edhe përbrenda Kosovës.
- iii. Transferimi - nënkupton dhënien e kontrollit mbi një person, një personi tjetër, i cili pastaj e pranon viktimën e trafikimit. Përderisa pagesa me të holla mund të jetë dëshmi që ka ndodhur trafikimi, nuk është element i nevojshëm në veprën penale të trafikimit.
- iv. Pranimi - është marrja e kontrollit mbi viktimën, zakonisht nga ndonjë person që më parë e ka rekrutuar ose transferuar viktimën.
- v. Strehimi - nënkupton sigurimin e dhomës ose një hapësire tjetër për personin, por pa e pranuar atë në cilësinë e viktimës në të kundërtën do të ekzistonte pranimi.

2) Elementi i mjetit

Elementi i dytë i veprës penale të trafikimit është i ashtuquajtur i elementi i mjetit. Ky kusht aplikohet vetëm nëse viktimë e trafikimit është e moshës madhore.

Posaçërisht në nenin 139 të KPK, kërkohet që kryesi të ketë kryer veprimet rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin ose pranimin e personave në raport me viktimën me mjete të kërcënimit ose të përdorimit të forcës apo me forma tjera të detyrimit, rrëmbimit, falsifikimit, mashtrimit apo keqpërdorimit të pushtetit ose të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies a marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit, që ka kontroll mbi personin tjetër. Prandaj, vetëm transferimi, pranimi, strehimi, rekrutimi ose transportimi i personit nuk përbën në vete veprën penale të trafikimit nëse nuk plotësohet edhe kushti i mjetit, pra të jetë përdorur, kërcënimi, forca, detyrimi, etj.

3) Elementi mental-psikik

Elementi i tretë i veprës penale të trafikimit është elementi mental apo kushti subjektiv, pra shfrytëzimi i qëllimshëm i viktimës. Ashtu si është paraparë qartë sipas nenit 139 të KPK, shfrytëzimi përfshin por nuk kufizohet në prostitucionin, shërbimet tjera seksuale, punë të detyruar, skllavërim, robërim ose heqje të organeve.

Qëllimi i shfrytëzimit është elementi mental me fjalë të tjera veprimi dhe mjeti te kryesi duhet të kenë për qëllim shfrytëzimin e viktimës. Prandaj, nuk është e domosdoshme që kryesi i veprës në të vërtetë ta shfrytëzojë viktimën.

Si rrjedhim, nëse veprimet dhe mjetet të kryera nga kryesi, si p.sh. "transferimi me përdorim të forcës, pranimi me anë të mashtrimit, etj. janë bërë me qëllim tjetër nga ai i shfrytëzimit të viktimës p.sh. me qëllim të fitimit të parave nga viktima, vepra penale e trafikimit nuk është kryer. Sidoqoftë, edhe nëse elementi subjektiv i veprës penale të trafikimit nuk është plotësuar i dyshuari mund të ndiqet penalisht për krime tjera, p.sh. lehtësimin e prostitucionit, kontrabandimi me imigrantë, etj."¹⁴

Kur është në pyetje trafikimi i fëmijëve Kodi Penal i Kosovës, përcakton shkallë më të ulët të dëshmive për trafikimin e fëmijëve se sa për trafikimin e personave madhor. Neni 139 parag.8/4 i KPK e bën të

4 Analiza ligjore e rasteve të trafikimit me njerëz në Kosovë, OSBE, tetor 2007, faqe 7.

qartë se rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pranimi i fëmijës me qëllim të shfrytëzimit, duhet të konsiderohet si "trafikim i qenieve njerëzore" edhe nëse kjo nuk përfshin asnjë nga mjetet e përdorimit të forcës, detyrimit, kërcënimit, etj.

Kështu, kur të miturit rekrutohen, transportohen, transferohen, strehohen ose pranohen, nuk është e nevojshme të provohet që fëmija është mashtruar, kërcënuar, etj. "Përderisa është logjikisht e pamundur që të ketë veprë të trafikimit të personave madhorë sipas përkufizimit nga neni 139 i KPPK në të cilën nuk janë përdorur një ose më tepër nga mjetet, pra kërcënimi, detyrimi etj. Ndërsa nuk nevojitet kushti i mjetit në rastet kur viktima të trafikimit janë fëmijët. Prandaj, vetëm thjeshtë rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pranimi i fëmijës me qëllim të shfrytëzimit, çdoherë i përmbush të gjitha elementet e veprës penale të trafikimit".⁵

Pra, elementi qenësor i veprës penale të trafikimit me njerëz është qëllimi i shfrytëzimit të personit.

Lidhur me pëlqimin e viktimës, duhet të cekim se nuk mund të bëhet fjalë për pëlqimin e viktimës nëse është përdorur kërcënimi, përdorimi i forcës, duke përfshirë edhe detyrimin, rrëmbimin, mashtrimin, falsifikimin, keqpërdorimin e pushtetit apo pozitës, keqpërdorimin e një pozite të ndjeshme, dhënia apo marrja e pagesave apo përfitimeve për tu arritur pëlqimi i viktimës së trafikimit me qëllim të shfrytëzimit.

- Në shembull nga praktika se si duket vepra penale e trafikimit me njerëz.

Besa është 17 vjeç nga qyteti i Prishtinës, një ditë duke shëtitur ndalet nga një mik i saj me emrin Arsim, për të biseduar gjatë bisedës e bind Besën që të shkojnë në një lokal për të pirë kafe, por posa Besa hyn në makinë Arsimi me shpejtësi largohet në drejtim të Malit të Zi. Me të arritur në Ulqin, Arsimi hyn në një lokal dhe e fton shokun e tij Agimin, që të vijë në hotelin "Shpati" për ta parë Besën dhe për t'i sjellë parat.

5 Po aty.

Me të arritur Agimi, në hotelin "Shpati" dhe me të parë Besën ai i thotë Arsimit se Besa nuk i plotëson kushtet për tu marrë me "atë punë" dhe refuzon që t'ia jep paratë.

Pas kësaj Arsimi vendos që të kthehet në Prishtinë, dhe me të arritur në Prishtinë, e drejton automjetin në drejtim të hotelit "Lumi", për tu takuar me një shok me emrin Naim dhe në telefon i thotë se do ta sjellë Besën për të punuar si prostitutë në hotelin "Lumi" në Prishtinë, për çka merr një mesazh nga Naimi se puna është rregulluar dhe se Besa do të filloj të punoj në atë hotel.

Me të arritur në hotel "Lumi" Besa fillon të punoj si prostitutë dhe ndërron disa klient brenda pak ditësh, por njeri nga klientët mëson se Besa ishte detyruar që të merret me prostitucion dhe se ajo ishte kërcënuar se nëse nuk pranon të punoj apo nëse i tregon dikujt do ti shkaktojnë një të keq vëllait të saj të vetëm.

Në këtë rast janë të përmbushura të gjitha elementet e veprës penale të trafikimit me njerëz, si elementi i veprimit, mjetit dhe qëllimit.



Qerim ADEMAJ

ARRESTIMI I PËRKOHSHËM DHE NDALIMI POLICOR

Masa e arrestit të përkohshëm dhe ndalimit policor, parashihet me nenet 210 deri 219 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.¹

Sipas dispozitës së nenit 210, kjo masë kjo masë mund të zbatohet si nga policia, e po ashtu edhe nga çdo person tjetër privat, në rast se një person kapet në flagrancë gjatë kryerjes së një vepre penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare ose ai person është në ndjekje për ndonjë vepër penale të kryer më herët.

Mirëpo sa i përket arrestit nga personat privat, në aspektin juridik të legjislacioneve procedurale të së drejtës në Bosnjë dhe në Kroaci është duke u hequr, ku të njëjtat shtete këtë të drejtë e kanë shndërruar në të drejtën *"e secilit person apo qytetar që të pengojë largimin e personit të gjetur në flagrancë të kryerjes së veprës penale"*. Arsyetimet janë të logjikshme ngase qytetari nuk ka as mjete dhe as aftësi për arrestimin e personit dhe as mundësinë e aplikimit të dhunës absolute. Teoria e së drejtës se procedurës penale konsideron se kryesi i veprës penale mund të këshillohet ose të nxitet që të mos largohet nga vendi i ngjarjes, ndërkaq veprimet e arrestimit të dhunshëm nga personi privat të kryesit të veprës penale vihen në dyshim.²

1 Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, është shpallur me rregulloren e UNMIK-ut, nr. 2003/26, te datës 06.07.2003 dhe ka hyrë në fuqi me datën 6 Prill 2008 (në tekstin e mëtejshëm KPPK). KPPK është ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 03/L-003 te datës 6 Nëntor 2008.

2 Xhevdet Elshani dhe Mejdi Dehari, Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, pjesa III-IV, prezantimi III, faqe 3. Instituti Gjyqësor i Kosovës- Prishtinë.

Ky dyshim vjen ne shprehje ngase në praktikë kanë ndodhur raste kur kryesi është zënë ne flagrancë dhe në rastet kur nuk është ndalur sipas udhëzimit të pronarit, kryesit të veprës penale nga vet pronari i janë shkaktar lëndime të rënda trupore, madje edhe në rastet kur kryesi ka qenë person i mitur.

Po ta shikojmë edhe kushtetutën e Republikës së Kosovës, përveç se në KPPK, nuk mund të interpretohet se personat privat mund ta bëjnë arrestin e kryesve të zënë në flagrancë, meqë nga këto dispozita me pa mëdyshje del se arrestin mund ta kryejnë vetëm organet e autorizuara ligjore dhe atë policia, ngase dispozita e nenit 210 të KPPK-së ka rrezik që në opinion të krijon anarki të llojit të vet, madje edhe të keqpërdoret ky autorizim nga qytetarët.³

Arrestimi paraqet marrjen faktike të lirisë së qytetarit në mënyrën e paraparë ligjore nga organet e autorizuara shtetërore (Policia), për të cilën masë policia nuk merr ndonjë aktvendim me shkrim. Kjo masë zgjatë aq kohë sa është e nevojshme që personi i arrestuar të sillet në gjykatë ose stacion policor dhe për këtë duhet menjëherë të njoftohet prokurori publik kompetent, lidhur me arsyet e arrestimit dhe ndërmarrjen e masave dhe veprimeve të mëtejme lidhur me arsyeshmërinë ose jo të ndalimit të tij.

Sipas dispozitës se nenit 211 të KPPK-së, policia një person mund ta privoj nga liria ne rast se:

- ekziston dyshimi i bazuar se personi i tillë ka kryer vepër penale,
- ekzistojnë arsyet për ndalim të parapara me nenin 281 parag.2 pika i, ii, iii dhe nënparag. 3 i KPPK-së, siç janë: vërtetimi i identitetit të kryesit, fshehja e tij, rreziku i ikjes se tij, asgjësimi, fshehja, ndryshimi, falsifikimi i provave të veprës penale, pengimi i procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarë, të dëmtuar, bashkëkryesit, peshës së veprës penale, karakteristikave të tija personale, sjellja e tij e mëparshme, ambienti dhe kushtet në të cilat jeton si dhe ndonjë rrethanë tjetër personale që tregon rrezikun se ai person mund të

3 Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka hyrë ne fuqi me date 15 Qershor 2008

- përsërisë veprën penale ose ta kryej veprën penale për të cilën është kanosur ta kryej dhe
- që policia pa vonesë duhet ta sjellë te gjyqtari i procedurës paraprake për të vendosur mbi paraburgimin.

Duke shikuar dispozitën e nenit 211 të KPPK-së, mund të konkludojmë se e njëjta është mjaft e paqartë dhe bie në kundërshtim të plotë me dispozitën e nenit 212 parag.5 të KPPK-së, sipas së cilës sa ma shpejtë që është e mundur pas arrestimit, por jo më vonë se gjashtë (6) orë nga koha e arrestimit, prokurori publik ose oficeri i autorizuar i policisë personit të arrestuar i lëshon vendimin mbi ndalim, ku e njëjta dispozitë gjithashtu është në kundërshtim edhe me nenin 282 par 1 të KPPK-së, sipas së cilës dispozitë paraburgimin e cakton gjyqtari i procedurës paraprake i gjykatës kompetente dhe atë në bazë të kërkesës me shkrim të prokurorit publik pas mbajtjes së seancës së dëgjimit.

Nga kjo mund të vijmë në përfundim se arrestimi dhe ndalimi i personit bëhet me autorizim të prokurorit publik dhe se masën e paraburgimit gjyqtari i procedurës paraprake nuk mund ta zbatojë pa kërkesë të prokurorit publik. Dispozita e nenit 211 të KPPK-së, sa i përket gjyqtarit të procedurës paraprake për të vendosur për paraburgim pa kërkesë të prokurorit publik, praktikisht mund të thuhet se plotësisht është e pazbatueshme.

Sipas dispozitës së nenit 212 të KPPK-së, në rrethana të ngutshme policia mund të arrestojë dhe ndalojë personin kur :

- ekziston dyshimi i bazuar se ai ka kryer veprën penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare,
- ekzistojnë arsyet për ndalim të parapara me nenin 281 par gag.1 nënparag.2 pikat (i) dhe (iii) të KPPK-së, siç janë: vërtetimi i identitetit të kryesit, fshehja e tij, rreziku i ikjes së tij, peshës së veprës penale, karakteristikave të tija personale, sjellja e tij e mëparshme, ambienti dhe kushtet në të cilat jeton si dhe ndonjë rrethanë tjetër personale, që tregojnë rrezikun se ai person mund të përsërisë veprën penale ose ta kryej veprën penale për të cilën është kanosur ta kryej, ose ka arsye për tu frikësuar se personi i arrestuar mund të asgjësojë

gjurmët e veprës penale, të paraparë me nenin 281 parag.1 nënparag.2 pika (ii) e këtij Kodi, ku policia në këtë rast për shkak të rrethanave të ngutshme dhe të arsyeshme nuk ka arrit që të marrë autorizimin nga prokurori publik, mund të ndalojë dhe arrestojë personin, mirëpo menjëherë duhet ta informoj prokurorin publik lidhur me arrestimin dhe arsyet e arrestimit.

Personi i arrestuar, menjëherë me rastin e arrestimit të tij informohet për të drejtat e tija të parapara me nenin 214⁴ dhe atë:

- informohet në gjuhën që ai e kupton për arsyet e arrestit të tij,
- të heshtë dhe të mos përgjigjet në asnjë pyetje, përveç dhënies së informatave mbi identitetin e tij,
- ti sigurohet përkthim falas nëse nuk e kupton gjuhën e policit,
- të shfrytëzojë ndihmën e mbrojtësit dhe për ndihmë ligjore ti caktohet mbrojtësi sipas detyrës zyrtare nëse nuk ka mundësi ta paguajë vet, i cili paguhet nga mjetet buxhetore të Kosovës,
- për arrestim të ketë mundësi që personalisht ose të kërkojë nga policia që ta lajmërojë ndonjë anëtar të familjes ose ndonjë person sipas zgjedhjes së tij,
- të ketë kontroll dhe trajtim mjekësor duke përfshirë edhe trajtimin psikiatrik.

Nëse personi i arrestuar është shtetas i huaj, ai ka të drejtë të njoftojë ose të kërkojë të njoftohet dhe të komunikojë gojariisht apo me shkrim me zyrën e ndërlidhjes apo misionin diplomatik të shtetit, shtetas i të cilit është ai, ose më përfaqësuesin e organizatës kompetente ndërkombëtare kur ai është refugjat ose është nën mbrojtjen e ndonjë organizate ndërkombëtare.

Personit të arrestuar sipas nenit 212 parag.5 të KPPK-së, menjëherë pas arrestimit por jo më vonë se gjashtë orë nga koha e arrestimit të tij, prokurori publik ose oficeri i lartë i autorizuar i policisë duhet ti lëshon vendimin mbi ndalim i cili përfshin;

4 Kur thirremi në dispozitat ligjore të procedurës penale, duhet të kihet parasysh se gjithnjë ju referohemi dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

- emrin dhe mbiemrin e personit të arrestuar,
- vendin, ditën dhe kohën e saktë të arrestimit,
- veprën penale për të cilën dyshohet,
- bazën juridike për arrestim dhe
- udhëzimin juridik se kundër vendimit ka të drejtë ankesë drejtuar gjyqtarit të procedurës paraprake të gjykatës kompetente.

Nëse personi i arrestuar ushtron ankesë kundër vendimit mbi arrestimin e tij, policia dhe prokurori publik detyrohen që ankesa t'i jetë dërguar gjyqtarit të procedurës paraprake. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit dhe se gjyqtari i procedurës paraprake për ankesë vendos brenda 48 orëve nga momenti i arrestimit (neni 212 parag.6 të KPPK-së).

Personi i arrestuar sipas vendimit të prokurorit publik apo oficerit të lartë të autorizuar policor, në ndalim policor mund të qëndrojë më së shumti 48 orë (neni 212 parag. 4 i KPPK-së). Para se të kalon afati kohor prej 48 orëve personi i ndaluar duhet të dërgohet tek gjyqtari i procedurës paraprake, i cili sipas nenit 29 pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës vendos për paraburgimin ose lirimin e tij, jo më vonë se 48 orë nga momenti kur personi i ndaluar është sjellë para gjykatës.

Ndalimi sipas vendimit të prokurorit publik apo oficerit të lartë të autorizuar policor nuk mund të kalojë 48 orëshin, sepse nëse kalon ky afat, policia janë të detyruar ta lirojnë personin e ndaluar, përveç rastit kur gjyqtari i procedurës paraprake ka urdhëruar paraburgimin.

Kur personi i arrestuar vet nuk angazhon mbrojtës, mbrojtësin sipas nenit 69 parag.6 të KPPK-së, mund ta angazhojnë anëtarët e tij të familjes, siç është përfaqësuesi i tij ligjor, bashkëshorti apo bashkëshorti jashtëmartesor, personi i gjakut në vijë të drejtë, prindi adoptues, vëllai, motra dhe ushqyes, mirëpo jo kundër vullnetit të tij.

Është kusht ligjor (neni 213 parag. 1 të KPPK-së) që personi i arrestuar, ka të drejtë në ndihmë të menjëhershme të mbrojtësit të cilin e angazhon sipas zgjedhjes së tij, mirëpo edhe nga ky kusht ligjor ka përjashtim ngase me nenin 213 parag.5 të KPPK-së, parashihet se

personit të arrestuar i cili dyshohet për terrorizëm ose krim të organizuar nuk mund ti angazhohet mbrojtësi sipas zgjedhjes se tij, kur ka arsye për dyshim se mbrojtësi i zgjedhur nga i arrestuari është i përfshirë në kryerjen e veprës penale ose do të pengojë zbatimin e hetimeve, ku gjyqtari i procedurës më kërkesë të arsyetuar të prokurorit publik, mund të urdhërojë caktimin e mbrojtësit tjetër që ta përfaqësojë të arrestuarin dhe atë më së shumti 72 orë nga koha e arrestimit.

Personi i arrestuar mund të heq dorë nga e drejta për të angazhuar mbrojtës, përveç rasteve kur kemi të bëjmë me mbrojtje të detyruar të parapara me nenin 73 të KPPK-së. Kur i arrestuari heq dorë nga e drejta për të pasur mbrojtës, këtë duhet ta bëjë në mënyrë të qartë, pasi që fillimisht të jetë informuar mirë nga prokurori publik ose policia se ka të drejtë të angazhojë mbrojtës dhe se mbrojtësi i tij mund të jetë prezentë gjatë marrjes se tij në pyetje.

Heqja dorë nga mbrojtësi duhet të bëhet në mënyrë vullnetare nga personi i arrestuar, duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të nënshkruhet nga i arrestuari dhe organi i cili zbaton procedurën qoftë prokurori apo policia, e po ashtu mund të bëhet edhe gojarisht nëpërmes audio incizimit, autenticiteti i së cilës mund të vërtetohet nga gjykata (neni 69 par 3 te KPPK-së).

Nëse i dyshuari ose i pandehuri njëherë ka hequr dorë nga e drejta në angazhimin e mbrojtësit dhe këtë të drejtë e kërkon sërish, ai mund ta ushtrojë menjëherë këtë të drejtë duke angazhuar mbrojtës sipas zgjedhjes se tij (neni 69 par 5 i KPPK-së).

Kur i arrestuari është person i mitur⁵, i cili nuk ka mbushur 18 vite, policia është e detyruar që menjëherë të lajmërojë përfaqësuesin e tij ligjor, për arrestimin, vendin e ndalimit ku gjendet i mituri dhe për çdo ndryshim të vendit të ndalimit dhe çka është karakteristikë tek mbrojtja e personave nën moshën 18 vjeçare se ata mund të heqin dorë nga e drejta për të angazhuar mbrojtës vetëm me pëlqimin e prindit, kujdestarit ose përfaqësuesit nga qendra për punë sociale,

5 Termi "i mitur" do të thotë personi ndërmjet moshës katërbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjeçare, neni 2 parag. 2 i Ligjit Penal për të Mitur, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/8, të datës 20 Prill 2004.

përveç në rast të dhunës familjare në të cilën është i përfshirë prindi apo kujdestari, ku të njëjtit nuk mund të japin pëlqimin për heqje dorë nga e drejta për të angazhuar mbrojtës për të miturin (neni 69 par 4 te KPPK-së).

Po ashtu personat që kanë çrregullime mendore ose shprehin shenja të paaftësisë mendore, nuk mund të heqin dorë nga e drejta për të angazhuar mbrojtës.

Praktika gjyqësore në Kosovë ka treguar se ndër shkeljet më të shpeshta që bëhen sa i përket procedurës penale, bëhen pikërisht në fazën e procedurës hetimore, ku në raste të shpeshta policia dhe prokurorët, me rastin e marrjes në pyetje të të dyshuarve nuk i njoftojnë me të drejtat e tyre të parapara me nenet 229-236, ku këtu hyn edhe e drejta për të angazhuar mbrojtës sipas zgjedhjes së tij, apo për të angazhuar mbrojtës sipas detyrës zyrtare në rast se nuk ka mjete për ta paguar vet i arrestuari, për çka për gjykatën deklaratat e të dyshuarve të marra në polici dhe prokurori pa u respektuar dispozitat e lartcekura, janë provë e papranueshme.

Kur personi i arrestuar tregon shenja të çrregullimit mendor ose paaftësisë mendore, policia është e detyruar që menjëherë pas arrestit të lajmërojë personin e caktuar nga personi i arrestuar si dhe qendrën për punë sociale për arrestimin dhe vendin e ndalimit ku gjendet personi i arrestuar si dhe për çdo ndryshim eventual të mëvonshëm të vendit të ndalimit.

Edhe pse lajmërimi i anëtarëve të familjes dhe organeve tjera kompetente për arrestimin e personave të dyshuar është kusht ligjor, nga kjo rregull ka një përjashtim sa i përket afatit të lajmërimit, ngase sipas nenit 215 parag.4 të KPPK-së, ky lajmërim mund të shtyhet më së shumti për 24 orë në rast se prokurori publik çmon se kjo kushtëzohet me nevoja të jashtëzakonshme për hetimin e rastit, mirëpo ky kusht nuk vlen kur kemi të bëjmë me persona me çrregullime mendore dhe persona që nuk kanë mbushur moshën 18 vjeçare.

Personi i arrestuar në çdo kohë pas arrestit dhe ndalimit, më kërkesën e tij ka të drejtë të kontrollohet nga mjeku ose dentisti sipas zgjedhjes së tij, të cilët duhet ti sigurohen në kohën sa më të shpejtë të

mundshme, e kur mjeku ose dentisti sipas zgjedhjes së tij s'mund t'i sigurohet, atëherë policia cakton një mjek ose dentist tjetër.

Po ashtu me kërkesën e tij apo anëtarëve të familjes së tij, personi i arrestuar ka të drejtë në trajtim mjekësor, psikiatrik kurdo që është e nevojshme. Policia gjithashtu cakton një mjek për të kryer kontrollin mjekësor në çdo rast të lëndimit fizik të të arrestuarit apo edhe nevojave tjera mjekësore (neni 216 parag.3 të KPPK-së). Mirëpo nëse i arrestuari refuzon ti nënshtrohet kontrollit dhe trajtimit mjekësor, i takon mjekut që të marrë vendimin përfundimtar për tretman mjekësor, por gjithnjë duke respektuar të drejtat e të arrestuarit.

Nëse personi i arrestuar shpreh shenja të sëmundjes mendore, policia menjëherë mund të urdhërojë kontrollin nga një psikiatër. Rezultatet e çdo kontrolli apo tretmani mjekësor, sipas rregullit regjistrohen dhe shënimet e tilla janë në dispozicion për personin e arrestuar si dhe mbrojtësin e tij.

Neni 217 i KPPK-së, parasheh që personi i arrestuar duhet të ndahet nga personat e dënuar apo të paraburgosur, nuk mbahet në të njëjtën dhomë me personat e gjinisë tjetër dhe duhet ti sigurohen tri racione ushqim në ditë nëse është ndaluar për më shumë se 12 orë. Po ashtu brenda 24 orëve personi i arrestuar ka të drejtën në së paku 8 orë pushim pandërprerë dhe gjatë kësaj kohë është e ndaluar që të merret në pyetje ose të trazohet nga policia lidhur me hetimin.

Përveç të drejtave të parapara me nenin 214 të KPPK-së, për të cilat duhet të njoftohet personi i arrestuar, e të cilat të drejta janë cekur me lartë, me nenin 231 parag.2 të KPPK-së është paraparë që i arrestuari duhet të njoftohet edhe më këto të drejta:

- veprën penale për të cilën dyshohet,
- se deklarata e tij e dhënë mund të përdoret si provë para gjykatës dhe
- se ka të drejtë të kërkojë marrjen e provave për mbrojtjen e tij.

Marrja në pyetje e të pandehurit bëhet duke respektuar plotësisht dinjitetin e tij, pyetjet duhet ti bëhen në mënyrë të qartë, të

kuptueshme, dhe të përpiktë. Ndalohet që të pandehurit ti bëhen pyetje sugjestive, të qëndrojnë në këmbë, ti mohohet ushqimi, uji si dhe tretmani mjekësor i nevojshëm. Gjatë marrjes në pyetje të personit të ndaluar apo arrestuar, bëhen pushime të shkurtra në intervale kohore përafërsisht dy orësh, por pushimi mund të shtyhet kur për shkaqe të arsyeshme, kur ka arsye për të besuar se shtyrja do të:

- shkakton rrezik për lëndim të personave ose humbje a dëmtim të rëndë të pasurisë,
- shtyjë pa nevojë ndalimin e personit ose përfundimin e marrjes në pyetje dhe
- të prejudikon rezultatin e hetimeve,

Marrja në pyetje e të arrestuarit duhet që atij t'i ofrojë mundësinë për të kundërshtuar arsyet e dyshimit kundër tij dhe për të nxjerrë në dritë faktet dhe provat që shkojnë në favor të tij. Personi i arrestuar në pyetje merret gojarisht, mirëpo gjatë marrjes në pyetje të njëjtit i lejohet që të mbajë shënime (nenet 216, 218, 233 dhe 234 të KPPK-së).

Gjatë marrjes në pyetje (neni 155 i KPPK-së), ndalohet që tek personi i arrestuar të:

- ndikohet në çfarëdo mënyrë apo forme për tu shprehur dhe formuluar përgjigjet e tij, nëpërmjet keqtrajtimit, ndërhyrjes fizike duke përdorur dhunën, kanosjen, torturën, shtrëngimin, duke i ofruar mjete hipnotizuese, etj.
- t'i premtohet ndonjë përfitim që nuk është paraparë me ligj,
- të kanoset me ndonjë masë që është e ndaluar me ligj ose
- t'i dobësohet kujtesa ose aftësia e tij për të kuptuar.

Sipas nenit 219 të KPPK-së, policia mbanë një dosje të vetme për të gjitha veprimet e marra lidhur me personin e arrestuar ku përfshihen:

- të dhënat personale të të arrestuarit,
- arsyet e arrestimit të tij,
- veprën penale për të cilën dyshohet,
- autorizimin ose njoftimin e prokurorit publik,
- vendin, datën dhe kohën e saktë të arrestimit,

- rrethanat e arrestimit,
- çfarëdo vendimi të prokurorit ose të oficerit të lartë të autorizuar policor lidhur me ndalimin,
- vendimin e ndalimit,
- identitetin e oficerit policor dhe të prokurorit përkatës publik,
- njoftimin gojor dhe me shkrim të personit të arrestuar të parapara me nenin 212 parag. 3 të KPPK-së.
- informimin mbi ushtrimin e të drejtave të parapara me nenin 214 të këtij kodi, veçanërisht e drejta e mbrojtjes dhe e drejta për t'i lajmëruar anëtarët e familjes ose personat tjerë përkatës, lëndimet e dukshme apo shenjat tjera që shtrojnë nevojën për ndihmë mjekësore,
- ndërmarrjen e një ekzaminimi mjekësor ose sigurimin e trajtimit mjekësor dhe
- informacionin mbi kontrollin e përkohshëm të sigurisë së personit dhe përshkrimin e sendeve të marra nga personi në kohën e arrestimit ose gjatë ndalimit.

Policia mban procesverbal për çdo seancë të marrjes në pyetje të personit të arrestuar, duke përfshirë kohën e fillimit dhe të përfundimit të marrjes në pyetje, identitetin e zyrtarit të policisë i cili e ka marrë në pyetje dhe personat tjerë që kanë qenë të pranishëm gjatë marrjes në pyetje. Kur mbrojtësi nuk ka qenë i pranishëm edhe kjo shënohet në mënyrë të rregullt në procesverbal. Ky procesverbal nënshkruhet nga zyra përkatëse e policisë si dhe nga personi i arrestuar.

Nëse personi i arrestuar refuzon nënshkrimin e procesverbalit, autoritetet policore shënojnë refuzimin e tillë dhe ja bashkëngjisin shpjegimin ose komentet eventuale me shkrim ose me gojë të personit të arrestuar.

Këto procesverbale gjithashtu i vihen në dispozicion personit të arrestuar dhe mbrojtësit të tij më kërkesën e tyre, në gjuhën që e kupton i arrestuari, dhe te njëjtat ruhen ne polici për dhjetë vite qe nga koha e përfundimit zyrtar të procedurës penale ose lirimi i personit të ndaluar, nëse lirimi ka ndodhur më vonë se përfundimi i procedurës.

**Sabri HALILI**

GJYQËSORI KOSOVAR, REFLEKSIONET NGA E KALUARA DHE ETIKA GJYQËSORE

Gjendja në drejtësinë kosovare një kohë të gjatë ishte e mbarsur me elemente anakronike nga e kaluara, edhe politike edhe ideologjike, por edhe me nuansa të mungesës së etikës, e shtresuar pos tjerash edhe me mentalitetin e sistemit të njëmendësisë. Në të kaluarën jo shumë të largët, drejtësia kalkulohej dhe bëhej duke zbatuar vendime dhe urdhra politike, të gatuar në kancelaritë pushtetmbajtëse - politike. Kishte profesionistë në gjyqësor, që ishin vetëm zbatues të devotshëm të politikave ditore të këtyre kancelarive. Megjithatë, sistemi i kaluar gjyqësor ka pasur edhe të mirat e veta, sidomos sa i përket përkujdesjes institucionale ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve. Nga kjo qasje, profesionistët gjyqësor dhe prokurorial, asnjëherë nuk ndiheshin të pasigurt as inferior në punën e tyre, në asnjë segment të shoqërisë, motivoheshin dhe stimuloheshin në shumë mënyra. Megjithatë, për pjesën më të madhe të qytetarëve të Kosovës, sistemi i kaluar gjyqësor ka lënë plagë të shumta.

Kjo çfarë u tha më lartë, përafërsisht ishte një tablo që pasqyron drejtësinë kosovare deri në kohën e luftës së fundit në Kosovë.

Kur "nis drejtësia" në Kosovë

Çfarë ishte gjendja në drejtësinë kosovare pas luftës dhe si pasqyrohet situata aktuale në Kosovën e pavarur? Me çka po ballafaqohet drejtësia pas dhjetë vjetësh nga instalimi i një fryme të re, në trend me shoqëritë demokratike, me prezencën e fuqishme të shteteve me demokraci evropiane e botërore?

Gjendja pas luftës në drejtësi ishte emergjente. Në këtë situatë ajo ishte e rëndë, por me tendenca përmirësimi në vazhdimësi, megjithëse asnjëherë nuk arriti nivelin e kënaqshëm.

Aktualisht, kjo gjendje në drejtësi mund të pasqyrohet me pak fjalë; e rëndë, me tensione të brendshme, me rritje të mosbesimit..., në shikim të parë një gjendje e pa rrugëdalje dhe shumë shqetësuese. Arsyet janë të shumta, por arsye parësore na del se shoqëria, dy pushtetet në Kosovë (ndërkombëtar dhe ai vendor), as gjatë fazës transitore-emergjente, por as sot, nuk i kushtuan dhe nuk i kushtojnë vëmendje aq të sinqertë dhe profesionale, këtij segmenti të rëndësishëm shoqëror. Madje deri më sot janë bërë qasje të diferencuara në drejtësi, varësisht nga regjioni apo përkatësia nacionale. Këtë po e ilustroj me një shembull të dhimbshëm, por që ishte për sa kohë realitet në Kosovë.

Kohë më parë, një gazetë ditore, pasqyronte një titull triumfalist, "Nisë drejtësia...?! Ishte një lajm për fillimin e rifunksionalizimit të gjykatave në veri të Mitrovicës. Pas dhjetë vjet çlirimi dhe pas dhjetë vjet qeverisje, edhe vendore edhe ndërkombëtare të Kosovës, kjo është për keqardhje! Për secilin njeri, e mos të flasim për profesionistët, do të dukej sa absurd aq edhe shqetësues ky titull!

Arsyet për mosfunksionim të drejtësisë në atë pjesë të Kosovës, thonë se janë, pakënaqësitë e serbëve për statusin e Kosovës. Edhe ky është një nonsens sui generis, në një shtet që synon ndërtimin e rendit demokratik dhe shtetin ligjor!

Nëse tashti qenka arsyeja e statusit të Kosovës, për kundërshtimin e drejtësisë në veri, cilat kanë qenë arsyet e mosfunksionimit të drejtësisë në të kaluarën, kur Kosova nuk ishte e pavarur?! Edhe 9 vjetët e kaluara në atë pjesë të Kosovës, nën menaxhimin e UNMIK-ut, gjegjë-

sisht të shoqërive demokratike ndërkombëtare, ndodhën krime ndaj qytetarëve, krime ndaj rendit dhe sigurisë, madje edhe sulme të rënda ndaj forcave të KFOR-it. Edhe BE-ja është "tepër e shqetësuar për kontrabandën më të madhe në Evropë". Megjithatë, për këtë nuk dihet të jetë dënuar deri sot ndonjë grup, apo individ, si bartës i këtyre krimeve.

Përgjigja është e thjeshtë, për ata që dëshirojnë ta shohin problemin me dioptri reale. Segmentet e caktuara politike dhe grupet e organizuara kriminale, të kësaj pjese të Kosovës, në bashkëpunim me grupe jashtë kësaj zone, nuk dëshirojnë të ketë drejtësi.

Kjo gjendje e drejtësisë dhe qasja e diferencuar, varësisht nga nacionaliteti dhe regjioni, për shqiptarët është e njohur vetëm në qeverisjen e vjetër të Kosovës. Edhe atëherë, bëheshin ligje e gjyqe kudo dhe kurdo, vetëm për shqiptarët. Kjo ndoshta është arsye kryesore, pse grupet e caktuara kriminale, e pengojnë drejtësinë dhe shtrirjen e rendit dhe ligjit në gjithë Kosovën. Ata dëshirojnë një terren me një anarki të plotë, me ligje e gjyqe që do i bëjnë vet, apo që ua sjellin të qarqe të caktuara.

Sipas mendimit të shumë profesionistëve vendor, kjo gjendje në drejtësinë kosovare ka qenë e ngjashme, që nga fillimi i viteve nëntëdhjeta, ka vazhduar në periudhën e UNMIK-ut, por askush nuk dëshiron të mendoj që kjo të vazhdoj edhe në periudhën "këshilluese" të EULEX-it.

Si të arrihet qëllimi i drejtësisë

Të gjithë e kanë pasur të qartë se faza transitore do të jetë një proces i rëndë, i përcjellë me vështirësi të shumta. Por, askush nuk e ka menduar se kjo do të zgjaste aq shumë. Edhe nëse dikush ka menduar për këtë kohëzgjatje, kishte shpresa se me kalimin e kohës, krahas ndryshimeve humane profesionale, të bëhen edhe ndryshime pozitive në infrastrukturën e përgjithshme, në përmirësimin e kushteve të punës, të sigurisë dhe të jetës së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Megjithatë, kjo nuk ka ndodhur, ndërsa ende nuk duket asnjë dritë shprese për përmirësime të shpejta. Ata që janë kompetent për të bërë këto ndryshime, nuk investojnë sa duhet për

një ardhmëri më të shëndoshë të drejtësisë. Si pasojë e kësaj, reformat që po paralajmërohen, nuk do të kenë sukses, pa krijimin e të gjitha kushteve, së paku, fillimin e krijimit të kushteve, që do ta nxirrin këtë sektor të shoqërisë nga gjendja e rëndë që ndodhet aktualisht. Vetëm një dritë jeshile në këtë drejtim do të inkurajoj dhe motivoj gjyqtarët dhe prokurorët. Kjo do të ishte një shpresë për opinionin, se do të ndryshoj diçka në drejtësi dhe një motiv për gjyqtarët dhe prokurorët, se duhet të punojnë dhe të japin çdo gjë nga vetja, për profesionin e tyre, që është sa i vështirë aq i rëndësishëm, për secilën shoqëri dhe për secilin shtet ligjor. Suksesi në këtë segment do të jetë i matshëm me krijimin e vetëdijes, edhe politike edhe shoqërore e shtetformuese, gjegjësisht institucionale, për rëndësinë e këtij segmenti shoqëror, si më i rëndësishmi dhe i vetmi për luftimin e krimit të organizuar, korrupsionit dhe dukurive tjera të shëmtuara, që një shoqëri e pasqyrojnë si të pa organizuar dhe të degjeneruar.

Kjo do të bëhet vetëm me ligjet adekuate me të cilët gjyqtarët dhe prokurorët dhe puna e tyre profesionale, do të trajtoheshin ashtu si e meritojnë, ashtu siç trajtohen në të gjitha shoqëritë demokratike dhe në shtetet e njëmendta ligjore. Kjo do arrihet edhe me krijimin e kushteve në infrastrukturë, sidomos atyre teknike, pajisje adekuate për seanca gjyqësore të pandikuara dhe të papenguara. Aktualisht, seancat gjyqësore, mbahen, edhe në prani të personave të tretë, të cilët hynë e dalin kur të dëshirojnë, nëpër zyrrat ku mbahen gjykime, madje edhe penale.

Për ndryshimin e kësaj gjendje, duhet të ndërtohen objekte adekuate, që përkojnë me një gjyqësor të mirëfilltë. Aktualisht, objektet e gjyqësorit janë të vjetruara, jashtë kohës, madje edhe arkitektura e tyre është krejtësisht me imazhe dhe motive të sistemit monist. Dhe, nëse kemi parasysh edhe kushtet e përgjithshme, të apostrofuara më lartë dhe dukuritë korruptive që e kanë kapluar, sidomos drejtësinë në Kosovë, para institucioneve relevante shtetërore, tashmë do të duhej të ishte ndezur sinjali i kuq. Megjithatë, ende nuk shihet një brengë aq e sinqertë e tyre dhe në këtë mënyrë gjyqësori dhe drejtësia në përgjithësi, mbetet nën mëshirën e atyre që dëshirojnë një drejtësi të varur, servile të interesave të ngushta...

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli VII, neni 102, gjyqësorin e përcakton si unik, i pavarur, i drejtë, apolitik... Mirëpo, për shkak të kushteve dhe rrethanave në të cilat punojnë e veprojnë aktualisht gjyqtarët dhe prokurorët, këto dispozita kushtetuese nuk respektohen në masë të duhur, posaçërisht nga disa institucione shtetërore, që efektojnë punën e drejtësisë, me arsyetime të ndryshme, madje shumë joprofesionale dhe banale, siç është edhe ajo e mungesës së infrastrukturës adekuate ligjore. Në të vërtetë, kemi prolongime të pakuptimta të nxjerrjes së ligjit mbi organizimin e gjykatave dhe prokurorive, gjë që bën që gjyqësori të mbetet në varësi indirekte nga pushtetet tjera shtetërore.

Arsyet e tilla nuk mund të pinë ujë, madje as të qytetarët më të thjesht të këtyre hapësirave, sepse asnjë punë tjetër nuk e bëjnë të zgjedhurit e popullit, pos të propozojnë e të miratojnë ligje dhe mu për këtë edhe paguhen bukur mirë. Dhe, në momentin kur miratohet një ligj në Parlament, opinioni konsideron se ai duhet të implementohet, se për të janë planifikuar të gjitha rreziqet dhe pasojat, edhe financiare dhe nuk i njeh arsyetimet e tilla për mungesë të mjeteve financiare....

Perceptime të ndryshme nga këndvështrime të ndryshme

Është e qartë se në Kosovë kemi dy këndvështrime dhe aspekte të perceptimit për gjyqësorin e Kosovës. Njëra anë është krejtësisht e rënduar nga politika ditore, që me vite po imponohet nga çarqe të ndryshme politiko-partiake. Perceptimi i dytë ka të bëjë me humbjen e besimit ndaj gjyqësorit, për shkaqe të shumta, të elaboruara më lartë, sidomos për shkak të refleksioneve nga e kaluara e hidhur.

Aspekti i parë ndërlihet me perceptimin e përgjithshëm të politikës së Beogradit, me çdo gjë në Kosovën e pavarur. Këtu bëhet kalkulimi politik i Beogradit, për të penguar zhvillimet e përgjithshme, sidomos në fushën e sundimit të ligjit në përgjithësi, si alibi politik, për paaftësinë e Kosovës, për të menaxhuar me gjendje të sigurisë dhe të sundimit të ligjit.

Aspekti i dytë ka të bëjë me humbjen e besimit, për shkak të vazhdimësisë së një sistemi, nga i cili, ky popull, nuk e ka realizuar asnjë të drejtë në të kaluarën, të një sistemi të drejtësisë që në çdo

veprim dhe në çdo vendim të tij, ka pasur, ka prodhuar elemente diskriminuuese dhe ka shkel të drejtat elementare të njeriut. Është normale që pritjet e opinionit për ndryshime rrënjësore kanë qenë të mëdha. Megjithatë, ndryshimet kanë shkuar shumë ngadalë, madje në disa raste, në dukje të parë, duket se asgjë nuk ka ndryshuar nga sistemi i kaluar.

Për ndryshimin e këtyre perceptimeve, nuk mjaftojnë vetëm fjalë, por duhet ecur në dy drejtime: Të vendosur për vënien e rendit dhe ligjit në të gjitha hapësirat e Kosovës dhe ndaj secilit qytetarë njësoj, në një rën anë, ndërsa në anën tjetër, duke krijuar besim në opinion me punë të pavarur, efektive dhe të paanshme. Secili gjyqtar dhe prokuror, të vetmin këshilltar duhet ta ketë ligjin dhe Kushtetutën e Kosovës, duke ndryshuar rrënjësisht mentalitetin e qasjes dhe veprimit ndaj palëve, ndaj detyrës, ndaj profesionit, e sidomos në raport me ligjin.

Mjerisht, në shoqërinë tonë ende ka qasje të atilla ku opinioni i gjerë nuk mund ta pasqyroj qartë kufirin ndarës ndërmjet ekzekutivit dhe legjislativit nga gjyqësori, ndoshta mu për shkak të ndikimeve direkte apo indirekte të faktorëve të jashtëm, në këtë segment shoqëror.

Etika, ndihmë apo pengesë për gjyqtarë dhe prokurorë, në një shoqëri pa përkujdesje të duhur ndaj drejtësisë

Është imperative që secili gjyqtar dhe prokuror të silltet dhe të veproj edhe në bazë të ligjit në fuqi, por edhe duke u bazuar në Kodin e Etikës Gjyqësore dhe Prokuroriale. Në bazë të këtij kodi, këta profesionistë, në punën e tyre, duhet të veprojnë gjithmonë duke krijuar besim tek publiku, duke pasqyruar dinjitet, integritet dhe pavarësi. Gjyqtari dhe prokurori duhet të pasqyrojnë standarde të larta të sjelljes personale e profesionale, të respektojnë dhe të zbatojnë ligjin, të shmangin çdo sjellje apo situatë, që do të sillte në pikëpyetje integritetin dhe paanshmërinë apo pavarësinë e tyre, të respektojnë në çdo moment të drejtat e njeriut, konform standardeve ndërkombëtare, për të gjitha palët në procedurë. Këto janë disa parime të përgjithshme të etikës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, që në praktikën e gjyqësisë kosovare shpeshherë mungojnë.

Pos sjelljeve të kontrolluara, në çdo vend dhe në çdo kohë, gjyqtarët dhe prokurorët kanë obligim ligjor dhe etik që gjatë procesit gjyqësor të mbrojnë të drejtat dhe liritë e të gjithë personave, sidomos të pandehurve, të cilët nuk mund të paragjykojnë fajtorë, derisa mos të vërtetohet fajësia e tij, me një vendim përfundimtar gjyqësor, pas një procesi gjyqësor legjitim. Edhe në këto raste, gjyqtarët dhe prokurorët nuk duhet të lejojnë që të ndikohen nga faktorë të jashtëm, siç janë, familja, shoqëria, zyrtarët të lartë të pushtetit, nga kërcënime, presione apo forma tjera ndikuese. Ata duhet të shmangen nga çdo konflikt i interesit, në çështjet juridike, në të cilat gjykojnë, apo duhet të gjykojnë.

Deri tashti, raporti i gjyqtarit dhe prokurorit me këta faktorë të jashtëm ndikues, ka qenë në një distancë të vogël, për të mos thënë se vija ndarëse as që ka ekzistuar. Kjo ka ndodhur për shkak të statusit të tyre, gjegjësisht kushteve të punës, por edhe mënyrës së punësimit të gjyqtarëve, por edhe mentalitetit të tyre.

Sipas etikës gjyqësore dhe prokuroriale, gjyqtari dhe prokurori, për dalim prej profesionistëve të tjerë nuk mund të merren me ndonjë veprimtari që bie ndesh, që, "janë të papajtueshme me besimin tek gjykatësit dhe prokurorët, ose me paanshmërinë apo pavarësinë e tyre, apo angazhimin e tyre për tu marrë në mënyrë të kujdesshme dhe brenda një kohe të arsyeshme me çështjet e sjella para tij". Sipas këtij përkufizimi, gjyqtarët dhe prokurorët mund të flasin në ndonjë simpozium që ka të bëjë me profesionin e tyre, të mbaj ndonjë ligjëratë lidhur me profesionin e tyre, të marrë pjesë në ndonjë veprimtari që ka të bëjë me sistemin juridik, gjegjësisht në ndonjë agjenci qeveritare që i përkushtohet përmirësimit të sistemit juridik, të merret me sport, me art dhe veprimtari tjera bamirëse, jofitimprurëse.

Gjyqtarët dhe prokurorët nuk duhet të merren me veprimtari politike dhe të mbajnë ndonjë post politik. Nuk mund të marrin pjesë në ndonjë organizatë që mbështet çfarëdo lloj diskriminimi, nuk duhet të merren me çështje financiare dhe me biznes që mund të ndikojë në paanshmërinë e tyre, gjegjësisht nuk duhet të përfshihen në marrëdhënie ekonomike me avokatët, apo persona që mund të dalin para gjykatës, në të cilën ata shërbejnë.

Gjyqtarët, prokurorët dhe familjet e tyre, janë të kufizuar në pranimin e dhuratave, privilegjeve dhe favoreve apo premtimeve për ndihmë materiale, prej ndonjë personi që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi ka interes, për çështjen që gjykohet nga gjykatësi.

Të gjitha profesionet tjera, mund të merren me punë dytësore edhe më shumë punë tjera, ndërsa gjyqtarët dhe prokurorët janë të kufizuar dhe ndalohet çdo veprimtari tjetër jashtë profesionit dhe detyrës parësore profesionale.

Për shkak të këtyre ndalesave, të shumta, kjo shoqëri duhet të mendoj që ata të jetojnë një jetë dinjitoze, të ndershme dhe pa presione të natyrës materiale-financiare. Ky shtet duhet t'u ofroj edhe siguri të mjaftueshme ndaj ndikimeve dhe kërcënimeve për jetën dhe punën e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe familjeve të tyre.

Nëse nuk arrihet një siguri optimale edhe financiare edhe etike, kodi i etikës nuk mund të shihet si ndihmesë, as si inkurajues për punën e gjyqtarëve dhe prokurorëve, përkundrazi.



Mr.sc.Shaban SHALA

CAKTIMI I VLERËS SË OBJEKTIT TË KONTESTIT

Kontesti paraqet mosmarrëveshje ndërmjet palëve kontestuese, pra paditësit dhe të paditurit lidhur më ndonjë çështje juridike-civile. Kontestet juridike-civile mund t'a kenë bazën në raportet juridike-civile të natyrës pronësore, detyrimore, trashëgimore apo familjare. Vlera e objektit të kontestit ka rëndësi se në bazë të saj përcaktohet kompetenca lëndore, e drejta e paraqitjes së revizionit dhe shuma e taksës për padi (sipas ligjit të ri), ndërsa sipas ligjit të vjetër përpos këtyre tri çështjeve varësisht nga vlera e kontestit është përcaktuar edhe përbërja e gjykatës gjatë vendosjes (gjyqtari individual apo trupi gjykues).

Siç dihet cilësinë e palëve në procedurën kontestimore e ka paditësi dhe i padituri. Paditës është personi (fizik apo juridik) i cili pretendon se i është shkelur një e drejtë subjektive të cilën ia njeh e drejta objektive, ndërsa i padituri është personi (fizik apo juridik) kundër të cilit është drejtuar kërkesa subjektive e paditësit.

Procedura kontestimore fillohet me padi të cilën e paraqet paditësi në gjykatën kompetente. Që të veprohet sipas saj ajo duhet të jetë e përpiluar në harmoni me dispozitat ligjore.¹ Prandaj shikuar nga ky

¹ Neni 253 par.1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr.03/L-006 i datës 30.06.2008 i cili është shpallur nga Presidenti i Republikës së Kosovës me Dekretin nr.DL-045-2008 të datës 29.07.2008 i cili ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit në fletoren zyrtare.

aspekt padia paraqet një akt juridik formal, pasi që me ligj përcaktohen elementet përbërëse të saj.

Në kuadër të elementeve formale që duhet t'i ketë padia hynë edhe vlera e objektit të kontestit,² të cilin element gjithashtu duhet ta përcaktoj paditësi në padinë e parashtruar në gjykatë. Është fakt i pakontestueshëm se çdo padi duhet ta ketë vlerën e kontestit, por shtrohet pyetja se: "Paditësi a është i lirë në përcaktimin e saj". Nëse lexohen dhe analizohen më kujdes dispozitat ligjore të cilat rregullojnë këtë çështje juridike rrjedh fakti se parimisht liria e paditësit është e kufizuar, kështu që gjatë caktimit të vlerës së saj ai ka kufizime ligjore çka do të thotë se paditësi mund të veprojë vetëm në kuadër të hapësirës ligjore të lejueshme. Shikuar nga ky aspekt dhe varësisht se çfarë është objekti i kontestit, liria e paditësit është tërësisht apo pjesërisht e kufizuar.

Në vazhdim do të analizojmë dispozitat ligjore që rregullojnë këtë çështje juridike-civile duke filluar me esencën e dispozitës se :

1.Vlerë të objektit të kontestit paraqet vlera e kërkesës kryesore.

Kjo dispozitë ligjore paraqet kufizimin e parë për paditësin e që konsiston në faktin se si vlerë e objektit të kontestit merret vetëm vlera e kërkesës kryesore.³ Kjo do të thotë se nëse paditësi me padi ka kërkuar që të aprovohet kërkesë padia në vlerën prej 1.000,00 € (njëmijë euro) si kërkesë kryesore dhe përpos kërkesës kryesore ka parashtruar dhe kërkesa aksesore si pagimin e kamatës në shumën prej 3% vjetore dhe të shpenzimeve procedurale në shumën prej 200 €. Kërkesa e paditësit në shumën prej 1.000,00 € do të paraqiste vlerën e objektit të kontestit pasi që paraqet kërkesë kryesore, çka do të thotë se vlerë të kontestit nuk paraqesin kërkesat aksesore pavarësisht shumave të tyre (kamata, shpenzimet procedurale, penalitetet e kontraktuara, etj).⁴

Nga ky elaborim paraprak rrjedh fakti se kur kemi të bëjmë me kërkesë në të holla shuma e kërkesës kryesore në të holla paraqet vlerën e objektit të kontestit.

2 Po aty, neni 253 par.1 pika d.

3 Po aty neni 30 par.1.

4 Po aty neni 30 par.2.

Kërkesë padia e paditësit në të holla mund të shprehet në forma të ndryshme, si kërkesa të ardhshme të cilat përsëriten edhe për këtë formë ligjdhënësi ka përcaktuar mënyrën se si do të përcaktohet vlera e objektit të kontestit, kështu që nëse kemi të bëjmë me dhënie të ardhshme që përsëriten, vlera e objektit të kontestit do të llogaritet sipas shumës totale të tyre, por jo më tepër se deri në shumën që i përgjigjet shumës totale të dhënieve për një kohë më së shumti prej 5 vitesh.⁵ Si p.sh. nëse kemi të bëjmë me kërkesën në të holla sipas rentës mujore në shumën prej 100 € vlerën e objektit të kontestit do t'a paraqet shuma e këtyre kërkesave të arritura të cilat për një vit do ishin 1200 €. Kështu që këto shuma në total mund të mbliidhen deri në maksimumin e 5 viteve.

Paditësi me padi kundër të paditurit mund të paraqes vetëm një kërkesë, apo dy ose më tepër kërkesa. Nëse kemi të bëjmë me një kërkesë situata është e qartë pasi që vlera e kërkesës kryesore paraqet vlerën e objektit të kontestit, por si do të përcaktohet vlera e objektit të kontestit kur ekzistojnë disa kërkesa kundër të paditurit. Edhe për këtë çështje ligjdhënësi ka përcaktuar qartësisht rregullën sipas se cilës, nëse këto kërkesa kundër një të padituri mbështeten në një bazë të përbashkët faktike dhe juridike atëherë vlera e përgjithshme e kontestit caktohet sipas shumës së përgjithshme të kërkesave.⁶ Si p.sh. kur cilësinë e të paditurës e ka një kompani sigurimi dhe kërkesë padia ka të bëjë me disa kërkesë padi për kompensim material dhe moral të cilat bazohen në bazë të njëjtë faktike dhe juridike (aksidenti në komunikacion) atëherë totali i kërkesave të padisë kundër të paditurit do të paraqiste vlerën e objektit të kontestit.

Në mënyrën e kundërt caktohet vlera e objektit të kontestit nëse kemi të bëjmë me baza të ndryshme faktike dhe juridike respektivisht kur cilësinë e të paditurve e kanë dy apo më tepër të paditur atëherë vlera e objektit të kontestit caktohet sipas vlerës së kërkesës veç e veç.⁷ Si p.sh. kur cilësinë e të paditurve e kanë tre persona fizik dhe kërkesa padia kundër personit A është 1000 €, kundër personit B 2000 €, ndërsa kundër personit C 3000 €, atëherë vlera e objektit të

5 Po aty neni 31.

6 Po aty neni 32 par.1.

7 Po aty neni 32 par.2.

kontestit kundër personave A,B dhe C do të caktohet veç e veç sipas shumave të kërkesave të specifikuar më parë.

Objekt kontesti në procedurë mund të jetë raporti i mëditjes, qirasë, shfrytëzimi i banesës apo lokaleve të punës edhe për këto lloje të kontesteve ligjdhënësi ka përcaktuar mënyrën se si do të caktohet vlera e objektit të kontestit. Vlera e objektit të kontestit në këto raste do të caktohet duke marrë për bazë shumën një vjeçare të mëditjes apo qirasë, përveç nëse raporti i mëditjes apo qirasë vlen për kohë më të shkurtër të kontraktuar.⁸ Si p.sh. nëse kemi një raport kontraktual të qirasë për një afat prej dy vitesh në shumat mujore prej 200 € atëherë vlerën e objektit të kontestit do t'a paraqet shuma prej 2400 € nëse padinë paditësi e parashtron padinë pas kalimit të afatit prej një viti nga data e arritjes së kërkesave të qirasë pasi që kjo shumë paraqet shumën një vjeçare të borxhit në emër të qirasë.

2. Kur kërkesëpadia e paditësit nuk shprehet direkt në të holla

Kërkesëpadia e paditësit gjithmonë nuk shprehet në të holla këtë fakt e vërteton praktika gjyqësore, por mundet paditësi lidhur me kërkesë padinë e parashtruar në Gjykatë të thekson se në vend të përmbushjes së saj jo në të holla pranon t'i paguhet shuma e caktuar në të holla. Në këtë rast vlerë të objektit të kontestit do të paraqes shuma e caktuar e të hollave që do t'i paguhet paditësit,⁹ kjo do të dukej praktikisht kështu p.sh. nëse paditësi ka kërkuar nga i padituri që t'ia dorëzoj makinën e tij të tipit Golf 2 me tabela të regjistrimit 211- KS- 211, si send të caktuar individualisht, por pranon që në vend të tij t'i paguhet shuma në të holla prej 2.000,00 € atëherë kjo shumë paraqet vlerën e objektit të kontestit.

3. Kur kërkesëpadia e paditësit nuk ka të bëjë me të holla apo jo në të holla, por me kërkesa të natyrave tjera

Nuk përjashtohet mundësia që paditësi të kërkoj nga Gjykata mbrojtje juridike lidhur më dhënien e sigurisë për ndonjë kërkesë apo për

⁸ Po aty neni 33 par.1.

⁹ Po aty neni 35 par.1.

vendosjen e së drejtës së pengut, në këto raste vlera e objektit të kontestit do të caktohet sipas shumës së kërkesës që duhet siguruar.¹⁰

4. Kur kërkesëpadia e paditësit as direkt as indirekt nuk shprehet në vlerën në të holla

Ekzistojnë lloje të kontesteve ku kërkesëpadia e paditësit nuk shprehet në të holla, atëherë shtrohet pyetja se si përcaktohet vlera e objektit të kontestit. Edhe këto lloje të kontestit duhet t'a kenë një vlerë të caktuar të cilën duhet gjithashtu t'a caktoj paditësi.¹¹ Por a ka liri absolute paditësi me rastin e caktimit të vlerës së kontestit në këto lloje të kontestit. Nëse lexohet dhe analizohet me kujdes dispozita ligjore që rregullon këtë çështje liria e paditësit është e kufizuar dhe kjo do të duhej të varet kryesisht nga Gjykata dhe pala e paditur të cilët duhet dhe mund të kenë një rol aktiv. Kështu që në qoftë se paditësi nuk ka theksuar fare vlerën e objektit të kontestit në padi apo këtë vlerë e ka paraqitur tepër të lartë apo shumë të ulët atëherë gjykata sipas detyrës zyrtare apo prapësimit të palës së paditur më se voni në seancën përgatitore apo nëse kjo nuk është mbajtur atëherë në seancën për shqyrtimin kryesor, por gjithsesi para fillimit të shqyrtimit kryesor shpejt dhe në mënyrë të përshtatshme do t'a caktoj përkatësisht do t'a verifikoj saktësinë e vlerës së caktuar në padi nga paditësi.¹² Kjo do të thotë se në caktimin e vlerës së objektit të kontestit në këtë mënyrë, pra kur paditësi nuk përcakton fare vlerën e kontestit, e përcakton shumë lartë apo shumë ulët gjykata duhet të kujdeset dhe të veproj sipas detyrës zyrtare në të kundërtën do të bënte shkelje të dispozitave të procedurës. Si do të zhvillohej ky proces në aspektin procedural, në rastin e parë kur nuk kemi vlerë të kontestit të paraqitur nga paditësi gjykata do të kërkoj nga paditësi që të përcaktoj atë, nëse paditësi paraqet atë realisht gjykata do të vazhdoj procedurën sipas radhës ligjore, mirëpo nëse paditësi e paraqet atë tepër të lartë apo tepër të ulët gjithashtu gjykata sipas detyrës zyrtare duhet të veproj duke kërkuar nga paditësi që atë t'a rris apo t'a ul, nëse paditësi nuk vepron në këtë drejtim gjykata do të merr aktvendim me të cilin cakton vlerën e objektit të kontestit kundër të cilit nuk lejohet ankesa. Lidhur më këto çështje i padituri

11 Po aty neni 35 par.2.

12 Po aty neni 36

gjithashtu mund të paraqes prapësim. Mirëpo veprimet e gjykatës të cilat do të duhej t'i ndërmerre sipas detyrës zyrtare apo sipas prapësimit të palës së paditur janë të limituara në kohë, kështu që ato mund të ndërmerren më së voni deri në seancën përgatitore, e nëse kjo nuk është mbajtur deri në seancën për shqyrtim kryesor por gjithsesi para fillimit të shqyrtimit. Në këto raste dhe nën këto rrethana nëse gjykata nuk vepron sipas detyrës zyrtare apo sipas prapësimit të paraqitur me kohë nga pala e paditur bënë shkelje të dispozitave të procedurës. Nëse prapësimin pala e paditur e paraqet pas kalimit të afateve kohore theksuar paraprakisht gjykata nuk është e detyruar të veproj dhe për pasojë nuk mund të ekziston një shkelje e tillë sa i përket vlerës së objektit të kontestit.

Në kontekst të kësaj analize ligjore do të ishte shumë e dobishme dhe e arsyeshme që të verifikoheshin faktet se gjykatat në Kosovë a i zbatojnë këto dispozita ligjore të cilat i referohen caktimit të vlerës së objektit të kontestit. Apriori nuk mund të shprehemi, por jemi shumë skeptik në zbatimit të tyre. Sido që të jetë për të arritur deri tek një konkluzion i saktë sa i përket kësaj çështje do të ishte mirë të bëhet një hulumtim praktik i cili shpresojmë se në ndërkohë do të ndërmerret.



Mr.sc.Shaban SHALA

LIGJI I RI PËR PROCEDURËN ADMINISTRATIVE, RAPORTI ME LIGJIN E MË PARSHËM DHE SFIDAT E ZBATIMIT TË TIJ

Ligji për Procedurën Administrative 02/L-28, është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më datën 22.07.2005 dhe është shpallur me rregullore të UNMIK-ut nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm¹ (në vazhdim: PSSP). Duke patur për bazë dispozitën kalimtare të këtij ligji konkretisht nenin 143 sipas së cilës ky ligj hynë në fuqi 6 muaj pas datës së shpalljes nga PSSP rezulton fakti se ky ligj nga data 06.11.2006 është në fuqi. Mirëpo shtrohet çështja se para hyrjes në fuqi të këtij ligji Kosova a ka patur ligj me të cilin ka rregulluar procedurën administrative. Duke patur për bazë faktin se Kosova ka qenë njësi konstituive e ish Federatës Jugosllave dhe se çështjet procedurale kanë qenë të rregulluara në mënyrë unike për gjithë territorin e federatës pasi që federata ka patur kompetencë ekskluzive për çështje të tilla, atëherë nga ky elaborim rrjedh konstatimi se para hyrjes në fuqi të këtij ligji në Kosovë dhe gjatë periudhës autonome ka qenë në fuqi Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative.²

Më qëllim të krahasimit të ligjit të ri të procedurës administrative me ligjin e aplikueshëm shkurtimisht do të paraqesim përmbajtjen e tyre

1 Rregullorja e UNMIK-ut nr.2006/33 e datës 05.05.2006.

2 Rregullorja e UNMIK-ut nr.1999/24 për Ligjin e Aplikueshëm në Kosovë.

duke vendosur theksin në çështjet të cilat nuk janë rregulluar fare apo janë rregulluar ndryshe.

Fillimisht duhet theksuar se të dy ligjet përmbajnë parime, mirëpo numri i parimeve në ligjin e ri është shumë më i vogël në raport me ligjin e aplikueshëm, përkundër faktit se në ligjin e ri ekzistojnë disa parime të cilat janë tërësisht të reja si p.sh. parimi i balancimit të interesave publike me private, parimi i proporcionalitetit etj.

Ligji i ri në raport me ligjin e aplikueshëm nuk përmban fare dispozita sa i përket palëve dhe përfaqësimit të tyre, por vetëm i referohet faktit se lidhur me përfaqësimin vlejnë rregullat e së drejtës civile.

Duhet theksuar gjithashtu se të dy ligjet rregullojnë çështjen e përdorimit të mjeteve të rregullta juridike, gjersa ligji i ri parasheh përdorimin e kërkesës për rishqyrtim dhe ankimit si mjete të rregullta juridike, ligji i aplikueshëm ka përcaktuar qartësisht dhe saktësisht vetëm ankesën si mjet të rregullt juridik.

Ligji i ri në raport me ligjin e aplikueshëm nuk përmban fare dispozita lidhur me shpenzimet e procedurës dhe përdorimin e mjeteve të jashtëzakonshme juridike të cilat ligji i aplikueshëm jo vetëm që i ka lejuar, por dhe i ka numëruar në mënyrë taksative.

Po ashtu sa i përket ekzekutimit të vendimeve ka dallim, kështu që gjersa ligji i ri i referohet ekzekutimit vetëm si çështje, ligji i aplikueshëm ka rregulluar me detalisht procedurën dhe format e ekzekutimit.

Kur të shikohet si tërësi ligji i ri për procedurën administrative përmban gjithsej 143 nene çka do të thotë se në raport me ligjin e aplikueshëm është më i vogël pasi që përmban gjithsej 301 nene. Numri i dispozitave ligjore në një ligj nuk paraqet garancion se një ligj është përmbajtjesor dhe kualitativ, por megjithatë në ndonjë rast siç është ky jep sinjale se mund të jetë i mangët kur të bëhet krahasimi në numra si dhe duke patur për bazë se kemi të bëjmë me çështje sistimore siç është rregullimin unik i zbatimit të procedurës administrative.

Në vazhdim do t'i elaborojmë shkurtimisht çështjet të cilat i kemi paraqitur si të ndryshme dhe të cilat meritojnë sqarim.

Sa i përket parimeve të cilat paraqesin bazë për rregullimin e aktivitetit të palëve dhe organit që zhvillon procedurën administrative ekziston një ndryshim i theksuar sa i përket numrit të tyre dhe risive. Do të theksonim si përparësi e ligjit të ri faktin e ekzistimit të parimeve të reja siç janë: parimi i balancimit të interesave publike dhe private me të cilin le të kuptohet se personat publik dhe privat janë të barabartë para organit të administratës publike, parimi i proporcionalitetit sipas të cilit gjatë zhvillimit të procedurës organi i administratës publike duhet të përdor mjetet të cilat janë në proporcion me realizimin e qëllimit. Ndërsa si mangësi e këtij ligji do të theksonim mungesën e disa parimeve mjaft të rëndësishme siç janë : parimi i dëgjimit të palëve, parimi i çmuarjes së lirë të provave, etj.

Sa i përket palëve dhe përfaqësimit të tyre ligji i ri përmban një dispozitë të vetme se: *"Aftësia për të filluar një procedim administrativ ose për të marrë pjesë në të, si dhe rregullat që bëjnë të mundur përfaqësimin përcaktohen në përputhje me dispozitat e së drejtës civile mbi aftësinë juridike të personave fizik dhe juridik"*.³ Konsiderojmë se kjo situatë paraqet një mangësi qoftë nga shkaku sipërfaqësor i rregullimit të kësaj çështje, por dhe për shkak të faktit se çështjet juridike-administrative dallojnë ndjeshëm nga çështjet juridike-civile prandaj shikuar nga ky aspekt dallon dhe pozicioni i palëve dhe pjesëmarrësve tjerë në procedurë. Në këtë drejtim duhet theksuar se ligji i aplikueshëm gjerësisht dhe në detale i ka rregulluar autorizimet dhe përgjegjësitë e palëve dhe organit i cili zhvillon procedurën i cili fakt konsiderojmë se paraqet një përparësi të këtij ligji.

Institutin e ankesës edhe pse e parashohin të dy këto dy ligje e rregullojnë në mënyra të ndryshme, kështu që gjersa ligji i ri njih institutin e ankimit administrativ në kuadër të cilit hynë kërkesa për rishqyrtim dhe ankesa, ligji i aplikueshëm taksativisht ka përcaktuar ankesën si mjetin e vetëm të rregullt juridik kundër të cilit vendos organi i shkallës së dytë. Kjo mënyrë e rregullimit sipas ligjit të ri mund të jetë përparësi pasi që çështjet e vendosura shumë shpejt

3 Neni 35 par.2 i Ligjit për Procedurën Administrative nr.02/L-28.

mund të rishikohen nga organi i cili ka vendosur, por njëkohësisht mund të jetë dhe mangësi pasi që vendos organi i cili ka vendosur lidhur me çështjen (kur është në pyetje kërkesa për rishqyrtim) i cili do të mund të manifestohej ndoshta me një qëndrim të ngurtë të organeve të administratës. Se si do të rrjedh situata mbetet të shihet dhe këtë fakt do ta dëshmoj praktika juridike.

Të mangët ligjin e ri e bën fakti se jo vetëm që nuk përmban një kaptinë të veçantë lidhur me shpenzimet procedurale sikurse që ndodh me çdo ligj procedural sistemor, por nuk përmban asnjë dispozitë të vetme e cila rregullon këtë çështje. Siç dihet gjatë zhvillimit të çdo procedurë ligjore në përgjithësi, në këtë drejtim procedura administrative nuk bënë përjashtim se organi i cili zhvillon procedurën dhe palët ndërmarrin veprime të caktuara më qëllim të zgjidhjes së çështjes në mënyrë meritore, kështu që krijohen shpenzime procedurale për të cilat vendoset në parim kur të vendoset lidhur me çështjen administrative në mënyrë meritore dhe me të cilat obligohet pala e cila në disfavor të saj është vendosur çështja ose e cila me fajin e saj i ka shkaktuar ato. Në një mënyrë apo tjetër pjesë përbërëse të çdo procedure administrative janë dhe shpenzimet procedurale, prandaj mos rregullimi i tyre me dispozita ligjore e bën këtë ligj me të meta serioze respektivisht jo funksional. Në anën tjetër ligji i aplikueshëm ka një kaptinë të veçantë ku në detale ka rregulluar këtë çështje procedurale. Po ashtu sa i përket atakimit të vendimit i cili në procedurën administrative ka marrë formën e prerë ligji i ri nuk njeh fare institutin e përdorimit të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, ndërsa ligji i aplikueshëm jo vetëm që ka njohur këtë institut, por dhe ka përcaktuar në mënyrë taksative numrin dhe llojin e tyre si dhe ka përcaktuar kushtet dhe rrethanat nën të cilat mund të parashtrohen.

Edhe sa i përket ekzekutimit të vendimit i cili ka marrë formën e prerë në procedurën administrative ekziston një dallim i theksuar, kështu që gjersa ligji i ri për procedurën administrative në mënyrë sipërfaqësore rregullon çështjen e ekzekutimit të vendimeve pa dhënë përgjigje në mënyrat e ekzekutimit të cilat mund të jenë administrative dhe jo administrative (në të holla), këtë çështje në mënyrë detale e ka rregulluar ligji i aplikueshëm sipas të cilit çështjet administrative të cilat kanë karakter administrativ i ekzekuton organi i cili ka vendo-

sur në shkallë të parë, ndërsa çështjet administrative të cilat kanë të bëjnë me detyrime në të holla i ekzekuton Gjykata kompetente.

Në çështjet të cilat paraqitem më lartë në mënyrë parimore kemi prezantuar çështjet të cilat konsiderojmë se janë të rëndësishme dhe paraqesin sfida serioze për zbatimin e tij. Me qëllim që të jemi më bindes dhe argumentues do të paraqesim rastin e dy shteteve : të Republikës së Kroacisë dhe të Bosnjës e Hercegovinës se si këto shtete kanë vepruar gjatë periudhës së tranzicionit lidhur me Ligjin e Procedurës së Përgjithshme Administrative të ish Federatës Jugosllave. Siç dihet këto dy shtete kanë qenë dy nga gjashtë njësitë konstituive të ish Federatës Jugosllave. Në territorin ish këtyre njërive federale tash shteteve të pavarura janë zbatuar ligjet sistimore unike procedurale (federaliste), kështu që në këtë drejtim është aplikuar dhe ish Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Ndërsa pas procesit të pavarësimit dhe konsolidimit të shteteve të pavarura këto dy shtete pothuaj komplet kanë marrë tekstin integral të ish ligjit të përbashkët në të cilin janë bërë disa pastrime sa i përket elementeve të vetëqeverisjes dhe federaliste. Pas këtyre intervenimeve në formë të pastrimit i kanë miratuar si ligje të veçanta të cilat sot janë në fuqi.⁴Kjo nuk duhet shikuar apo kuptuar si nostalgji për të kaluarën apo të lidhet me diçka tjetër irracionale, por eventualisht të merret si një zgjidhje e mirë juridike dhe pragmatike. Jo vetëm për shkak se ish Jugosllavia ka qenë shtet i përbashkët dhe në procesin e ligjbërjes kanë marrë pjesë të gjitha njësitë duke përfshirë në këtë rast dhe Kosovën çka do të thotë se në aspektin politik ekziston një fare legjitimiteti nëse mund të shprehemi kështu, por thjeshtë për arsye të pastërta juridike dhe praktike. Çka e bënë një zgjidhje të tillë të qëlluar dhe cilat ndoshta kanë qenë motivet që i kanë shtyrë këto dy shtete të përvetësojnë një ish ligj të përbashkët, me siguri se këtu vend për motive politike nuk ka pasur kur të kihet parasysh fakti se çfarë krahure kanë përjetuar këto shtete me këtë ish katurë të përbashkët, por thellësisht besojmë se kanë qenë në pyetje arsyet e pastërta juridike dhe praktike. Ndoshta dhe Republika e Kosovës është dashur të ndjek një rrugë të tillë duke u nisur nga shkaqet e pastërta juridike dhe praktike e të cilat në vazhdim disa nga to do t'i numërojmë:

4 Shih : Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative të Republikës së Kroacisë dhe të Bosnie dhe Hercegovinës.

- Faktin se kemi të bëjmë me një ligj sistemor përmbajtjesor dhe kualitativ;
- Zbatimi i tij për një kohë të caktuar në territorin e Republikës së Kosovës ka rezultuar me një praktikë të pasur;
- Zbatimi i caktuar i këtij ligji nga organet e administratës shtetërore ka ndikuar që në një anë të krijohet një standardardizim së paku minimal në zbatimin e tij dhe njohjen nga qytetarët ;

Duke i pasur për bazë të gjitha që i theksuam paraprakisht zbatimi i këtij ligji do të paraqesë sfidë serioze për organet e administratës shtetërore në Kosovë në një anë dhe për realizimin e të drejtave të qytetarëve në anën tjetër pasi që kontakti i parë i qytetarit me shtetin vjen në shprehje pikërisht me organet e administratës shtetërore. Këtë sfidë e bën dhe më sfiduese kur të merret parasysh fakti se në këtë ligj ekziston një terminologji juridike e cila në një masë të caktuar është në kundërshtim me terminologjinë procesualiste standarde e cila përdoret në Kosovë.

Sido që të jetë mbetet të shihet se si do të reflektohet ky ligj në praktikë, por sigurisht se do shkaktojnë kokëçarje (dilema) për zbatuesit e tij dhe ndoshta do të prodhoj pasoja për qytetarët.



Valon TOTAJ

KONTRATA (PARA) MARTECORE

Në radhë të parë, objekti i së drejtës martesore (si nëndegë e së drejtës familjare) përbëhet nga marrëdhëniet e natyrës personale. Këto janë marrëdhënie të cilat janë të rregulluara me norma ligjore imperative, si p.sh. kushtet për lidhjen e martesës, shkaqet e pavlefshmërisë së martesës, të drejtat dhe detyrat e çiftit bashkëshortor, shkaqet e pushimit ose të zgjidhjes së martesës, etj. Pa dyshim se marrëdhëniet personale martesore janë parësore. Por objekt i të drejtës martesore janë edhe marrëdhëniet e pasurore të cilat rrjedhin nga martesa. Marrëdhëniet pasurore janë të prejardhura nga marrëdhëniet personale prandaj edhe konsiderohen si dytësore. Edhe këto marrëdhënie janë të rregulluara me ligj dhe janë në funksion të realizimit më të mirë të marrëdhënieve personale.

Në lidhje me natyrën juridike të martesës, ekzistojnë dy teori: e para, se martesa është kontratë civile dhe e dyta, se martesa është një institucion juridik. Sipas teorisë së parë, martesa është një kontratë civile e karakterit specifik. Ky koncept i ka rrënjët e veta në të drejtën romake, ndërsa ka qenë i sanksionuar edhe në legjislacionin kishtar (Codex iuris kanonici) dhe është i sanksionuar edhe sot e kësaj dite në të drejtën e sheriatit. Teoria e dytë, martesën e cilëson si institucion juridik. Sipas kësaj, martesa krijon statusin juridik bashkëshortor për burrin dhe gruan duke krijuar kështu familjen.

Tërësia e normave juridike me të cilat rregullohen marrëdhëniet pasurore të çiftit bashkëshortor quhet regjim pasuror martesor. Rezultatet e hulumtimeve të ndryshme historiko-juridike dhe atyre juridiko-krahasuese, tregojnë se në periudha të ndryshme të zhvillimit shoqëror kanë ekzistuar regjime të ndryshme pasuroro-martesore. Ky regjim në masë të madhe ka qenë i kushtëzuar nga pozita të cilën e ka pasur gruaja në shoqëri. Sidoqoftë, shikuar në përgjithësi, ekzistojnë tri lloje të regjimit pasuror martesor: regjimi i pasurisë së përbashkët, ai i pasurisë së veçantë dhe regjimi i pasurisë së përzier. Në bazë të zgjidhjeve ligjore të cilat janë paraparë në disa shtete të regjionit (Shqipëri, Maqedoni, Kroaci, Serbi, Mal i Zi, Vojvodinë, etj.) e të cilat zgjidhje me disa specifika i ka paraparë edhe Ligji mbi Familjen i Kosovës (2004), regjimi i pasurisë së përbashkët martesore nuk është më regjim i detyrueshëm ligjor, ngase tani, çiftit bashkëshortor i është mundësuar që në bazë të dëshirës dhe nevojave të tyre ti rregullojnë edhe marrëdhëniet e tyre pasurore, thjeshtë duke lidhur kontratë. Historikisht, mënyra e rregullimit të marrëdhënieve pasurore të çiftit bashkëshortor ka evoluuar nga kalimi i pasurisë së gruas në pasurinë e burrit, pastaj në ndarjen e pasurisë së gruas me të cilën ka qeverisur burri, e deri te pasuria e përbashkët e bashkëshortëve.

Me hyrjen në fuqi të ligjit për Familjen i Kosovës (nr.2004/32), është krijuar mundësia që çifti bashkëshortor, me ndërmarrjen e punëve juridike (lidhjen e marrëveshjes - kontratës) të rregullojnë marrëdhëniet pasurore martesore në përputhje me mënyrën e cila ju konvenon nevojave dhe interesave të tyre. Kjo nënkupton si pasurinë aktuale ashtu edhe pasurinë e ardhshme të cilën ata mund ta fitojnë apo pritët ta fitojnë. Midis shumë marrëveshjeve, të cilat mund ti bëjë çifti martesor siç janë: kontrata mbi dhurimin, kontrata mbi shitblerjen, etj., padyshim se kontrata (para)martesore me të cilën palët i rregullojnë marrëdhëniet pasurore martesore, paraqet një rëndësi nga kontrata më të rëndësishme. Baza e përgjithshme juridike për lidhjen e kësaj kontrate buron nga neni 276 i Ligjit për Familjen i Kosovës (LFK), sipas të cilit "anëtarët e bashkësisë familjare me kontratë mund t'i rregullojnë marrëdhëniet reciproke martesore". Në bazë të këtij ligji, bashkëshortët përkatësisht çifti i ardhshëm bashkëshortor, mund t'i rregullojnë marrëdhëniet pasurore martesore me mar-

rëveshje - kontratë, me anë të së cilës ata e "formojnë" një regjim pasuror në bazë të vullnetit të tyre. Me lidhjen e kontratës para(martesore) ata (bashkëshortët) mund ta anashkalojnë në tërësi regjimin pasuror të pronësisë së përbashkët, mund ta zgjerojnë atë në tërë pasurinë e tyre aktuale apo edhe në atë të ardhshme, etj. Megjithatë, me kontratë (para)martesore bashkëshortët nuk mund t'i rregullojnë veprimet (efektet) personale pasurore të martesës, nëpërmjet të të cilave mbrohet interesi i palës bashkëshortore e cila është ekonomikisht më e dobët se sa pala tjetër (p.sh. heqja dorë nga e drejta e mbajtjes nuk do të prodhonte kurrfarë efekti juridik).

Kontrata para(martesore) është e plotfuqishme nëse është lidhur me vullnet të lirë dhe nga personat me aftësi të plotë veprimi. Kjo kontratë është e formës solemne, duhet të lidhet me shkrim dhe duhet të vërtetohet nga ana e gjyqtarit, i cili është i obliguar që para vërtetimit, të njëjtën t'ua lexoj bashkëshortëve, duke ua tërheq vërejtjen se me nënshkrimin e kësaj kontrate përjashtohet regjimi i pasurisë së përbashkët martesore. Në këtë mënyrë sigurohet që çifti bashkëshortor të njoftohet me përmbajtjen, kuptimin efektet dhe pasojat e nënshkrimit të kësaj kontrate. Në sistemet juridike tek të cilat ekziston institucioni i noterit publik, kontrata vërtetohet para noterit. Kontrata (para)martesore konsiderohet e lidhur edhe para lidhjes së martesës, mirëpo ajo nuk fillon të prodhojë efekte juridike para se të lidhet martesa. Kontrata (para)martesore e cila ka për objekt të saj edhe paluajtshmëri regjistrohët edhe në librat publik (regjistrat) mbi të drejtat e paluajtshme.

Kontestet e natyrës pasurore ndërmjet (ish)bashkëshortëve për ndarjen e pasurisë së përbashkët janë konteste të ndërlikuara dhe mjaft të ndjeshme. Andaj, me lidhjen e kësaj kontrate thjeshtohët bukur shumë puna e gjykatës por edhe e palëve të mundshme gjyqësore, ngase ajo që duhet të vërtetohët në procedurë gjyqësore, tanimë veç është e rregulluar me kontratë. Në këto raste në mënyrë të plotë zbatohen dispozitat e kontratës mbi mënyrën e ndarjes së pasurisë së përbashkët. Kështu pra, në mënyrë më të mirë dhe më të plotë janë rregulluar marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve, ndërsa mbrojtja juridike e bashkëshortëve në procedurë gjyqësore është bërë më e shpejtë dhe më efikase. Me një fjalë, atë (pasuri) që bashkëshortët e

kanë poseduar para martesës, atë të cilën e kanë fituar në mënyrë të pavarur gjatë martesës, ose që iu është dhuruar apo të cilën e kanë trashëguar, nuk kanë nevojë ta ndajnë nëpërmjet procedurës gjyqësore, ngase të tëra këto rregullohen me kontratë.

Kontrata (para)martesore është institucion fakultativ dhe në rast se bashkëshortët, përkatësisht çifti i ardhshëm bashkëshortor nuk e "konstituojnë" këtë institucion (përmes lidhjes së kësaj kontrate), në raportet e tyre pasurore vlen regjimi ligjor i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve.

Aspekti praktik i kontratës (para)martesore

Bashkëshortët (e ardhshëm) të cilët vendosin që të lidhin kontratë martesore duhet të kenë parasysh rrethanat vijuese:

- kontrata martesore mund të lidhet para dhe gjatë martesës;
- me këtë kontratë rregullohet pasuria aktuale e bashkëshortëve apo pasuria të cilën ata mund ta fitojnë në të ardhmen;
- kontrata martesore duhet ta ketë formën e shkruar;
- kontrata martesore duhet t'i përmbajë palët kontraktuese me të gjitha shënimet për identifikimin e tyre (emrat, adresat etj);
- në mënyrë që të prodhojë efekte juridike, kjo kontratë duhet të vërtetohet nga ana e gjykatës kompetente (komunale);
- procedura për vërtetimin e kësaj kontrate fillohet në atë mënyrë që pranë zyrës për pranimin e shkresave të gjykatës kompetente dorëzohet propozimi për vërtetimin e përmbajtjes së kontratës martesore, të cilës i bashkëngjitet edhe kopja e tekstit të kontratës;
- referenti në zyrën e pranimit e pranon propozimin, e pro - tokollon atë në protokollin përkatës, pas së cilës kjo lëndë e merr numrin e veçantë;
- me ftesë të gjykatës, palët bashkëshortore duhet të paraqiten para gjyqit, me ç'rast gjyqtari përkatës, pasi që bënë identifikimin e palëve, në prezencë të një dëshmitari bënë leximin e kontratës, duke i njoftuar palët (kontraktuese) bashkëshortore se me nënshkrimin e kësaj kontrate përjashtohet regjimi i pasurisë së përbashkët bashkëshortore;

- gjatë kësaj procedure gjyqtari kujdeset për faktin se a është nënshkruar kontrata me vullnetin e lirë të bashkëshortëve;
- për të gjitha veprimet e ndërmarra procedurale nga ana e gjyqtarit hartohet procesverbali të cilit i bashkëngjitet një kopje e kontratës, ndërsa në origjinalin e kontratës shënohet edhe numri i protokollit, me çka procedura e vërtetimit të kësaj kontrate para gjykatës përfundon;
- kontrata martesore e cila për objekt të vetin ka edhe pronë të paluajtshme, regjistrohet në librat (regjistrat) mbi të drejtat në paluajtshmëri.

Në vend të përfundimit

Kontrata (para)martesore është kontratë me të cilën bashkëshortët, gjegjësisht bashkëshortët e ardhshëm, në mënyrë të pavarur përcaktojnë regjimin pasuror martesor. Me lidhjen e kësaj kontrate bashkëshortët në mënyrë të pavarur dhe me marrëveshje i rregullojnë marrëdhëniet e tyre pasurore martesore. Lidhja e kësaj kontrate, në asnjë mënyrë nuk shpreh (nuk do të duhej) mosbesimin e bashkëshortëve ndaj njëri tjetrit porse nëpërmjet saj tentohet të eliminohen kontestet rreth asaj se "çka e kujt është".

Shtrohet pyetja se kjo kontratë a i parandalon shkurorëzimet dhe a ka ndikuar paraqitja e saj në zvogëlimin e numrit të shkurorëzimeve?

Lidhja e kësaj kontrate nuk e parandalon shkurorëzimin e as që do të ndikoj në zvogëlimin e numrit të shkurorëzimeve. Sipas avokates Milena Milanoviç "martesa, si një nga institucionet më të rëndësishme të shoqërisë, është duke u shkatërruar gjithnjë e më shumë. Nuk e dimë se çka do ta shpëtonte atë e as që do ta dimë këtë edhe për një kohë të gjatë. Është fakt i pakontestueshëm se lëvizja feministe ka ndikuar pozitivisht në realizimin e të drejtave të grave, por ndoshta dhe vetëm ndoshta, kjo lëvizje ka ndikuar edhe në rritjen e numrit të shkurorëzimeve, ngase tani gruaja është bërë më e vetëdijshme, ekonomikisht më e pavarur dhe më pak e gatshme për kompromise..." përfundon kjo avokate e njohur e cila tërë karrierën e vet është marrë me probleme martesore.

Si për ironi, duhet thënë se kontrata (para)martesore, në një farë mënyre e lehtëson shkurorëzimin. Megjithatë, në kontestet e kësaj natyre, nuk do të duhej të mohohej paraqitja e një faktori i cili do ta lehtësonte dhe përshpejtonte procesin gjyqësor të shkurorëzimit.

**Valon TOTAJ & Arsim HAMZAJ**

SHKURORËZIMET NË KOSOVË

Pas luftës së vitit 1999, Kosova është përballur me probleme të natyrave të ndryshme. Këtë periudhë e karakterizojnë ndryshime të mëdha psikologjike dhe socio - ekonomike, të cilat ishin dhe mbetën sfida e rëndë për qytetarin e Republikës së Kosovës. Pasuan probleme dhe çrregullime të natyrave të ndryshme sociale, ku në mesin e tyre janë edhe marrëdhëniet e çrregulluara familjare, që në disa raste pasojnë edhe me prishjen e martesës, gjegjësisht shkurorëzimin.

Në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr.1999/24, të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, në lëmin e marrëdhënieve familjare, deri më 16 shkurt 2006 ka qenë në fuqi Ligji për Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare i Kosovës (LMMFK) i vitit 1984. Pas kësaj date ka hyrë në fuqi ligji i ri - Ligji për Familjen i Kosovës. Ky konsiderohet edhe si ligj themelor (burim themelor). Ekzistojnë edhe disa ligje që konsiderohen si burime plotësuese të së drejtës familjare, të cilat përveç tjerash rregullojnë edhe disa marrëdhënie familjare siç janë: Ligji për Librat Amzë (Nr.2004/46, i vitit 2004), Ligji për Trashëgiminë i Kosovës (2004), Ligji për Procedurën Kontestimore (2008), Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (2004), Ligji për Procedurën Administrative (2006), Ligji për Procedurën Përmbartimore (2008), Rregullorja për mbrojtjen kundër dhunës në familje (2003/12), etj. Si burime të së drejtës familjare janë edhe aktet e

ndryshme ndërkombëtare si: Karta e Kombeve të Bashkuara (1945), Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (1948), Pakti Ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore të Njeriut (1966), Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Suprimimin e Diskriminimit ndaj Grave (1967), Konventa për eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Grave (1979), Konventa për Dhënien e pëlqimit për martesë, moshën minimale për lidhjen e martesës dhe regjistrimin e martesave (1962), Konventa për Shtetësinë e Gruas së Martuar (1957), Konventa për Mbrojtjen e Amësisë (1952), Konventa për të drejtat e fëmijëve (1989), etj.

Ligji për Familjen i Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më 16.2.2006, rregullon martesën dhe marrëdhëniet familjare dhe paraqet një akt ligjor me të cilin pothuajse në mënyrë të plotë është kodifikuar e drejta Familjare. Ligji në fjalë është i ndarë në 8 (tetë) pjesë dhe përmban në vete gjithsej 355 nene.

Liria për të lidhur martesë zakonisht shoqërohet edhe me lirinë e zgjidhjes së saj. Në bazë të ligjeve në fuqi, në Republikën e Kosovës, për zgjidhjen e martesës, kompetente janë Gjykatat e Qarkut. Momentalisht, në Kosovë funksionojnë 5 (pesë) gjykata të qarkut: e Prishtinës, e Prizrenit, e Pejës, e Mitrovicës dhe e Gjilanit.

Martesa shuhet (përfundon) me : vdekjen e njërit bashkëshort, shpalljen e njërit bashkëshort për të zhdukur, me shkurorëzim dhe me anulim. Jo të gjitha sistemet juridike shtetërore e lejojnë shkurorëzimin (si zgjidhje të martesës së vlefshme). Kështu dallojmë: sisteme juridike të cilat e ndalojnë shkurorëzimin, sisteme juridike të cilat e lejojnë shkurorëzimin, sisteme juridike të cilat shkurorëzimin e konsiderojnë si sanksion, sisteme juridike të cilat shkurorëzimi konsiderohet si mjet shërimi dhe sisteme juridike të kombinuara.

Me shkurorëzim nënkuptojmë zgjidhjen e martesës së vlefshme, me aktgjykim të gjykatës kompetente, në procedurë ligjore dhe për shkaqe të parapara me ligj. Normalisht se martesa e pavlefshme nuk zgjidhet por ajo anulohet. Shkaqet e shkurorëzimit janë rrethana për shkak të së cilave mund të kërkohet zgjidhja e martesës, e të cilat lindin pas lidhjes së martesës. Shkaqet mund të jenë të përgjithshme

dhe të veçanta, shkaqe absolute dhe relative, shkaqet për të cilat e drejta e padisë fitohet pas kalimit të afatit dhe ato për të cilat kjo e drejtë nuk është e lidhur me afat, shkaqet e fshehta dhe jo të fshehta, si dhe shkaqet për zgjidhjen e martesës për të cilat e drejta e parashtrimit të padisë humbet pas kalimit të afatit dhe shkaqet për të cilat e drejta e parashtrimit të padisë nuk humbet pas kalimit të afatit.

- *Shkaqet e përgjithshme* të shkurorëzimit, janë rrethana të formuluar në mënyrë të përgjithshme, në kuadër të të cilave mund të jenë të përfshira të gjitha apo një pjesë e madhe e shkaqeve të veçanta (mospajtimi i karaktereve, mosmarrëveshjet e përhershme etj). *Shkaqet e posaçme* të shkurorëzimit duhet të jenë të përcaktuara në mënyrë precize dhe taksative (shkelja e besnikërisë bashkëshortore, keqtrajtimi serioz, lënia qëllimkeqe dhe e paarsyeshme, etj).
- *Shkaqet absolute* të shkurorëzimit, janë ato shkaqe të cilat në vete ngërthejnë fakte, rrethana apo situata të tjera të para-para me ligj, prezenca e të cilave ka për pasojë nxjerrjen e aktgjyqimit për shkurorëzimin e martesës (shkelja e besnikërisë, vepra penale ndaj bashkëshortit etj). Shkaqet relative të shkurorëzimit, ekzistojnë vetëm atëherë kur tërësia e fakteve, rrethanave apo situatave të tjera, mund të ndikojnë në krijimin e marrëdhënieve të atilla ndërmjet palëve bashkëshortore, të cilat marrëdhënie kanë për pasojë prishjen e bashkësisë martesore, me çka edhe do të humbte qëllimi kryesor i martesës (mospërshtatja e karaktereve, qasja e ndryshme etj).
- *Shkaqet për të cilat e drejta e padisë fitohet pas kalimit të afatit*, janë ato shkaqe për shkak të së cilave padia (apo propozimi) nuk mund të parashtrohet para se të kalojë afati i caktuar. Kështu padia për shkurorëzim nuk mund të parashtrohet nga asnjëri bashkëshort gjatë shtatzënisë së gruas dhe deri sa fëmija i tyre të mbush moshën njëvjeçare. Shkaqet për të cilat e drejta e padisë nuk është e lidhur me afat, janë të shumta në praktikë. Në këto raste e drejta për paraqitjen e padisë lind me paraqitjen e shkakut. Në këtë grup të

shkaqeve hyjnë: shkelja e besnikërisë bashkëshortore, vepra penale kundër bashkëshortit, lënia qëllimkeqe dhe pa arsye e bashkëshortit, etj.

- Shkaqet jo të fshehta të shkurorëzimit, janë ato të cilat janë paraqitur në mënyrë të "natyrshme" dhe si të tilla nuk mund ti vihen në barrë asnjërisht palë bashkëshortore (mospërputhja e karaktereve, qasja e ndryshme, etj.). Shkaqet e fshehta janë ato shkaqe të cilat janë paraqitur si pasojë e sjelljeve të palëve bashkëshortore, e të cilat janë në kundërshtim me ligjin (keqtrajtimi, etj.).
- Shkaqet për zgjidhjen e martesës për të cilat e drejta e parashtrimit të padisë humbet

Pas kalimit të afatit, janë ato shkaqe për të cilat me ligj është paraparë se humbet e drejta për iniciimin e procedurës po që se ajo nuk është bërë brenda afatit të caktuar, gjatë të cilit (afat) pala ka kuptuar për faktin përkatës. Këto janë shkaqe relative dhe në themelin e tyre qëndron fajësia si element subjektiv (tradhtia bashkëshortore, lënia qëllimkeqe etj.). Shkaqet për zgjidhjen e martesës për të cilat e drejta e parashtrimit nuk humbet asnjëherë, ekzistojnë në të gjitha rastet e tjera kur e drejta e parashtrimit të padisë nuk është e lidhur me afat. Këto janë shkaqe të natyrës objektive (keqtrajtimi, lënia pas dore etj.).

Përveç se me padi, bashkëshortët mund të kërkojnë zgjidhjen e martesës edhe me marrëveshje. Varësisht prej asaj se bashkëshortët a kanë fëmijë apo jo, martesë mund të zgjidhet (shkurorëzohet) në dy mënyra: zgjidhja e martesës me propozim të përbashkët të bashkëshortëve dhe zgjidhja e martesës me marrëveshje të bashkëshortëve. Rasti i parë ka të bëjë me zgjidhjen e martesës ndërmjet bashkëshortëve të cilët nuk kanë fëmijë, ndërsa i dyti me bashkëshortët të cilët kanë fëmijë. Do theksuar se tek rasti i dytë, krahas marrëveshjes për shkurorëzim, bashkëshortët janë të obliguar që kësaj marrëveshje t'ia bashkëngjisin edhe marrëveshjen me shkrim për përkujdesjen, edukimin dhe ushqimin e fëmijëve, e cila jo domosdoshmërisht e obligon gjykatën. Po ashtu me këtë marrëveshje rregullohet edhe organizimi i kontakteve personale të dy bashkëshortëve me fëmijët e tyre në të ardhmen.

Të drejtën për shkurorëzim e kanë vetëm bashkëshortët e jo edhe trashëgimtarët e tyre. Eventualisht, trashëgimtarët mund vetëm ta vazhdojnë procedurën tani më ekzistuese por jo edhe ta iniciojnë atë. Gjithashtu, për ta shuar një bashkësi faktike apo një bashkësi jashtëmartesore nuk kërkohet veprim ligjor zyrtar.

Procedura e shkurorëzimit është një procedurë e veçantë dhe specifike, andaj si e tillë ajo ngërthen në vete disa parime të cilat edhe e karakterizojnë atë. Këto parime janë: parimi i mbrojtjes së veçantë të disa kategorive të personave në procedurë, parimi i përjashtimit të publikut, parimi i kufizimit të disponimit me objektin e kontestit, etj. Procedura zhvillohet në dy faza: fazën e tentimit për pajtim të bashkëshortëve dhe fazën e shqyrtimit gjyqësor. Përndryshe në kontestet martesore nuk mund të nxirret aktgjykim për shkak të mungesës apo aktgjykim në bazë të pranimit. Te kontestet martesore, bazat e ankimit janë të njëjta sikurse edhe në procedurën civile. Përjashtim bëjnë rastet e zgjidhjes së martesës sipas propozimit të përbashkët të bashkëshortëve për shkurorëzim dhe zgjidhjes së martesës me marrëveshje të bashkëshortëve, ku aktgjykimi me të cilën zgjidhet martesa mund të goditet vetëm për shkak të: shkeljeve thelbësore të dispozitave të të procedurës kontestimore dhe për arsye se propozimi është dhënë në lajthim ose nën ndikimin e shtrëngimit, ose të mashtrimit. Nëse martesa është zgjidhur ose është anuluar me aktgjykimin e formës së prerë, vendimi për shkurorëzimin, përkatësisht për anulimin e martesës, nuk mund të goditet me mjetet të jashtëzakonshme juridike.

Bazuar në projektin "Monitorimi i gjykatave të qarkut dhe të qendrave për punë sociale, në raste shkurorëzimi" të realizuar nga shoqata e juristëve "Norma", del se numri i shkurorëzimeve në Republikën e Kosovës është në rritje pothuajse të përhershme. Shënimet përfshijë periudhën e viteve 2000-2004. Kështu përderisa në vitin 2001, nga 15327 martesa të lidhura, 1363 sosh kanë përfunduar me shkurorëzim (duke përfshirë edhe ato të lidhura më parë), në vitin 2003 nga 15985 martesa të lidhura, janë regjistruar 2261 lëndë shkurorëzimi (duke përfshirë edhe martesat e lidhura më parë).

Në vitin 2003, me propozim të përbashkët të bashkëshortëve për shkurorëzim (propozim për zgjidhjen e martesës me marrëveshje të

bashkëshortëve) janë iniciuar 1385 lëndë ose 65.30 % të rasteve, kurse me padi janë iniciuar 736 lëndë ose 34.70 % të rasteve. Prej tyre 344 lëndë ose 46.74 % të rasteve janë iniciuar nga ana e bashkëshortës, kurse 392 lëndë ose 53.26 % të rasteve janë iniciuar nga ana e bashkëshortit. Po ashtu në këtë vit, nga 2121 lëndë të kryera për shkurorëzim, në 1363 lëndë ose 64.26 % të rasteve bashkëshortët kanë pasur fëmijë, kurse në 758 lëndë ose 35.74 % të rasteve bashkëshortët nuk kanë pasur fëmijë.

Në vitin 2003 prej 1363 rasteve të shkurorëzimit, ku bashkëshortët kanë pasur fëmijë, në 682 lëndë ose 50.03 % të rasteve fëmijët u janë besuar nënës, kurse në 681 lëndë ose 49,97 % të rasteve fëmijët u janë besuar babait. Në këtë vit, 55 % të bashkëshortëve të shkurorëzuar kanë qenë nga vendet rurale, ndërsa 45 % nga ato urbane. Mosha më e re e bashkëshortit të shkurorëzuar ka qenë 18 vjeçare, ndërsa ajo më e vjetra ka qenë 84 vjeçare.

**Violeta HUSAJ-RUGOVA**

KONVENTA EVROPIANE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJËRIUT DHE LIRIVE THEMELORE ME THEKS TË VEÇANTË NENI 5

Historik i shkurtër

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore është një traktat ndërkombëtar, me synim unik respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, është miratuar në Romë me 4 nëntor të vitit 1950 duke u bërë gurthemel i Këshillit të Evropës. Teksti i saj bazë i ripërpunuar dhe plotësuar me 13 protokolle të saj është aprovuar në mënyrë suksese në periudhën prej vitit 1952 deri në vitin 1994.

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore (Konventa) i përcakton të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të njerëzve në Evropë si dhe mekanizmat kontrolluese për mbrojtjen e tyre.

Vendet evropiane, anëtare të Këshillit të Evropës dhe nënshkruesit e Konventës për respektimin e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore dhe protokolleve të Konventës, janë të obliguara që të gjithë njerëzve që gjenden nën juridiksionin e tyre t'u mundësojnë gëzimin e të drejtave të tyre njerëzore dhe lirive themelore.

Gjithashtu këto vende janë të obliguara që qytetarëve të vet, grupeve tjera dhe individëve, si dhe të huajve që qëndrojnë në territorin e tyre t'u mundësojnë aplikim të papengueshëm para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, në rast se ata konsiderojnë se liritë dhe të drejtat e tyre janë abuzuar nga organet e pushtetit publik të shtetit përkatës.

Konventa ka 59 nene dhe 13 protokolle. Protokollet 1,4,6,7 dhe 12 janë protokolle shtesë (me to janë shtuar të drejtat e garantuara), ndërkaq protokollat e tjera janë protokolle amandamentuese.

Konventa është e përbërë prej gjithsej 3 pjesëve. Në pjesën e parë janë të parapara të drejtat dhe liritë, në pjesën e dytë janë paraparë dispozita lidhur me Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjersa në pjesën e tretë janë përfshirë dispozita të ndryshme me karakter plotësues.

Të drejtat e garantuara

Neni i parë (1) i Konventës përcakton që palët kontraktuese të sigurojnë për të gjithë njerëzit brenda juridiksionit të tyre, të drejtat dhe liritë e definuara në pjesën e parë të konventës. Obligimi vlen për të gjithë personat brenda juridiksionit të shtetit, pa marrë parasysh shtetësinë. Pjesa e parë e konventës përcakton 12 të drejta:

- E drejta për jetë (neni 2),
- Ndalimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor (neni 3),
- Ndalimi i skllavërisë dhe punës së detyruar (neni 4),
- E drejta për lirinë dhe sigurinë e personit (neni 5),
- E drejta për gjykim të drejtë dhe brenda një kohe të arsyeshme (neni 6),
- Mbrojtja nga retroaktiviteti i ligjit penal (neni 7),
- E drejta për respekt të jetës private dhe familjare, shtëpisë dhe korrespondencës (neni 8),
- Liria e mendimit, vetëdijes dhe religjionit (neni 9),
- Liria e shprehjes (neni 10),
- Liria e tubimit dhe organizimit (neni 11),
- E drejta për martesë dhe vendosja e familjes (neni 12) dhe
- E drejta për mjete efektive nëse e drejta e dikujt është shkelur (neni 13).

Shteti nuk mund të kufizojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, më shumë se sa ka parashikuar Konventa Evropiane, mirëpo mund të parashikojë në legjislacionin e brendshëm garantim efektiv të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Konventa garanton edhe disa të drejta të tjera që janë të parapara në protokollin shtesë të saj, përkatësisht në protokollin 1, 4, 6, 7 dhe 12. Siç thamë edhe më lartë protokollin që parashohin dhe shtojnë disa të drejta të tjera quhen protokolle shtesë.

Protokolli me numër 1 i shton edhe tri të drejta të tjera:

- E drejta e pronës (neni 1),
- E drejta e prindërve të sigurojnë arsimim për fëmijët e tyre, konform me bindjet e tyre religjioze dhe filozofike (neni 2) dhe
- E drejta për zgjedhje të lira (neni 3).

Protokolli me numër 4 i shton edhe katër të drejta tjera:

- Mbrojta nga burgimi për shkak të borxheve (neni 1),
- Liria e lëvizjes dhe zgjedhjes së vendbanimit (neni 2),
- Mbrojta nga ekzili dhe e drejta për të hyrë në atë shtet ku është qytetar (neni 3) dhe
- Ndalimi i dëbimit kolektiv të huajve (neni 4).

Protokolli me numër 6 e shton edhe një të drejtë tjetër:

- Ndalimi i dënimit me vdekje gjatë kohës së paqes (neni 1).

Protokolli me numër 7 i shton edhe pesë të drejta të tjera:

- E drejta e të huajit që të mos largohet nga shteti pa proces gjyqësor (neni 1),
- E drejta për tu ankuar për raste penale (neni 2),
- E drejta për kompensim, për procedurë jo ligjore (neni 3),
- Imuniteti nga persekutimi i dyfishtë për shkelje të njëjtë (neni 4) dhe
- Barazia e të drejtave dhe përgjegjësi të bashkëshortëve sa i përket karakterit të ligjit privat në mes të tyre dhe në relacionin e tyre me fëmijët e tyre (neni 5).

Protokolli me numër 12 e shton edhe një të drejtë tjetër:

- Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit (neni 1).

Përveç parashtrimit të një katalogu të të drejtave dhe lirive, Konventa krijon një mekanizëm për vënien në zbatim të detyrimeve të ndërmarra nga shtetet kontraktuese. Kjo përgjegjësi iu besua, tashmë vetëm Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (e krijuar në vitin 1959) dhe Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, i përbërë nga Ministrat e Punëve të Jashtme të Shteteve anëtare apo përfaqësuesit e tyre.

NENI 5 I KEDNJ - E drejta për Liri dhe Siguri personale

Neni 5 i KEDNJ përbën një element themelor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të një individi. Liria personale është kushti bazë për gëzimin e të drejtave të tjera, siç janë: e drejta dhe respektimi i jetës private dhe familjare, liria e lëvizjes, etj. Prandaj, gjyqtarët e shteteve anëtare në ushtrimin e funksioneve të tyre duhet të kenë parasysh që çdo privim i lirisë duhet të vendoset në rrethana të caktuara, të jetë i justifikuar në mënyrë objektive dhe të mos zgjasë më shumë se sa është e nevojshme.

Ky nen ka të bëjë me mbrojtjen e lirisë fizike, e veçanërisht me mbrojtjen e lirisë nga arresti apo ndalimi. Me këtë nen garantohet edhe e drejta për tu informuar menjëherë pas arrestit, e drejta për te dalë sa më shpejtë para gjyqit, si dhe e drejta në procedurë të paraparë me ligj.

Neni 5 paragrafi 1 parashikon që çdokush e ka të drejtën e lirisë dhe të sigurisë personale dhe askujt nuk mund ti hiqet përveç në rastet:

"kur burgoset ligjërisht, pas një dënimi të dhënë nga një gjykatë kompetente";

"kur arrestohet ose burgoset ligjërisht për moszbatim të një urdhri të dhënë nga gjykata në përputhje me ligjin ose për të garantuar përmbushjen e një detyrimi të parashikuar nga ligji"

"kur është arrestuar dhe paraburgosur për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent, kur ka arsye të besueshme për të dyshuar se ai ka kryer një vepër penale ose kur ka motive të arsyeshme për të besuar se është e nevojshme që të pengohet të kryejë një vepër penale ose të largohet pas kryerjes së saj"

"kur një i mitur ndalohet ligjërisht, për qëllim edukimi të mbikëqyrur, ose për ndalimin e tij të ligjshëm, me qëllim që të çohet përpara autoritetit kompetent ligjor"

"kur individët ndalohen ligjërisht për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve infektive të personave të sëmurë mendërisht, alkoolistëve, narkomanëve ose endacakëve",

"kur një person arrestohet ose ndalohet ligjërisht, me qëllim që të ndalohet hyrja e tij e paautorizuar në atë vend, ose për një person kundër të cilit është duke u kryer një procedurë dëbimi ose ekstradimi".

Neni 5 par. 1 i Konventës parashikon fillimisht prezumimin që çdo kush ka të drejtë për liri dhe siguri personale dhe askujt nuk mund ti hiqet, dhe më pas përcakton në mënyrë taksative rastet se kur mund t'i hiqet apo t'i kufizohet liria një personi, do të thotë se ky paragraf i ka 6 përjashtime (që lejon heqjen e lirisë nën kushte të parapara). Pikat a,b,c kanë të bëjnë me ndalimin për çështje civile dhe penale, pika d ka të bëjë me ndalimin e të miturve, pika e me ndalimin në procedurë jashtëkontestimore, ndërkaq pika f ka të bëjë me ndalimet e shtetasve të huaj.

Nga ky paragrafi i këtij neni rezulton se heqja e lirisë së personit mund të bëhet, si kur është kryer vepra penale ashtu edhe për të penguar personin që të kryejë vepër tjetër penale. Që të arrestohet apo të ndalohet një person është e domosdoshme që ai të ketë kryer një vepër penale të parashikuar nga legjislacioni i vendit ku është kryer vepra. Përveç këtij kushti duhet të ekzistoj edhe dyshimi i arsyeshëm për kryerjen e veprës penale.

Ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm që personi i arrestuar ka kryer një vepër penale është një kusht i domosdoshëm (sine qua non) që paraburgimi i personit të jetë në përputhje me ligjin.

Me dyshim të arsyeshëm në kuptim të nenit 5 par. 1 pika c duhet të kuptojmë që heqja apo kufizimi i lirisë personale të personit do të bëhet në rast se ka baza të forta. Gjykata e Strasburgut ka theksuar se dyshimi konsiderohet i arsyeshëm, nëse bazohet në fakte dhe në informacione të cilat krijojnë bindjen se ekziston një lidhje objektive midis personit të dyshuar dhe veprës penale për të cilën ai akuzohet. Kështu duhet të ekzistojnë prova të mjaftueshme që krijojnë bindjen se personi i dyshuar ka kryer veprën penale dhe heqja e lirisë së personit nuk duhet të bazohet në ndjenjat, instinktët apo paragjykimet që mund të ketë gjyqtari për çështjen.

Neni 5 paragrafët 2 dhe 3 parashohin që:

2. Çdo person i arrestuar duhet të informohet brenda një afati sa më të shkurtër dhe në një gjuhë që ai e kupton, për arsyet e arrestimit të tij dhe në lidhje me çdo akuzë që i bëhet.

3. Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1/c të këtij neni, duhet të çohet menjëherë përpara një gjykatësi ose një zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në gjykim e sipër. Lirimi mund të kushtëzohet nga garanci për t'u paraqitur para gjykatës.

Në këtë rast Konventa parashikon një siguri, që çdo personi që i është hequr liria duhet çuar përpara një gjykatësi apo një autoriteti tjetër të autorizuar me ligj. Funkzioni i autoritetit ligjor kompetent është që të përcaktojë nëse masa e paraburgimit duhet të vazhdohet dhe nëse po, për sa kohë. Gjithashtu është e domosdoshme që kohëzgjatja tërësore e privimit të lirisë përpara gjykimin të veprës penale të mos tejkalohet.

Termi brenda një afati të shkurtër i përdorur nga neni 5 par. 3 përbën një standard të rëndësishëm për respektimin e lirisë personale të individëve. Në Konventë nuk parashihet konkretisht se sa duhet të jetë afati maksimal për t'u çuar i arrestuari apo i ndaluar para një autoriteti gjyqësor por shprehet me termin brenda një afati të shkurtër. Gjykata Evropiane e të drejtave të njeriut është shprehur

rast pas rasti, se sa duhet të jetë afati për tu dërguar personi para një autoriteti gjyqësor. Gjithashtu efekti i vendimit të autoritetit gjyqësor sipas nenit 5 par. 3 është që të sigurojë paraqitjen e personit të dyshuar në gjyq dhe masa e arrestit në burg jepet vetëm kur gjyqtarët krijojnë bindjen se masat e tjera janë të papërshtatshme.

Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se ekzistojnë këto arsye që duhen marrë parasysh nga autoriteti gjyqësor për të vendosur masën e paraburgimit të cilat janë: rreziku i largimit, rreziku i ndërhyrjes në procesin e drejtësisë dhe nevoja për të parandaluar pasojat e mëtejshme të veprës penale.

Së fundmi, gjyqtari duhet të jetë i pavarur dhe i paanshëm me rastin e vendosjes mbi ligjshmërinë por edhe mbi domosdoshmërinë e mbajtjes në paraburgim. Ai duhet të ketë pushtetin e duhur për të bërë këtë gjë dhe vendimet e tij duhet të jenë të detyrueshme dhe të përmbajnë arsye të mjaftuara faktike dhe juridike që arsyetojnë mbajtjen në paraburgim.

Neni 5 paragrafi 4 parasheh:

Habeas Corpus

4. "Çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm".

Me këtë dispozitë i jepet mundësia personit të paraburgosur që të ankohet për ligjshmërinë e paraburgimit. I paraburgosuri, ankesën që të vendoset mbi ligjshmërinë e paraburgimit mund ta paraqes në çdo fazë të procedurës, si dhe në çdo kohë kur ai mendon se është ndaluar pa bazë.

Ndërkaq me paragrafin 5 të nenit 5 të Konventës është paraparë e drejta e personit që të kërkojë dëmshpërblimin, për çdo rast kur ai pretendon se i është shkelur ndonjë e drejtë e garantuar. Ky dëmshpërblim përcaktohet nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili

është i ndryshëm nga rasti në rast. Gjykata në fjalë së pari vërteton se a ka ndodhur shkelja, pastaj shtetit i cili ka bërë shkeljen i përcakton si dënim një shumë të të hollave, të cilin ai shtet ka për obligim t'ia paguaj palës së dëmtuar, si dëmshpërblim, obligim ky të cilin shtetet anëtare e marrin përsipër me rastin e nënshkrimit të Konventës dhe hyrjes në Këshillin e Evropës.

Në rast të mospërfilljes së vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga ana e një shteti anëtar, nuk mund të ketë ndonjë sanksion tjetër, përveç mundësisë së përjashtimit të atij shteti nga Këshilli i Evropës.

Nga ato që u tha më lartë, Konventa (KEDNJ) paraqet një "*Kushtetutë Pan Evropiane*" e cila i obligon shtetet anëtare të Këshillit të Evropës që legjislacionet e tyre të jenë në përputhje me të, e në rast mospërputhje, Konventa mund të gjej zbatim të drejtpërdrejt në shtetin përkatës deri në harmonizimin e atij ligji me Konventën. E gjithë kjo bëhet me qëllim që të arrihet në maksimum dhe në mënyrë efikase respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut që i takojnë çdo qenie njerëzore pavarësisht racës, kombit, fesë, gjuhës. Andaj, shtetet anëtare të Këshillit të Evropës njëkohësisht edhe nënshkruese të Konventës, mund t'iu garantojnë qytetarëve të vet më shumë të drejta dhe liri, se sa ato të parapara në konventë, mirëpo kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore nuk mund t'i tejkalojnë kufizimet e parashikuara me Konventë.

